

Shoqata Albanian Canadian Development Alternative, në bashkëpunim me **ALBLIBRIS**, Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kanada, Agjencinë Kombëtare të Diasporës, organizon panairin e librit shqip në Kanada:

## ALBANIAN BOOK FESTIVAL NË TORONTO, KANADA

### Rudin Dakli:

Një nga synimet tona është të ruajmë kulturën dhe traditat. Dhe ndoshta qasja duhet të fillojë jo nga gjuha, por nga kultura.

#### Aida Baro:

Një laborator kulturor ku testohet jo vetëm çfarë shkruhet në shqip, por edhe si mund të jetojë kjo letërsi në botë

#### Flurans Ilia:

Libri është si një festë që njeriu duhet ta ketë përherë me vete

### SHËNIME MBI LIBRAT

Mbi librin "Për ata që s'u kthyen" të Edona B. Kelmendit, Botimet "Drini", Ferizaj

#### PIKOVA GJAK NË HESHTJE

Nga Agron Tufa (fq. 6)

Poeti Hamit Aliaj

Nga Ymer Çiraku (fq. 8)

Rreth romanit *Në mëni të njeni-tjetrit* të Besnik Mustafajt, "Onufri"

Pajtimi me Hijen

Nga Ballsor Hoxha (fq. 9)

Një qasje krahasimore mes "Princi i vogël" i Sent-Ekzuperisë dhe "Princeshzës së hënës" së Virgjil Muçit, "Dituria"

Një princ e një princeshzë

Nga Dr. Esmeralda Strori (fq. 10)

Ndryshimi i realizmit magjik mes veprës së Anton Nikë Berishës me letërsinë latino-amerikane

Nga Timo Mërkuri (fq. 11)

Dashuria, gjykimi dhe rendi i padukshëm shoqëror: një rilexim i romanit *Krenari dhe paragjykim*

Nga Anja Levanaj (fq. 19)

Disidenca letrare shqipe si e tillë

Nga Eldon Gjikalaj (fq. 5)



## Në kërkim të Mandricës shqiptare

Nga Mimoza Hasani Pllana

(fq. 6)

Mbërrita vonë në Mandricë, në mbrëmjen e së shtunës së dytë të shtatorit 2025, pas një udhëtimi me plot kujtime nga vitet sa jetova në Bullgari dhe me plot pritshmëri për fshatin që nuk arrita ta vizitoj gjatë asaj kohe. Për të shkuar në Mandricë, rruga relativisht më e lehtë nga Prishtina ishte ajo përmes Maqedonisë së Veriut, më pas Greqisë dhe në fund, nëpërmjet kalimit të kufirit Nymfaia-Makaza hymë në pjesën jugore të Bullgarisë ku shtrihet ky fshat shekullor i banuar me shqiptarë. Rruga nga Sofja konsiderohet më e vështirë, pasi përshkon më shumë zona malore dhe me kthesa, duke u bërë kështu rrugë më e lodhshme.

## Fatet e bijave të Pushkinin dhe të Tolstoit

(fq. 20)

Shkrimtari i njohur Anthony Horowitz, pranon se përdor inteligjencën artificiale: "Më duket sikur po mashtroj"

(fq. 23)

Sakrificat ekstreme që Muriel Spark bëri për të shkruar, duke vënë letërsinë mbi mëmësinë dhe martesën



(fq. 24)

### BIBLIOTEKË

Ismail Kadare (fq. 21)

*Shpjegim për librat  
Besianës së vogël*

Roland Gjoza (fq. 12)

*Të dua më shumë se veten*

Iris Halili (fq. 14)

*Xhaketa e Thanasit*

Franco Kulli (fq. 16)

*Mea Culpa e Kel Parubit*

Taip Sulko (fq. 18)

*Ne të tre dhe shpirti njerëzor*

Arben Meksi (fq. 19)


*Karikatura e së shtunës*

Piktura e Mimoza Arapit, një urë mistike e kalimit nga vëzhgimi i epërm në interpretim  
Nga Dhurata Hamzai (fq. 15)

Libri shqip  
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta  
brenda SHBA-së

www.alblibris.al



# ALBANIAN BOOK FESTIVAL NË TORONTO

## Aida Baro

**Një laborator kulturor ku testohet jo vetëm çfarë shkruhet në shqip, por edhe si mund të jetojë kjo letërsi në botë**



Edicioni i dytë i Albanian Book Festival në Toronto shënon një zgjerim të dukshëm të hapësirës letrare shqiptare në diasporë, duke e kthyer festivalin në një platformë të strukturuar dialogu kulturor. Me rreth 350 autorë, afro 5,000 libra dhe 750 tituj të shpërndarë në dhjetë stenda tematike, festivali nuk është vetëm një ekspozitë librash, por një arkitekturë e gjallë e qarkullimit të letërsisë shqipe.

Programi i këtij viti ndërtohet rreth tri boshtesh kryesore: përkthimi, letërsia për fëmijë dhe shkëmbimi letrar ndërkulturor. Këto nuk trajtohen si kategori të ndara, por si zona që ndërthuren vazhdimisht në mënyrën se si letërsia prodhohet, transmetohet dhe lexohet sot, veçanërisht në kontekstin e diasporës shqiptaro-kanadeze dhe lexuesve jo-shqipfolës.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet fëmijëve dhe takimeve me autorë. Këtu letërsia nuk shfaqet vetëm si produkt kulturor, por si një formë edukimi emocional dhe gjuhësor, ku krijohet marrëdhënia e parë me librin dhe imagjinatën. Kështu, do të jetë e ftuar dramaturgia për fëmijë, Suzanne Lebeau, ajo vetë është kanadeze dhe në Shqipëri është botuar pjesa e saj teatrale “Këpucët prej rëre”, përkthyer nga Anjeza Murati e botuar nga Dita Books. Është një risi për tregun e librit në Shqipëri, i cili vuan nga mungesa e larmisë së zhanreve letrare. Kjo vepër është vënë në skenë edhe nga Teatri Metropol.

Në të njëjtën kohë, programi hap një diskutim të thelluar mbi natyrën e shkrimit bashkëkohor. Në bisedën me Ardian Vehbiun, vëmendja zhvendoset drejt kufijve gjithnjë e më të paqartë mes fikcionit, autofikcionit dhe kujtesës personale, duke ngritur pyetje mbi mënyrën se si ndërtohet e vërteta letrare në një epokë ku rrëfimi personal dhe historia ndërthuren vazhdimisht.

Nga ana tjetër, takimi me Rita Petro

e vendos letërsinë në një territor më të drejtpërdrejtë ekzistencial: si akt lirie dhe si mënyrë e të qenit në botë. Fjala nuk mbetet vetëm tekst, por bëhet qëndrim, rezistencë dhe formë vetëdijeje sociale.

Në këtë ekosistem kulturor, një rol gjithnjë e më të rëndësishëm po merr edhe Aida Baro Literary Agency, e cila vepron si ndërmjetëse mes autorëve shqiptarë dhe tregut ndërkombëtar të librit. Agjencia letrare nuk kufizohet vetëm në përfaqësimin e autorëve, por ndërton ura mes përkthimit, të drejtave të botimit dhe rrjeteve editoriale jashtë Shqipërisë. Në një kontekst ku letërsia shqipe ende varet shumë nga iniciativa individuale për të dalë jashtë kufijve gjuhësorë, një strukturë e tillë synon të krijojë vazhdimësi dhe profesionalizëm në mënyrën se si prezantohen dhe qarkullojnë në tregjet e huaja autorët shqiptarë.

Në një plan më të gjerë, festivali përfshin edhe diskutime mbi historiografinë osmane dhe burimet arkivore, mbi letërsinë e mërgimit dhe mbi mënyrat se si e formon përvoja e largimit identitetin dhe kujtesën kolektive. Këto tema e zgjerojnë horizontin e festivalit përtej letërsisë si art, duke e vendosur atë në kryqëzimin mes historisë, ligjit, migrimit dhe kulturës.

Në qendër të gjithë këtij programi qëndron një ide e thjeshtë, por e vështirë për t'u realizuar: që letërsia shqipe të mos mbetet e mbyllur në kufijtë e saj gjuhësorë, por të qarkullojë, të përkthehet dhe të lexohet në hapësira të reja. Kjo kërkon jo vetëm autorë, por edhe përkthyes, redaktorë dhe ndërmjetës kulturorë që e bëjnë të mundur këtë kalim.

Në këtë kuptim, Albanian Book Festival në Toronto funksionon si një laborator kulturor ku testohet jo vetëm çfarë shkruhet në shqip, por edhe si mund të jetojë kjo letërsi në botë.

## Flurans Ilia

**Libri është si një festë që njeriu duhet ta ketë përherë me vete**



Kam qenë i ftuar në një takim në Toronto në 13 Prill 2024, titulluar “Fjalë midis brigjesh” ku në një panel të përbashkët me autorët Ajkuna Dakli dhe Gazment Kapllani do të diskutonim rreth letërsisë, mërgimit, gjuhës shqipe, dhe të tjera tema të përbashkëta si këto. Kam përshtypjen se në këtë periudhë kohore lindi ideja e prurjes së librit shqip në këto brigje të Amerikës së Veriut për disa arsye të veçanta. Së pari ngaqë “epoka” e transportit të librave nga Shqipëria me valixhe konsiderohej tashmë si e tejkaluar, sepse njerëzit preferonin të sillnin më mirë dy bidonë raki në vend të dy tre librave. Së dyti, për t'i dhënë një shans brezit pasardhës që të jetë në kontakt me gjuhën, kulturën dhe librin shqip, përkrah gjuhës së biznesit në të cilën janë shkolluar dhe i përkasin në realitetin e këndejmë. Së treti, për vet ne, autorët në dhe të huaj që vazhdojnë të shkruajnë “kokëfortësisht” shqip. Dua të theksoj qysh në kryeradhë se ideja ka qenë e zotit Rudin Dakli dhe e shoqatës ACDA (Albanian Canadian Development Alternative), një shoqatë jo fitim prurëse për t'u pirë në kupë si i themi ne shqiptarët, e cila në të gjitha këto vite të fundit ka përballuar me dinjitet koston, mundin, e mbështetjes së krejt aktiviteteve kulturore artistike në komunitetin shqiptar në Kanada, çka personalisht nuk e kisha menduar kurrë si autor në të gjitha këto 25 vite që jetoj dhe shkruaj në këtë vend si shumë kolegë të tjerë.

Është normale që në fillesat e një sipërmarrje të tillë tërësisht individuale, thjesht të nisur nga dashuria për kulturën tonë, për të krijuar ura lidhëse me atdheun, qofshin këto thjesht nëpërmjet gjuhës së shkruar por edhe në nivelin akademik, do të kishte njëfarë skepticizmi se si do venë gjërat? A jemi të aftë për ta bërë realitet një sipërmarrje të tillë kaq të madhe? Përtej të gjitha këtyre pikëpyetjeve ACDA organizoi për herë të parë në historinë e diasporës shqiptare në Amerikën e Veriut, Festivalin e Librit Shqip në 30 Nëntori dhe 1 Dhjetor

të vitit 2024 në Toronto. Pjesëmarrja ishte aktive jo vetëm nga Kanadaja por edhe nga Shtete e Bashkuara, madje mbresëlënëse do e quaja në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Duhet theksuar se kjo vinte në një kohë kur gjithandej interesi për librin ka rënie të ndjeshme jo vetë në raport me librin shqip. Pa e kuptuar as vet, po krijuam një oazë që jo vetëm shërben për të shuar etjen në kohën e thatësisë së leximit, por akoma më gjerë, po i jepnim një shtysë vëmendjes kundrejt librit (shqip) nga një hapësirë gjeografike pothuajse e pa imagjinueshme prej së cilës mund të lindë ky fenomen. Këtu dua të shtoj daljen në pah të autorëve shqiptaro-kanadez në takime dhe biseda direkt me publikun por edhe ardhjen e shkrimtarëve dhe poetëve nga Shqipëria në gjirin e diasporës shqiptare. Papritur, si të thuash me vullnet të lirë dhe me dëshirë të mirë, kishim krijuar një urë lidhëse midis dy brigjeve.

Pas edicionit të parë të Torontos, në 27 Prill 2025 zhvillohet Festivali i Librit Shqip në Montreal. Sërish një pjesëmarrje dhe interesim për t'u admiruar nga komuniteti shqiptar i Montrealit i cili dëshmoi se jo vetëm që interesi për librin (shqip) nuk ka vdekur, por jemi një komunitet shqipfolës me identitet të veçantë dhe ndjeshmëri po aq të veçantë kundrejt kulturës tonë.

Këtë fund javë që vjen, në 9 dhe 10 maj 2026 zhvillohet edicioni i radhës i Festivalit të Librit Shqip në Kanada, ku larmia e të ftuarve dhe temave ka një dinamikë ndryshe nga vitet e tjera. Kjo tregon jo vetëm besim për të bërë gjëra të cilat as që i kishim në mendje dy apo tre vite më parë, por njëherazi dëshmon se komuniteti shqiptar është rritur në raport me kulturën dhe identitetin e vet. Nuk është rastësi që ky aktivitet, më i madhi i librit shqip në Amerikën e Veriut, quhet Festival dhe jo Panair, për të nënkuptuar faktin se, Libri është si një festë që njeriu duhet ta ketë përherë me vete.

Montreal, 4 maj 2026

Rudin, gjej rastin t'ju përgëzoj edhe personalisht për iniciativën e jashtëzakonshme të një festivali të librit shqip në Kanada. Kur e kuptuat se Kanadaja kishte një komunitet aq të madh lexuesish të gjuhës shqipe?

Faleminderit, Andreas, për mundësinë e intervistës. Gjej rastin të falënderoj edhe z. Bujar Hudhri për bashkëpunimin. Kanadaja, dhe sidomos Torontoja ku jetoj prej dy dekadash, ka pasur vazhdimisht aktivitete të lidhura me librin dhe letërsinë, duke qenë se këtu tashmë jetojnë prej vitesh autorë që kanë shkruar letërsi cilësore dhe e kanë vazhduar krijimtarinë e tyre në shqip. Kam marrë pjesë shumë herë në promovime librash, takime e tema mbi letërsinë dhe në këto takime është shtruar shumë herë dëshira e autorëve kanadezë, po edhe e lexuesve pjesëmarrës në këto takime, për ta pasur librin shqip në Kanada përtej porosive dhe blerjes së librave vetëm gjatë udhëtimeve në atdhe.

**Mendoni se më të interesuar për këtë festival janë ata shqiptarë që u mungon shqipja si gjuhë e përditshme leximi, apo ai brez i dytë emigrantësh të cilët e kanë humbur deri diku shqipen dhe, nëpërmjet leximit, duan ta rigjejnë, ta rifitojnë atë?**

Të interesuar janë më shumë shqiptarët e brezit të parë, të cilët vazhdojnë ta lexojnë librin dhe letërsinë shqipe, sepse e njohin gjuhën në atë lartësi që nevojitet për të lexuar dhe kuptuar letërsinë. Brezi i dytë shtyhet të marrë pjesë nga kurioziteti, po për fat të keq ka filluar ta humbë lidhjen me gjuhën, aq sa të mos jenë të sofistikuat për të shijuar leximin e një poezie apo libri në shqip.

**Meqë tani është edicioni i dytë, besoni se festivali po kthehet në traditë?**

Shpresojmë. Po mbetet për t'u parë. Në traditë mendoj se mund të kthehet kur brezat e ardhshëm të emigrantëve shqiptarë të fillojnë të lexojnë shqip. Përndryshe do të jetë një traditë që, edhe nëse krijohet, do të fillojë të humbë me kalimin e kohës.

**Kur ideuat dhe organizuat edicionin e parë, cilat ishin pritshmëritë që kishit dhe, a mendoni se i keni arritur ato?**

Kur nisëm punën për realizimin e edicionit të parë pati shumë pikëpyetje. Megjithë një ndjesi pozitive që na kishin krijuar takimet me autorët apo bisedat me të njohur që, sapo gjenin dikë që vinte e kthehej në Shqipëri, porosisnin libra, pritshmëritë nuk ishin të mëdha. Mendoj se edicioni i parë i kaloi pritshmëritë tona. Në fakt, pas festivalit, me gjithë mungesat që mund të ketë pasur në organizim aty-këtu, u ndjemë se kishim arritur një diçka të rëndësishme; hapëm rrugën për futjen e librit shqip në Amerikën e Veriut.

**Dua të më tregoni pak për diasporën shqiptare në Kanada. A është e organizuar në shoqata si dhe, a ia ka dalë të bëhet pjesë e jetës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të atij vendi?**

Diaspora në Kanada është, për vetë mënyrën e përzgjedhjes, një nga

# Rudin Dakli

Një nga synimet tona është të ruajmë kulturën dhe traditat. Dhe ndoshta qasja duhet të fillojë jo nga gjuha, por nga kultura.

*Bisedoi: Andreas Dushi*



komunitetet shqiptare me mesataren e edukimit më të lartë. Për këtë arsye ka tendenca aktivizmi shoqëror, gjë që e tregon edhe numri i madh i organizatave jofitimprurëse në të gjitha fushat e jetës. Mund të them me bindje se tashmë shqiptarët janë bërë pjesë e jetës ekonomike dhe kulturore dhe tashmë ka lëvizje drejt integritit dhe pjesëmarrjes edhe në jetën politike. Së shpejti besoj do të kemi shqiptarë të Kanadasë që do të kandidojnë në të gjitha nivelet e qeverisjes.

**Për t'u rikthyer edhe një herë te festivali i këtij viti, rritja e numrit të botuesve si dhe e shkrimtarëve të pranishëm, çfarë do të thotë për ju? Po për diasporën tonë në Kanada?**

Është një shenjë e mirë që aktiviteti ka ngjallur interes. Herën e parë nuk pati jehonë, pavarësisht përmasave, sepse edhe koha për të njoftuar njerëzit ishte e shkurtër. Ne jemi një organizatë jofitimprurëse dhe e gjithë puna është e vetëfinancuar dhe vullnetare, kështu që edhe mundësia për të sjellë autorë, botues etj. ishte e kufizuar. Këtë vit kemi pasur edhe ndihmën e Ambasadës dhe veçanërisht ambasadores Artemisa Malo, që na ka mbështetur pa rezerva. Sa i përket interesit të komunitetit këtu për të ftuarit, mendoj se këto takime shërbejnë për të vendosur lidhje dhe krijuar njohje të reja, dhe ndoshta edhe për të filluar bashkëpunime të reja.

Po sjellja e librave nga Shqipëria në Kanada, si ishte si përvojë? Sa në aspektin logjistik, aq edhe në atë të përjetimit. Pasi s'e di, më duket disi poetike ideja se dikush në një doganë apo port dhe pret libra që vijnë nga atdheu.

Sjellja e librave nga Shqipëria ishte pika kryesore e hezitimit për të nisur një rrugëtim të tillë. Mungesa e përvojës bëri që herën e parë të merrnim një kontenier nga Shqipëria që kishte vetëm librat në 1/4 e tij dhe pjesa tjetër ishte bosh. Nga pikëpamja logjistike ishte herë e parë dhe çdo hap ishte një përvojë. Librat erdhën nga Durrësi në Montreal dhe pastaj me tren në Toronto. Ngaqë kishim dëgjuar përvoja të ndryshme, morëm vendimin të mos e prenotonim hapësirën deri në momentin që librat ishin këtu. Kjo na kushtëzoi edhe në kohë, edhe në përzgjedhjen e vendit ku do të mbanim panairin. Ishte një përvojë e bukur marrja e librave në dorëzim, po edhe intimiduese. Pesë mijë libra! Një komunitet relativisht i vogël në Toronto, 30-40 mijë shqiptarë. Shumë pikëpyetje, po që, për fat të mirë, morën përgjigje pozitive në ditët e panairit.

**Në programin e festivalit, më bëri shumë përshtypje që ai hapej me një bisedë të lidhur me letërsinë për fëmijë e po ashtu, ditën e dytë ishte sërish e pranishme një autore librash për fëmijë. Është një ndër synimet e festivalit të farkëtojnë lexuesin e gjuhës shqipe në Kanada?**

Po, një nga synimet tona është të ruajmë kulturën dhe traditat. Dhe ndoshta qasja duhet të fillojë jo nga gjuha, por nga kultura. Ky është mendim personal. Është e rëndësishme që brezi i dytë dhe i tretë tashmë të njohë kulturën shqiptare, qoftë edhe në gjuhën që i vjen më lehtë. Kjo do të sjellë interesin dhe kuriozitetin për gjuhën në vazhdim. Çështja e mësimi të gjuhës është e komplikuar dhe mendoj se meriton diskutim të vazhdueshëm.

**Si e keni ndërtuar programin? Ka qenë dëshira për një përfshirje sa më të madhe ajo çfarë ju ka shtyrë t'i ofroni hapësirë promovimeve dhe ligjëratave që lidhen sa me nonfiction-in, aq edhe me fiction-in dhe të cilat, po ashtu, kalojnë nga letërsia për fëmijë, deri te memuarët?**

Për t'iu përgjigjur interesit të lexuesve menduam të shtrihemi edhe në fusha të tjera veç letërsisë. Pati shumë interes për librat historikë dhe këtë vit menduam të organizojmë një takim me temë historinë. Po kështu ka një takim tjetër me temë jurisprudence, një tjetër ku fëmijët e komunitetit do të recitojnë e lexojnë shqip etj. Një larmi aktivitete menduam se do të ishte më e përshtatshme dhe do t'u jepte mundësinë edhe segmenteve të tjera të komunitetit që lexojnë letërsi jo "fiction" të kenë mundësi të marrin pjesë me interes.

**Për këtë vit, cilat janë pritshmëritë që keni?**

Shpresojmë për më mirë se herën e parë. Në fakt vazhdimësia e kësaj nisme do të varet shumë nga rezultatet e këtij edicioni. Shpresojmë të mos jetë thjesht kurioziteti ai që i dha suksesin edicionit të parë.



Mbërrita vonë në Mandricë, në mbrëmjen e së shtunës së dytë të shtatorit 2025, pas një udhëtimi me plot kujtime nga vitet sa jetova në Bullgari dhe me plot pritshmëri për fshatin që nuk arrita ta vizitoj gjatë asaj kohe. Për të shkuar në Mandricë, rruga relativisht më e lehtë nga Prishtina ishte ajo përmes Maqedonisë së Veriut, më pas Greqisë dhe në fund, nëpërmjet kalimit të kufirit Nymfaia-Makaza hymë në pjesën jugore të Bullgarisë ku shtrihet ky fshat shekullor i banuar me shqiptarë. Rruga nga Sofja konsiderohet më e vështirë, pasi përshkon më shumë zona malore dhe me kthesa, duke u bërë kështu rrugë më e lodhshme. Për këtë arsye, itinerari i parë u përshkrua nga vizitorët dhe studiuesit që e kishin vizituar më parë fshatin dhe të cilët, për siguri më të plotë dhe këshilla, i kontaktova para nisjes.

Pjesën e parë të udhëtimit e përjetova si një udhëtim tipik vere. Kudo që ndaleshim e ndjenja puhinë e ngrohtë të fundit të verës, deri në qytetin bregdetar Kavalla, kur kjo ndjenjë bashkë me erën bregdetare mbështillej me një qetësi disi mistike çka ma bënte udhëtimin edhe më të ndjerë. Në Kavalla mbresëlënëse ishte ecja nëpër rrugicat me kalldrëm, ku shihja e ndjeja gjurmë historike shqiptare, pastaj zbritja drejt bregut të detit dhe dreka në një nga tavernat e njohura për ushqimin vendas, i cili ngjante shumë me gatimet tona të përditshme. Si "qershia mbi tortë" e kësaj ndalese ishte gurabia, një ëmbëlsirë me shije të gjalpit, bajameeve dhe me shumë sheqer pluhur, ëmbëlsirë e ngjashme me gurabitë tona.

Pjesa e dytë e rrugës, ajo që të çonte drejt Mandricës, e bënte udhëtimin gjithnjë e më të paparashikueshëm dhe të panjohur. Edhe kufiri mes Greqisë dhe Bullgarisë dukej sikur po humbiste gjurmët në ato zona që rrallë shihej ndonjë udhëtar, ani pse kilometrat kalonin dhe Mandrica nuk ishte më aq e largët. Me të hyrë në Bullgari, dielli veç po perëndonte dhe rruga drejt fshatit të shumëkërkuar po ngushtohej e errësohej gradualisht, saqë, kohë pas kohe, kisha dyshime nëse vërtet ajo ishte rruga e duhur që të çonte drejt një të panjohure, për të cilën kisha krijuar një imazh nga leximet dhe nga krejt pak video që kisha pa e që tani, që shrkuaj, them se nuk kisha pas pa asgjë.

xxx

Që nga viti 2015, kur për herë të parë shkova për të jetuar në Sofje, kisha një dëshirë e vazhdueshme për të takuar shqiptarët e këtij fshati. Kjo dëshirë u shtua edhe më shumë në vitin 2019, kur vizitova fshatin Arbanas dhe nuk takova asnjë njeri që fliste shqip. Që atëherë, prisja një mundësi për të vizituar Mandricën, ku shqipja thuhej e shkruhej se kishte mbijetuar me shekuj.

xxx

Arsyeja pse zgjodha fundjavën për këtë udhëtim lidhej me një këshillë të profesoreshës sime, albanologes bullgare Rusana Hristova Bejleri. Ajo më kishte thënë se, nëse ke dëshirë të takosh banorët, shko në Mandricë të dielën në mëngjes, te kisha e fshatit, aty mblidhen të gjithë, meqë kisha nuk është vetëm një objekt fetar, por qendra e jetës së komunitetit. Aty takohen banorët e përhershëm, por edhe ata që jetojnë në qytete si Sofja dhe Plovdivi, e që kthehen në fundjavë për të vizituar familjet e tyre në fshat. Kështu, e diela është momenti kur fshati gjallërohet dhe kur kujtesa kolektive merr formë, më tha ajo.

Pra, kjo ishte arsyeja pse në Mandricë mbërrina të shtunën vonë, të isha gati për të dielën.

# Në kërkim të Mandricës shqiptare

Nga Mimoza Hasani Pllana



xxx

Para se të nisesha, nuk u mjaftova vetëm me dëshirën për të takuar banorët shqiptarë të këtij fshati. Kisha lexuar libra dhe artikuj nga profesorë të Universitetit të Sofjes dhe studiues të tjerë që kishin shkruar për këtë komunitet. Këto burime më ndihmuan të

krijoja një ide më të qartë për historinë, origjinën dhe rëndësinë kulturore të fshatit.

Sipas gojëdhënave të trashëguara brez pas brezi, themeluesit e Mandricës ishin barinj nga Vithkuqi i Korçës. Albanologu Thoma Kacori, në librin e tij "Ndriçime", pohon se shqiptarët janë vendosur në Bullgari që pas rënies së Shqipërisë nën



Perandorinë Osmane në shekullin XVI. Sipas tij, ata u vendosën në pjesën veriore dhe juglindore të vendit, në veri në fshatin Arbanas, pranë qytetit Veliko Tarnovo ndërsa në juglindje në Mandricë, pranë Ivajlovgradit dhe jo shumë larg qytetit antik Plovdivit. Këto dy fshatra përbëjnë qendrat më të njohura të pranisë së hershme shqiptare në Bullgari, bën me dije Kacori.

Studiues të tjerë, përfshirë edhe profesoreshën Hristova Bejleri, kanë vazhduar kërkimet në terren gjatë shekullit XXI. Sipas saj, një legjendë vendase tregon se fshati është themeluar nga tre vëllezër ortodoksë shqiptarë nga Vithkuqi, të cilët mirreshin me ndërtimtari dhe bujqësi. Në vitet e fundit, bashkë me studentët e Lektoratit të Gjuhës Shqipe realizoi një ekspeditë në terren dhe shënoi numri i banorëve, që sihin diku rreth 58. Numër i vogël thotë, por megjithatë fshati ruante gjurmë të jetës shoqërore dhe kulturore të organizuar rreth identitetit shekullor.

Në përmbledhje, burimet gojore dhe ato të shkruara dëshmojnë për praninë e gjatë të shqiptarëve në Mandricë, edhe pse, me kalimin e kohës kanë ndodhur ndryshime demografike, megjithatë është ruajtur kujtesa e origjinës dhe një pjesë e trashëgimisë gjuhësore e kulturore. Në këtë





kuptim, Mandrica mbetet një rast i veçantë i mbijetesës së identitetit shqiptar në Bullgari.

xxx

Të dielën u zgjova herët, në minutat e fundit të natës, me dëshirën për të pritur lindjen e diellit mbi Mandricë. Dhe po, e pashë. Përmes xhamit të dritares kisha ngulur sytë përtej, siç bëj rrallë në vendet e reja që vizitoj. E hapa dritaren dhe ndjeva ngrohtësinë e natës që po largohej, bashkë me shenjat e para të ditës së re.

Hodha një hap në ballkon, me një ndjenjë të lehtë pasigurie. Ballkoni i vjetër i hotelit "Bukur Shtëpi" dukej i brishtë, i mbështetur mbi trarë të vjetër nga druri, edhe pse të lyer së fundmi. Megjithatë, dola. Hodha një hap dhe një tjetër, me plot pasiguri, por qëndrova aty, në ballkon. Aty e ndjeva qëndrueshmërinë e kësaj ndërtese të vjetër, si një kujtesë prej druri e guri që nuk

dorëzohet, njësoj si edhe qëndrueshmëria e banorëve që kanë mbajtur gjallë identitetin e tyre ndër shekuj.

xxx

Shikimin e parë e hodha drejt qiellit, ishte flakë, mrekulli veç me pa. Po kur sytë i ula poshtë, ajo që pashë ishte pothuajse surreale. Para meje shtrihej Mandrica në qetësinë e saj të plotë. Shtëpitë me tulla balte, rrethuar me dru e të mbuluara me llojlloje bime të gjelbrër, qëndronin të heshtura si në skena të një filmi jashtë kohës sonë. Në atë çast, m'u duk sikur isha teleportuar në një botë tjetër, duke qenë e vetmja e zgjuar në një fshat që tejkalonte edhe imagjinatën time.

Vazhdon...

*E diela në Kishën e fshatit "Shën Dhimitri"*



# Disidenca letrare shqipe si e tillë

Nga Eldon Gjokaj

Fenomeni i disidencës artistike, përkatësisht letrare, në ish vendet komuniste të gjysmës së dytë të shekullit XX ka gjetur një trajtim të gjerë në fushën studimore. Optikë janë të larmishme, por në thelb kanë synuar ndriçimin e veçantive të fenomenit në vende të ndryshme, njëkohësisht edhe spikatjen e invarianceve ideologjike-estetike që e projektojnë fenomenin, diku më pak e diku më shumë si boshtin përbashkues të një kahjeje ndryshe nga realizmi socialist.

Në këtë hapësirë letërsia shqipe ka një vend specifik për arsye thelbësisht socio-politike të zhvillimeve në kohë. Shqipëria ishte i vetmi ndër vendet ish komuniste të Europës Lindore, që nuk e përjetoi revizionim politik të linjës së ashpër ideologjike staliniane. "Shkrirja e akujve" e formuluar nga Ilia Erenburgu pas revizionimit politik të Hrushovit, që solli në ish Bashkimin Sovjetik një klimë shumë më të zbutuar, deri rehabilituese për artistët dhe shkrimtarët që krijonin ndryshe nga modeli i realizmit socialist, në Shqipëri rezultoi si "akullnajë në shtrirje" për të tillë krijues. Kjo politikë, me ndonjë luhajtje, aty këtu, pasojë e situatave socio-politike jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë, vazhdoi linearisht me të njëjtën ashpërsi deri në fillimin e viteve '90-të. Madje edhe pas vdekjes së liderit në vitin 1985, nuk ka shenja të zbutjes së prirjes, prej institucioneve jo e jo, por edhe prej prodhimit letrar në dominancën e tij.

Në vijim të arsyetimit nëse në një vështrim historiko-letrar realizmit socialist në Shqipëri mund t'i përvijohet një fazë inkubimi, një fazë stabilizimi dhe një fazë lëvrimi, faza e dezintigrimit përvijohet më shumë si një fazë kolapsimi në minimim kohor, dhe jo si një proces dialektik, siç ndodh në sistemet letrare nacionale të vendeve të ish Europës lindore.

Problemi i censurës në art, si mekanizëm shtetëror i mirorganizuar dhe autocensurës në periudhën e socializmit shtetëror, ka specifikat e veta dhe në vende të ndryshme ka patur ngjyrimet përkatëse. Sa i takon autocensurës, kjo shfaqet në dy tipologji: e para si besim i padyshimtë, që shpie në bindje ndaj dogmës, të cilën shkrimtari, apo artisti, përpiqet me sa mundet ta materializojë në vepër, dhe së dyti si vetëdije personale, për t'u treguar sa më i kujdesshëm, për të mos rënë në "terren të rrëshqitshëm". "Gabimet", qoftë përmbajtësores, qoftë formale, edhe "aksidentalisht", mund të rezultojnë fatale për të ardhmen. Në tipologjinë e parë, artisti është një "përcjellës i verbër" i doktrinës ideologjike, për të cilin *cogito* dekartiane është e huaj, ndërsa në tipologjinë e dytë dhe me gjasë kjo ka qenë më e pranishme tek krijuesit e talentuar në totalitarizëm, artisti është gjithnjë "vigjilent" për injektimin e dozës së duhur ideologjike në vepër, duke synuar njëherazi cenimin sa më të pakët të cilësisë së saj.

Në Shqipëri vazhdon i njëjti ritëm censure dhe autocensure, deri në fillimin e viteve '90-të. Një dëshmi mjaft interesante lidhur me censurën/autocensurën, nga Shqipëria e periudhës së komunizmit, sjell A. Stipçeviq, në librin e tij *Censori i përsosur*: "Kur një gazetar i huaj e pyeti kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë Dritëro Agollin, i cili ishte edhe redaktor në një ndërmarrje botuese, vallë a ekziston censura në vendin e tij, ai me gezim u përgjigj: "Censura? Po unë jam censura!"<sup>1</sup>

Një fakt i tillë, mes të tjerash, e bën edhe më delikate çështjen e disidencës artistike në Shqipëri. Sa ishte e mundur ajo në terrenin stalinist shqiptar? Në ç'përmasë qëndronte, krahasimisht me vendet e revizionuara të Europës lindore? Nëse disidenca në regjimin komunist do të përkuqizohej si një akt individual publik, në kundërshtim të hapur

me dogmën politiko-ideologjike, siç gjellonte në vende të tjera, në Shqipërinë komuniste kjo ishte e pamundur; për këdo artist ishte vetvrasje e sigurtë. "Shtegu" nga ku atakimi mbetej më i mundshëm ishte ai formal, që, gjithsesi, ngahera i diskutueshëm mbetet.

Arti i krijuar në fshetësi, apo "letërsia e sirtarëve", nuk e krijoi dot kontaktin dhe njëherazi ndikimin te receptuesi në përmasën e duhur. Fenomeni i të famshmeve "Samiztadt", si publikime klandestine *underground*, të shkrimtarëve të shquar disidentë në vende si Polonia, Hungaria, Çekia madje edhe në Bashkimin Sovjetik post-stalinist, mungon në letërsinë shqipe. Një fibër disidence analoge me vendet e tjera ish komuniste nuk përftohet dot, domethënë një përmasë në thelb ideologjike ku shtresëzohet niveli estetik, përfaqësuar nga personalitete si Milloshi, Shollzhenicini, Miçniku, Haveli etj.

Ndërkohë, sa më sipër nuk e përjashton asesi ekzistencën edhe në Shqipëri të artistit disident në vetvete, apo në rrethe intime, që ndryshe mendon dhe ndryshe sillet e vepron (shkruan, pikturon, kompozon, interpreton), por siç thotë Todorov-i, nisur nga veprimtaria dhe karriera zyrtare e Shostakoviçit në komunizëm, "Kur mban një maskë për dyzetë vjet, ajo kthehet në fytyrë".<sup>2</sup>

Ekzistenca e një prodhimi alternativ dëshmohej sidomos pas viteve 90-të. Botohet letërsia e krijuar në burje me autorë si Arbnori, Zhiti, Lubonja etj; botohet letërsia e krijuar në fshetësi me vetëdije të plotë të autorit se po realizonin vepra që nuk mund të botoheshin në kohën e shkrimit, por më vonë, që ndoshta nis me "E madhe gjëma e mëkatit" e Kutelit, për të vazhduar me shumë të tjerë, ku përfaqësues kryesor është Trebeshina. Lexuesi njihet me letërsinë e krijuar nga autorë shqiptarë të cilët për arsye të persekutimit politik kishin qenë të detyruar të mërgonin jashtë Shqipërisë si Pipa, Camaj, Koliqi etj. Ndërkohë nis e botohet vit pas viti letërsia e traditës, që ishte krasituar dhunshëm nga trunghi historik i letërsisë shqipe, sipas kriterit ideologjik, shpesh i lidhur me drejtpërdrejtë me krijuesin, sesa me tekstin: Fishta, Koliqi, Skiroi, Harapi, Prenushi etj.

Pas vitit '90-të një rëndësi të dorës së parë kanë përthimtet në gjuhën shqipe. Kemi një prurje tejet të pasur me krijuesit më të rëndësishëm të letërsisë botërore që deri asokohe ishin përjashtuar nga komunikimi në gjuhën shqipe duke nisur që nga autorët e Romantizmit (reaksonar) për të vazhduar me të gjithë emrat e ndritur të avangardave të gjysmës së dytë të shekullit XIX deri në ditët e sotme. Ardhja në shqip e këtyre autorëve e ballafaqon receptuesin e gjerë por edhe të specializuar me një tjetër *letrarësi*, e cila nga njëra anë kultivon një tjetër shije estetike, duke e ridimensionuar dominancën e saj në sistem, por nga ana tjetër shërben si një lakmus cilësor vlerësimi edhe për prodhim letrar shqiptar sidomos të kryer në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Ndërkohë letërsia e përkthyer ka rëndësinë e saj evidente edhe në orientimin e prodhimit letrar pas vitit '90-të sidomos tek krijuesit e rinj në moshë, që bartin një tjetër asht krijimi krahasuar me pararendësit.

Si përfundim disidenca në letërsinë shqipe mbetet një nga çështjet më të rëndësishme, e vështirë, ku kryqëzohen një sërë problematikash historiko-letrare, të letërsisë së krahasuar po e po, e cila vetvetiu rrok shtresëzime interpretimesh me synim një sintezë sa më pranë të vërtetës. Ndoshta këtu më fort se në argumente të tjerë që kanë të bëjnë me letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX, kjo e fundit (e vërteta) mbetet një "term pune".

<sup>1</sup> A. Stipçeviq, *Censori i përsosur*, Era, Prishtinë 2002, f. 54.

<sup>2</sup> T. Todorov, *L'arte nella tempesta*, Milano, Garzanti, 2017, f. 118.

## I. Parafjalë

Ka libra që rrëfejnë ngjarje dhe libra që mbajnë mbi vete peshën e tyre. “Për ata që s’u kthyen” i Edona B. Kelmendit i përket kësaj të dytës: nuk është thjesht një dëshmi për një episod tragjik të luftës në Kosovë, por një tekst ku kujtesa, dhimbja dhe gjuha bashkëjetojnë në një gjendje të tendosur, pa kërkuar zgjidhje. Rrëfimi nis në një botë të qetë, thujse idilike, në fshatin Qyshk të rrethinave të Pejës, për t’u thyer në një pikë të vetme kohe — 14 majin 1999 — që mbetet boshti i gjithë përvojës së saj.

Librin e veçon jo vetëm materiali tragjik, por mënyra e përpunimit të tij në gjuhë. Rrëfimi është i ndërprerë, i thyer, herë i tërhequr drejt heshtjes, e herë i përqendruar në ndërhyrje poetike që e ngjeshin përvojën pa e zbkuruar. Proza dhe poezia ndërveprojnë si dy mënyra për të përballuar atë që nuk mund të thuhet drejtpërdrejt.

Përvoja e fëmijës del si prani e pandërprerë, e papërthithur nga koha. Ngjarja rrëfëhet nga brenda një plaje që mbetet e hapur, jo nga një distancë e sigurt. Kjo i jep tekstit një ton të kursyer, ku fjala matet dhe heshtja bëhet pjesë e kuptimit.

## II. 14 maji 1999 – skena si bërthamë

Ngjarja e 14 majit 1999 shfaqet si një varg skenash të përqendruara, ku çdo detaj mbart peshë disproporcionale. Dhuna ndërtohet përmes ndërprerjes: një pyetje e hedhur në ajër, një hap përpara, një goditje, një shikim. Pikërisht në këtë ekonomi të ngjeshur shfaqet intensiteti i përvojës.

Episodi i të atit mbështetet mbi një zhvendosje minimale: ai bën një hap përpara. Ky gjest, në rrethana të zakonshme e parëndësishëm, merr këtu një karakter vendimtar. Është një reagim i menjëhershëm, pothuaj instinktiv, i lidhur me nevojën për të ndërhyrë, për të mos qëndruar pasiv. Menjëherë pas këtij hapi, dhuna e zhvesh këtë gjest nga kuptimi i tij: goditja me fundin e automatikut që i jep befaz paramilitari serb, e kthen trupin në objekt dhe e përkul figurën e babait në sytë e fëmijëve të tij, pa e rrëzuar.

Në këtë pikë, rrëfimi zhvendoset nga veprimi te shikimi. Në kujtesë mbetet vështrimi që pason, gjesti i kursyer. I përshkruar si më i rëndë se çdo fjalë, ai shënon çastin kur figura mbrojtëse e babait nuk shembet përpara syve të fëmijës, por madhërohet me aktin martirizues. Teksti e përqendron këtë çast në një komunikim të heshtur, ku kuptimi bartet pa u artikuluar. Fëmija nuk e dëgjon fjalinë; ajo e rindërton: “Mos më mbani mend kështu.” Këtu rrëfimi kalon nga dëshmia në interpretim, duke treguar mënyrën se si trauma përpunohet në kujtesë.

E njëjta logjikë përqendrimi vepron edhe në episodin e tetëmbëdhjetëvjeçarit Ardian, kur paramilitarët e udhërojnë të hyj në shtëpinë që digjet, të digjet bashkë me shtëpinë. Situata paraqitet si një ngurtësim i përgjithshëm: askush nuk lëviz, askush nuk flet, frika nuk shpërthen, por mpikset. Gjuha e dhunës shfaqet përmes një urdhri të thatë, të përkthyer me vështirësi, ndërsa reagimi i viktimës reduktohet në minimum — një zbardhje në fytyrë, një ngrirje e trupit. E ëma nuk klith. Teksti shmang çdo teatralitet dhe

Mbi librin “Për ata që s’u kthyen” të Edona B. Kelmendit  
Botimet “Drini”, Ferizaj

## PIKOVA GJAK NË HESHTJE

Nga Agron Tufa

e vendos lexuesin përballë një tmerri që paralizon.

Në të dyja rastet ndërtohet një përvojë e dhunës që është njëkohësisht edhe një mënyrë e të parit të saj. Ngjarja rrëfëhet nga brenda një vetëdijeje që përpiqet ta kuptojë atë në çastin kur ndodh. Kështu, 14 maji nuk mbetet një datë historike, por një pikë e palëvizshme e përvojës, rreth së cilës organizohet i gjithë rrëfimi i një jetë të tërë, i një bote, që shihet tashmë përmes asaj plaje.

## III. Figura e babait – bosht etik dhe memuaristik

Në strukturën e librit, figura e babait shndërrohet në bosht rreth të cilit organizohet përvoja dhe kuptimi i saj. Prania e tij del në pah përmes fragmenteve, kujtimeve të shkurtra, gjesteve të përditshme dhe, mbi të gjitha, përmes çastit të ndarjes, para masakrës me burrat e tjerë. Kjo ekonomi e portretizimit e largon figurën nga patetika dhe e vendos si një referencë etike dhe emocionale që vazhdon të veprojë edhe pas zhdukjes fizike.

Vendimi për të mos u larguar, edhe kur rreziku është i qartë, mbetet brenda logjikës së një përgjegjësie të heshtur. Ai qëndron, sepse nuk mund ndryshe. Kështu, figura e babait mbetet në përmasën e njeriut të zakonshëm, aty ku pesha e veprimit bëhet më e ndjeshme.

Çasti i fundit, i rindërtuar përmes

dëshmisë së të mbijetuarit, e përforcon këtë dimension. Fjalja “*M’i paskan vra dritat e syve... çka më duhet jeta?*” qëndron si një përmbledhje e zhveshur e përjetimit. Teksti e lë këtë moment në lakuriqësinë e vet. Edhe urdhri i thjeshtë “*Merre, Rexhë!*” — i dhënë pak çaste para ekzekutimit — shfaq një qetësi që buron nga vetëdija e skajshme e situatës. Ekonomia e fjalëve e bën momentin më të rëndë se çdo shpërthim dramatik.

Pas humbjes, figura e babait zhvendoset në një plan tjetër: bëhet një prani e brendshme që orienton jetën e autores. Kujtimet mbajnë gjallë një lidhje që vazhdon të veprojë në të tashmen. Në këtë kuptim, babai shfaqet si figurë e mungesës dhe njëkohësisht si burim kuptimi: një pikë referimi nga e cila matet përballja me jetën.

Jeta pas traumës nuk paraqitet si kapërcim apo shërim. Figura e babait përfshihet në përvojë si një element i pandashëm i saj. Pikërisht në këtë përfshirje qëndron një nga përmasat më të forta të librit: mënyra se si humbja bëhet pjesë e strukturës së brendshme të jetës.

## IV. Gjuha dhe forma – proza e ndërprerë, poezia si përqendrim

Një nga veçoritë përcaktuese të këtij libri është mënyra se si përvoja organizohet në gjuhë. Fjalitë janë të kursyera, shpesh të shkurtra, të çliuruara



nga çdo teprim përshkrimor. Kjo ekonomi është një mënyrë për të mbajtur nën kontroll një material që mund të rrëshqasë lehtësisht në patetikë. Teksti e ul qëllimisht zërin dhe e përqendron kuptimin në njësi të vogla, ku çdo fjalë mban peshë.

Kjo krijon një efekt të dyfishtë. Rrëfimi mbetet i kthjellët në sipërfaqe, ndërsa nën këtë kthjelltësi grumbullohet një dendësi e errët përvojë, që ndihet si presion i vazhdueshëm. Heshtja bëhet pjesë e strukturës së kuptimit, jo thjesht mungesë e të thënit. Pikërisht në këtë raport ndërtohet tensioni i brendshëm i tekstit.

Ndërprerja e prozës nga blloqe poetike e ruan këtë tension. Poezia vepron si formë përqendrimi. Aty ku proza shpalos një situatë, vargu e mbledh atë në një kornizë më të ngjeshur, duke e ndalur rrjedhën dhe duke e fiksuar përvojën në një pikë të vetme. Kjo krijon një ritëm të veçantë: rrëfimi ecën, ndërpritet, përmbledhet dhe më pas rifillon.

Poezitë operojnë me një logjikë tjetër kohe. Ato e mpiksin përvojën në formulime të shkurtra, ku ajo përthyeret dhe përqendrohet. Në “*Për veten time*”, për shembull, rruga nga dhimbja te vetëpërcaktimi paraqitet përmes pohimeve të shkurtra: “*Mungesa më rriti, / dhimbja më mësoi*”. Këto fjali nuk shpjegojnë; ato vendosin.

Në këtë ndërthurje formash ruhet një ndjenjë e qëndrueshme mase. Edhe në momentet më të ngarkuara emocionalisht, teksti ruan kontrollin mbi vetveten. Kjo vetëpërmbajtje e bën përvojën më të besueshme dhe më të qëndrueshme. Dhimbja mbetet e përqendruar, e mbajtur brenda kufijve të një gjuhe që e njeh peshën e saj.

Në këtë kuptim, forma bëhet pjesë e etikës së tekstit. Mënyra se si thuhet lidhet drejtpërdrejt me atë që thuhet. Dhe pikërisht kjo përputhje mes disiplinës së gjuhës dhe natyrës së përvojës i jep librit një qëndrueshmëri që shkon përtej dëshmisë.


## Fragmente të zgjedhura nga libri i Edona B. Kelmendit “Për ata që s’u kthyen”

\*\*\*

...Pastaj befaz një zë i ashpër bërtiti:  
- A ka ndonjë shofer kamioni këtu?

Babi im nuk ishte shofer. Ishte profesor. Por i njihte kamionët, sepse punonte bashkë me xhaxhallarët, një punë të ndershme, për të siguruar më shumë të ardhura për familjen, prandaj menjëherë pas asaj pyetje, ai nuk hezitoi të bënte një hap përpara.

Ndoshta vetë kërkesa për shofer, që dukej se lidhej me ndonjë mundësi largimi prej aty, i dha ndjesinë se mund



të shpëtonte dikë nga ajo turmë....

Por sapo doli një hap përpara të tjerëve, një paramilitar iu afrua dhe e goditi me fundin e automatikut në bark. Trupi i babit u përkul, u bë dyfish nga dhimbja. Por ende pa u drejtuar, ai ktheu shikimin nga ne.

Atë shikim nuk do ta harroj kurrë! Ishte më i rëndë se çdo britmë, më i thellë se çdo fjalë, ishte një vështrim që, përveç dhimbjes së trupit, fliste edhe me një dhimbje tjetër, më të heshtur, më të rëndë, me dhimbjen e një babai që, për herë të parë, nuk mund të mbronte as veten, as fëmijët. Ai nuk kishte frikë për veten. Kishte dhimbje që ne po e shihnim ashtu, të përkulur, të goditur, të pambrojtur. Ishte sikur donte të na kërkonte falje që nuk ishte më ai mburoja jonë. Unë e ktheva në fjalë shikimin e tij, sepse e kuptova që donte të thoshte: "Mos më mbani mend kështu!"

\*\*\*

...Edhe pse babi vazhdonte të rrinte i përkulur nga dhimbja, arriti të mbahej. Nuk ra. Por mamai e dinte se dhimbja e trupit nuk ishte asgjë krahasuar me barrën që ndjente në shpirt. E dinte se ai e kishte kuptuar se përtej asaj barre, përtej asaj goditje qëndronte një e vërtetë tjetër. E kishte kuptuar se ajo ditë nuk ishte më ditë. Ishte fundi.

\*\*\*

... Pastaj foli njëri prej tyre. Ne nuk e kuptuam çfarë tha, por dikush i përsëriti fjalët e tij në shqipe:

- Cili nga meshkujt këtu është më rritur? Silleni këtu shpejt! E sollën Ardianin, djalin e axhës. Ai sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjet, një moshë që në kohë paqje, do të thoshte fillim jete, por atë ditë mjaftonte të konsiderohej burrë.

Një nga paramilitarët iu afrua, e pa drejt në sy dhe i tha me një ton të thatë:

- Hajde, futu brenda! Do të digjesh dhe ti, bashkë me shtëpinë.

Ardiani nuk e kuptonte serbishten. Vetëm i shikonte ata me një hutim të thellë, pa mundur të kuptonte pse po e nxirrnin nga turma. Sytë e tij lëviznin ngadalë, nga njëra fytyrë në tjetrën, sikur kërkonte dikë që do t'i tregonte çfarë po ndodhte. Pastaj pa nga mamai. E pyeti me sy: çka po thonë?" Mami iu përgjigj me një zë që mezi e nxorri:

- Po të thonë me hy... me hy brenda në këtë shtëpi...

Zëri i saj u këput. Nuk mundi ta përfundonte fjalinë. Por ai e kuptoi. Ishte ajo shtëpi që digjej. Dhe ata po i thoshin të hynte brenda saj.

Ardiani u zbardh në fytyrë, mbeti pa pikë gjaku. Trupi iu drodh njëherë, pastaj mbeti si i ngrirë. U kthye për t'i parë flakët që përpinin muret, e pastaj sytë i mbetën të ngulitur në tokë. As nuk bërtiti, as nuk qau. Ishte bërë si statujë, një fëmijë që s'kishte më as forcë të reagoje, as fjalë për t'u mbrojtur. Në atë çast ai nuk ishte më një tetëmbëdhjetë vjeçar, nuk ishte burrë. Ishte thjesht një shpirt i vogël përballë një vdekjeje të tmerrshme. Turma përreth mbeti e ngrirë. Askush nuk lëvizte, askush nuk pipëtinte, të gjithë shihnin në një vend dhe një rrymë e padukshme përhapte një frikë të ftohtë në ajër.

Nëna e Ardianin kapi kokën me të dy duart dhe u përkul, por nuk bëzani. Si shumë të tjera, e kishte mësuar që zëri mund të ishte rrezik i shtuar për birin



e saj. Gratë e tjera ulën kokën, disa nën zë përmendnin emrin e tij, të tjerat shtrëngonin fort fëmijët e vet, sikur në atë shtrëngim të mund të ndalonin fatin e dikujt tjetër. Edhe fëmijët e kuptuan se diçka e tmerrshme po ndodhte. Sytë e tyre ishin të mbushur me lot, por askush nuk qante me zë. Kishte diçka që i ndalonte të qanin. Frika ishte bërë më e madhe se lotët...

... Një paramilitar tjetër iu afrua dhe e pyeti me një shqipe të çalë:

- Sa vjeç je?

- Shtatëmbëdhjetë... - iu përgjigj Ardiani me zë të ulët, pa i ngritur sytë.

- Ulu qaty, - i tha serbi. - Po të lëmë me jete... edhe një ditë.

Ata ndaluan aty. Por ajo ndjenjë vdekje nuk u largua. Qëndroi pezull mbi ne, si një re e rëndë tymi që nuk lëviz, që nuk ikën nga mushkëritë, që ngjitet pas lëkurës dhe shpirtit.

\*\*\*

Flakët kishin përpirë çatinë dhe zhurma e trarëve që kërcisnin në kulm, e qeremideve (tjegullave) që binin në tokë si poça që thyhen, më është gdhendur në kujtesë. Sa herë i mbyll sytë, e dëgjoj ende atë zhurmë. Ende e ndjej erën e drurit të djegur, të mishit, të shpresës së tretur. Ajo ishte era e humbjes që s'kishte fund. E dhimbjes që nuk ikte më.

\*\*\*

Dikur, gjatë ditës, babai e kishte pyetur njërin nga paramilitarët:

- Ku janë familjet tona?!

Ai i ishte përgjigjur ftohtë:

- I kemi mbaruar (ekzekutuar).

Kushëriri kishte treguar se babi ishte kthyer kah ai dhe me një zë të lodhur e të trishtuar i kishte thënë:

- M'i paskan vra dritat e syve... çka më duhet jeta?

Pak çaste më vonë, njëri nga paramilitarët kishte hedhur një shkrepëse para këmbëve të babit dhe burrave që ishin pranë tij. Askush nuk e dinte pse. Çfarë donin? Çfarë prisnin? Rexha, kushëriri që ndodhej ngjitur me babin, i kishte hedhur një shikim të hutuar, të mbushur me pyetje. Babi i ishte përgjigjur shikimit të tij dhe me një zë të qetë, por të prerë, i kishte thënë: - Merre, Rexhë! Asnjë fjalë tjetër. Vetëm ajo. Sikur në atë fjalë të vetme të mund të përmbledhej gjithçka që mund të thuhej para fundit. Kur Rexha ishte përkulur për ta marrë shkrepësen, ata kishin qëlluar me rafale automatiku. Krismat kishin shpërthyer njëra pas tjetrës, duke përzier britma, pluhur e gjak.

Në atë çast kaosi, kushëriri i babit kishte arritur të kërcente prej dritares dhe të ikte. Ajo shtëpi, që ende nuk ishte e përfunduar, i kishte dritaret të mbyllura me najlon dhe pikërisht përmes atyre najlonëve të grisur, ai kishte marrë arratinë, mes plumbave dhe zjarrit.

\*\*\*

Ne fëmijët që ishim pak më tutje, nuk e dëgjuam fjalinë e tij të fundit me gjysmë zëri, por dëgjuam britmat. Pastaj kujën. Zërat e grave që çanin natën dhe thyeshin si qelqi. Disa binin përtokë pa frymë, të mpiira nga dhimbja; të tjerat qanin me dënese, duke thirrur emra që nuk do t'u përgjigjeshin më.

\*\*\*

Unë isha e thyer. E humbur. Në trupin tim ndodhej një qetësi e çuditshme, një si ngrirje e thellë, që më jepte shumë dhimbje, por asnjë pikë loti. Një heshtje e akullt që nuk të lejonte as të qaje. Ishte një pjekuri e hidhur që më kishte shtyrë përpara, pa më pyetur nëse isha gati.

\*\*\*

Nuk hanim. Nuk flinim. Nuk flisnim. Jetonim me frymën ndalur. Zëri na ishte shuar; flisnim vetëm me pëshpërima, si shpirtra që kishin humbur fjalën... Në mëngjes rrugët ishin bosh. Ajri mbante një erë të rëndë, erën e djegies, të trupave, të shtëpive, të shpresës që piqej dhe digjej bashkë me gjithçka tjetër. Ditët që pasuan nuk kishin emra. Nuk kishin data, as orë, por as çaste. Ishin vetëm një rrjedhë e zymtë, si një errësirë e dendur ku ora nuk lëvizte. Nuk shihnim më fare Çfarë ndodhte jashtë; gjithçka zhvillohej brenda nesh. Ato që po i jetonim ishin skena tragjike që njerëzimi i kishte parë dhe riparë që nga agimi i historisë së tij. Kishim mbetur të mbërthyer në atë ditë që na vodhi jetën që deshëm. Ajo që mbeti nuk ishte asgjë tjetër, përveç një tronditje e vazhdueshme. Nuk flisnim, nuk pyesnim, nuk prisnim. E jetonim një përditshmëri që nuk ndryshonte. Edhe dielli, kur dilte, dukej i njëjtë me natën. Koha kishte humbur kuptimin. Jeta po ashtu.

\*\*\*

Çdo mëngjes pyes veten: si vazhdon jeta kur zemra jote nuk jeton më?... Pothuaj u çmenda. Humba shkëndijën time udhërrëfyese. Pikova gjak në heshtje. Prandaj nuk mund të them se e përballova, unë mbijetova.

\*\*\*

Kujtimet nuk vdesin. Ato mbesin të gjalla, të fshehura në rrudhat e ditëve tona, dhe nganjëherë mjafton një detaj i vogël, si një xhakëtë, për t'i zgjuar ato me gjithë forcën e tyre. Dhe unë, edhe sot, vazhdoj t'i ruaj. Sepse në çdo kujtim të tij, gjej një copëz të vetes sime që ende nuk është shëruar.

...Dashuria nuk më bëri të harroj kush jam, por më dha mundësinë të vazhdoj të jem: të jem vajza e një martiri, të jem një grua që nuk hoqi dorë nga jeta, të jem një nënë që, një ditë, do ta tregoj të vërtetën, pa frikë... E kuptova se dashuria nuk është një rezervuar që zbrazet, por një burim që zgjerohet, thellohet, rritet bashkë me jetën.

E dashur unë!

E vërteta është kjo: ti nuk je vetëm ajo që të ndodhi, por gjithçka që ndërtove përtej saj.

## PËR VETEN TIME

Unë jam ajo vajza që qau,  
por lotët e saj u bënë fjalë.  
U përkul, por në kujtimin e tij gjeti forcë.

Mungesa më rriti,  
dhimbja më mësoi;  
por zëri i babit më tha:  
"Mos e ul kokën."

Unë nuk jam vetëm plagë,  
jam edhe drita që ai la.  
Dhe kjo trashëgimi më mban gjallë.

Duke u hedhur një sy shkrimeve të ruajtura në ekranin e kompjuterit, vreja dhe disa shënime të hedhura për poezinë e Hamit Aliajt (1954-2024). Ishte një diskutim që e mendoja për ta mbajta në një përkujtimore të organizuar në nderim të këtij poeti, me të cilin kisha patur njohje e miqësi të kahershme. Pjesëmarrja e të pranishmëve në atë takim, miq e të afërm të tij, ishte e madhe dhe në mesin e diskutimeve që nuk mbaronin, e pata të pamundur të flisja, duke menduar edhe për të mos krijuar zgjatje dhe përsëritje.

Gjej rastin që t'i risjell për lexuesin disa mbresa e vlerësime për këtë poet, një ndër emrat e dalluar në thesarin e poezisë së sotme shqipe. I dalluar prej disa shenjave poetike vezulluese, që ajo i përcjell mjeshtërisht në nivel metaforik dhe estetizmi gjuhësor.

Me Hamitin jam njohur qysh në vitet studentore, në fillimin e viteve '70-të.

Dua të kujtoj se tek unë si bashkëstudent me të (ishte dy vite pas meje), ai u identifikua si njeriu, i cili shfaqte jo vetëm një mirësi fort të çiltër, por edhe një furi talenti, të cilën, në fakt nuk e zhurmëronte vend e pa vend, siç mund të ndodhte me disa të tjerë aso kohe, rishtarë entuziastë të poezisë.

Të ofronte një miqësi aq të pastër, vërtet prekëse.

Kishte vetpërbajtje e modesti, që binte në sy qysh në njohjen e parë me të. Por jo të kalkuluar, apo të rafinuar qëllimtazi për hesap dukjeje e shtirjeje. Ishte veçse njeriu i vërtetë - për atë çka përfaqëonte realisht dhe harmonishëm, me vlerat e tij njerëzore dhe letrare.

Me sa duket, këtë sjellje karakteriale e sillte edhe prej traditave familjare nga vinte dhe që i ishte bërë pjesë e karakterit. Pra, karakter i qëndrueshëm, pa konformizma dhe luhajtje ditore. Por ama, jo egocentrist. Përkundrazi, mbeti njeriu i brishtë e ca i tërhequr, por me botë të madhe, ashtu siç e dëshmoi edhe në poezinë, që krijoi dhe botoi.

Në vitet pas studentore, nuk kemi patur rast që të takohemi aq dendur mes nesh, siç do të deshmim, ndonëse kam mbetur aq sa kam mundur, një lexues besnik i poezisë së tij, të cilën, H. Aliaj e botonte kohë pas kohe në faqet e gazetave letrare dhe në një varg librash si: "Bjeshkët janë mbiemri im", "E ruaj një fjalë për ty", "Lotin nuk ta fal", "E hëna përtej botës", "N' Dardani bjen një tupan", etj. Po ashtu, është autor i mjaft skenarëve të filmave dokumentarë, i teksteve të dhjetra këngëve, si dhe fitues i disa çmimeve në poezi.

Shqipëria e mbetur, apo "Shqipëria londineze" - siç e quante shpesh me pezm Ali Podrimja, pra, Shqipëria e vogël gjeografikisht, bëhet ndërkaq aq e madhe me vlerat e saj, por që për fat të keq, bëhet në jo pak raste - e madhe edhe prej problematikave dhe prej ngjarjeve të mbrapshta të krijuara brenda vetes. Çka na e kanë bërë shpesh të vështirë komunikimin mes shokësh e miqsh. Thuaj sikur të ishim brenda hapësirave të largëta të një kontinenti të stërmadh e jo brenda një qyteti si Tirana (!).

Duket se Hamitin, për vet natyrën e tij disi të tërhequr, i vinte për mbarë të zgjidhte që të qëndronte disi në periferi të jetës, ndonëse në poezinë që krijonte, ai kishte hyrë meritueshëm mu në qendër të poezisë shqipe.

Dua të kujtoj me këtë rast, pikërisht atë që e ka vënë në dukje me të drejtë, në një nga shkrimet për të, edhe shkrimtari dhe miku i afërt me të, Mehmet Elezi, kur shkruan se Hamit Aliaj është "provincial" në dukje - por veçse universal në përmbajtje, sepse vargu i tij, sfidon çdo provincializëm.

Para viteve '90-të, është vënë re një dukuri interesante, që do të ishte rasti të bëhej objekt studimi për historianët e letërsisë shqipe. Kësaj kohe, mund të

# Poeti Hamit Aliaj

Nga Ymer Çiraku

thuhet se kanë funksionuar le t'i quajmë katër "Qarqe Letrare", kryesisht në poezi, të shtrira përkatësisht në Tropojë, Lezhë, Tepelenë, Lushnjë. Në secilin prej këtyre qarqeve (apo le ta themi disi me rezerva apo pa rezerva "grupime letrare"), kemi një varg emra poetësh, disa prej të cilëve do të zënë vend meritueshëm në poezinë shqipe si: Anton Pappleka, Skënder Buçpapaj, Hamit Aliaj, Ndoc Gjetja, Rudolf Marku, Preç Zogaj, Petrit Ruka, Qazim Shemaj, Ilirian Zhupa, Faslli Haliti, Visar Zhiti, Bujar Xhaferri etj.

Mund të themi se këtë dukuri, nuk e kemi të shfaqur kaq dukshëm në qytete të tjera, ndonëse disa prej tyre ishin dhe qytete të mëdhenj, me tradita të spikatura kulturore e letrare dhe me autorë të njohur edhe në poezi.

Poetët në këta katër "qarqe letrare", janë sigurisht krijuar individual, pra me vlerat e tyre origjinale. Pra, jo me atë frymën dromos "përbashkuese/unifikuese" - në rrafshin estetik të krijimtarisë së tyre, që mundet ta sillte një mjedis i caktuar kulturor, apo le ta themi një i ashtuquajtur "Qark letrar". Duhet kuptuar se komunitetet e këtyre poetëve, kanë funksionuar kryesisht si mediume, ku ata mund të ndiheshin mes tyre më afër komunikimit letrar, larg nga monotonia e punëve profesionale, që ushtronte çdonjeri. Brenda një komunikimi të tillë letrar, duket

se ata i "zgjerimin" poetikisht hapësirat e ngushta të qyteteve ku jetonin.

Besoj se "mecenatizmi" estetik, që ka funksionuar në arealin letrar në Tropojë, si ashk frymëzues, duket që të ketë qënë trashëgimia e njohur dhe aq e pasur e poezisë epike dhe lirike popullore e atyre anëve, mbleksur dhe me traditat e ligjërimeve të kuvendeve në kulla, në bjeshkë e në lugje.

Hamit Aliaj i përket pra, në fillimet dhe formimin e vet krijues, "Qarkut letrar" të Tropojës, ku kanë spikatur disa poetë të tjerë të njohur.

Dhe në poezinë e tij, nën pushtetin e relievit të pasur kulturor e historik të atij mjedisi, brenda fashave të regjistrimit të zhërvjellët stilistik, vrehet të ketë mjaft ajër, dritë, qiell, hapësirë, lartësi, të përcjella e të transfiguruar këto si referenca me vlera estetike.

Është poeti, të cilin e brejnë "pyetjet e vjetra", nga ato pyetje, që e lënë botën pa gjumë. Në vargjet e tij, dashuria në kuptimin më të përplotshëm të saj, ka fuqinë dhe misterin e madh si bibla e dritës së jetës.

*"Sonte do të fle në tbanin e prillit*

*Në kasollen e fëmijërisë*

*Thurrur me marse*

*Lule t' lulsa paskan lulue natën..."*

Ndrehen dendur në këtë poezi dhe vargje që përcjellin shpirtin e trazuar të njeriut, endur ngultazi nëpër kohëra - në kërkim



të paqes së tij, ndofta të cënuar dhunshëm.

Është kuptimplote dhe e gjithkohshme maskarada e antiheronje, që në paqe modifikojnë dhe fallsifikojnë rrjedhat e historisë. Poeti është tejet i ndjeshëm dhe apelon fort për demaskimin e atyre, që jo vetëm ishin indiferentë ndaj të keqes së madhe kolektive, por me mbarimin e luftës, kur flitej për të munguarit (të rënë), i shpalli tradhëtare deri edhe pemët pse çelën lule në kohë të robërisë (!) Dhe me sakicë në krah, i preu ato një e nga një dhe me drurin e tyre gdhend të vdekurit - dhe del e i shet në emër të historisë! Poezi kjo, që ka një furi të gjithkohshme demaskuese - ndaj falsifikatorëve të histories sonë. Një dukuri sa e vjetër, aq edhe e re, që për fat të keq, nuk mungon të shfaqet mes nesh.

Para disa kohësh, në një shkrim kushtuar Hamit Aliajt, publicisti i njohur Luan Rama, në vlerësimet e kësaj krijimtarie, mes të tjerash propozonte që një shkollë apo rrugë, të mbante emrin e tij.

Një propozim me shumë vend. Me zbatimin e këtij propozimi, nuk do të nderohej thjesht poeti. Shkrimtarët dihet se përmes veprës që krijojnë, rrojnë përtej moshës së tyre biologjike. Pra, nuk kanë nevojë ata, por kanë nevojë komunitetet, që të identifikohen dhe të hirësohen me vlerat e figurave të nderuara, sikundër është dhe Hamit Aliaj.



Ka një fenomen të çuditshëm në romanin *Në mëni të njeni-tjetrit* të Besnik Mustafajt: megjithëse libri botohet si fiction, ai flet për dy figura të dokumentuara në historinë tonë. Njëra i përket historisë gojore, përmes këngës së Shog Sokolit; tjetra historisë më të afërt të Kosovës: Dren Cekës, djaloshi dhjetëvjeçar që i mbijetoi masakrës ndaj familjes së tij nga forcat serbe.

Shog Sokoli, si personazh i historisë gojore, është konflikti që e përcjell autorin për një jetë të tërë: nga fillimi i viteve tetëdhjetë e deri sot, ose së paku deri në çastin kur lexon historinë e Dren Cekës. Ky i fundit, po ashtu djalosh rreth dhjetëvjeçar, bëhet dëshmitar i një masakre familjare në Kosovë, duke e kthyer historinë e Shog Sokolit nga këngë e vjetër në plagë të përsëritur.

Romani është aq i besueshëm, aq i lidhur me ngjarje reale, sa nuk i ikën dokumentaritetit. Megjithatë, Mustafaj ka vendosur ta quajë roman, jo ese, jo dokumentar, jo rrëfim autobiografik. Pikërisht këtu lind pyetja: ku qëndron ndarja mes fiction-it dhe dokumentares në këtë libër? A ka vërtet ndarje? Apo romani lind pikërisht aty ku dokumenti nuk mjafton më?

Le të nisemi nga figura që i rri autorit si hije gjatë gjithë jetës: Shog Sokoli. Në kuptimin jungian, Hija është ajo pjesë e njeriut që shtypet, mohohet, lihet e pajetur. Ajo nuk përmban vetëm potencialin e pashfrytëzuar apo ankthin e mohuar, por edhe një vetvete që nuk ka arritur të bëhet jetë. Në rastin e Shog Sokolit, kjo bëhet edhe më e rëndë, sepse, siç na e paraqet romani, ai është një fëmijë i varrosur së bashku me farefisën e tij në një masakër. Dhe autori e kupton këtë histori kur është afërsisht në të njëjtën moshë me të.

A është, atëherë, Shog Sokoli një fat i mundshëm i vetë autorit? Një figurë me të cilën fëmija Besnik identifikohet pavetëdijshëm? Një Hije e fëmijërisë, e historisë familjare dhe e kolektivit shqiptar? Dhe, më tej, a është dëshira naive, patriotike, nacionaliste për hakmarrje një formë e lidhjes me këtë Hije?

Këto pyetje duhet t'i lëmë pak më vonë, pasi të ndalemi te disa nga pikat kyçe të romanit.

Në pjesën më të madhe të librit, autori/narratori lufton me veten për të shkruar historinë e Shog Sokolit. Kjo histori i vjen nga kënga gojore dhe është e lidhur ngushtë me historinë e familjes së tij. Ai nuk mund t'i ikë asaj. Sa herë që radioja e familjes e transmeton këngën, gjyshja e tij ndalon çdo lëvizje, çdo zë, çdo jetë tjetër në shtëpi, përveç këngës.

Në atë këngë, një fëmijë rreth dhjetë vjeç këndon ndërsa burrat e fshatit janë duke mihur varrin e përbashkët. Në naivitetin e tij, edhe Shogu nis ta kuptojë çfarë po ndodh me "mallkimin" e çuditshëm që merr nga babai. Historia lidhet me dhunën ndaj shqiptarëve myslimanë në zonat kufitare, në kohën kur serbët kërkonin nënshtrimin ose asimilimin e tyre të dhunshëm përmes konvertimit në fenë ortodokse. Ata që nuk pranorin, vriteshin.

Narratori i Mustafajt është një njeri që rrëfhet para nesh. Ai e sheh veten duke luftuar, duke mbijetuar, madje duke u përballur me atë që vetë e quan një lloj "skizofrenie" të pasioneve të brendshme: hakmarrjes, naivitetit, ambicies letrare, ideologjisë së shtetit në të cilin është formuar, dhe dëshirës për ta "vendosur në vend" historinë.

Në të vërtetë, ai flet për periudhën nga fillimi i karrierës së tij si shkrimtar, në fillim të viteve tetëdhjetë, deri në kohën e tanishme. Gjatë gjithë kësaj kohe e përcjell pengun për ta kthyer në jetë, për ta vendosur në vend dhe për ta treguar të patregueshmen e masakrës.

Kjo histori mund të ndahet në tri shtresa. E para është shtresa e shkrimtarit të ri, të pushtuar nga pasioni për drejtësi. Mirëpo drejtësia që ai imagjionon në atë kohë është ende e varfëruar nga ideologjia, nga nacionalizmi dhe nga modeli i hakmarrjes. Të "vendosësh drejtësinë në vend" për të do të thotë, në thelb, ta shtosh edhe një plumb, edhe një gjakmarrje, edhe një vazhdimësi të luftës mes dy popujve të armiqësuar.

Në këtë shtresë të parë, Mustafaj na e tregon luftën e narrators me pasionet e veta. Ai është i ri, ambicioz, i edukuar brenda ideologjisë komuniste, në një botë ku mendimi, shprehja dhe imagjinata janë të kufizuara nga shteti. Megjithatë, pikërisht ky kufizim bëhet, paradoksalisht, shpëtim për të. Sepse romani

Rreth romanit *Në mëni të njeni-tjetrit* të Besnik Mustafajt, Onufri

## Pajtimi me Hijen

Nga Ballsor Hoxha

nuk e lë të bëhet thjesht roman hakmarrje.

Momenti vendimtar është takimi me gjyshen. Shkrimtari i ri shkon tek ajo me ambicien për ta intervistuar, për të mbledhur materialin e romanit të madh nacionalist që mendon se do ta shkruajë. Por gjyshja, megjithëse nuk zë shumë hapësirë në libër, del të jetë qendra morale dhe filozofike e romanit. Ajo është bartëse e një dhimbjeje që nuk pranorin të kthehet në retorikë. Ajo e mban masakrën në vete, por nuk ia dorëzon nipit si armë.

Këtu shfaqet mjeshtëria e Mustafajt. Pyetjet e shkrimtarit të ri, që mund t'i imagjinojmë lehtë, na bëjnë ne si lexues të kuptojmë se ai është nisur në një rrugë të rrezikshme dhe qorre. Por ai vetë, në atë kohë, nuk e kupton këtë. Për të, heshtja e gjyshes është pengesë. Për lexuesin, ajo është urti.

Gjyshja bëhet mur. Jo mur i ftohtësisë, por mur i dhimbjes dhe i flijimit. Ajo nuk pranorin ta ushqejë romanin e hakmarrjes. Në heshtjen e saj, ajo e ruan nipin nga mënia. Jo vetëm nga mënia ndaj tjetrit, por edhe nga mënia ndaj vetes.

Kjo na çon te shtresa e dytë e romanit: filozofia e rrëfimit. Mustafaj e ka një sinqeritet të thellë, të njohur edhe në vepra të tjera të tij, për ta nxjerrë të vërtetën e idesë së romanit deri në kockë. Ai nuk e fsheh naivitetin e vet të dikurshëm. Nuk e zbulon veten. Nuk e nxjerr shkrimtarin e ri si hero të drejtësisë, por si njeri të kapur nga ideologjia, nga ambicia,

nga dhimbja dhe nga dëshira për hakmarrje.

Kjo krijon dy rrjedha brenda librit. Nga njëra anë kemi rrëfimin për Shog Sokolin dhe për masakrën që duhet treguar. Nga ana tjetër kemi rrëfimin për shkrimtarin që nuk di si ta tregojë atë pa rënë në vazhdimin e dhunës. Romani, në këtë kuptim, nuk është vetëm për një masakër të së kaluarës; është për rrezikun që kujtesa e masakrës të bëhet vetë motor i masakrave të ardhshme.

Dhe pikërisht këtu qëndron arsyeja pse libri duhet të jetë roman. Dokumenti mund të tregojë çfarë ka ndodhur. Eseja mund të shpjegojë çfarë do të thotë. Por romani mund të tregojë njeriun që nuk di çfarë të bëjë me atë që ka ndodhur. Mund të tregojë luftën mes kujtesës dhe mënies. Mes drejtësisë dhe hakmarrjes. Mes rrëfimit dhe heshtjes.

Në fund, ajo që ndodh është një formë pajtimi. Jo pajtim i lehtë. Jo pajtim politik. Jo harresë. Por ajo që në shkencat humane njihet si reconciliation: pajtim me mundësinë dhe pamundësinë e shkrimit të këtij romani. Paradoksi është se romani që dukej i pamundshëm për t'u shkruar është pikërisht romani që kemi në duar.

Tani le t'i kthehemi Hijës.

Kur shkrimtari vetëdijshëm për Shog Sokolin, është në të njëjtën moshë me të. Kur kënga dëgjohet në radion e familjes, ai mbetet i palëvizshëm, i pagojë, i pavetëdijshëm për luftërat dhe masakrat që lidhen edhe me



historinë e familjes së tij. Ai jeton nën shtypjen e ideologjisë së Shqipërisë së Enver Hoxhës, por njëkohësisht nën një tjetër shtypje më të thellë: atë të historisë së trashëguar.

Këtu lind ndjesia e së njohurës së panjohur. Shog Sokoli është familjar dhe i huaj në të njëjtën kohë. I afërt dhe i frikshëm. Një figurë që ia prish lojën, humorin, fëmijërinë dhe realitetin e përditshëm. Ai hyn në jetën e fëmijës përmes gjyshes dhe këngës, pra përmes dy formave të fuqishme të kujtesës: trupit familjar dhe traditës gojore.

Tërë romani mund të lexohet si përpjekje e një njeriu me Hijen e tij. Herë duke e pranuar, herë duke e mohuar; herë duke dashur ta jetojë, herë duke dashur ta kthejë në armë; herë duke e ruajtur, herë duke u rrezikuar prej saj. Sigurisht, narratori nuk e mohon drejtpërdrejt Shog Sokolin. Ajo që ai mohon, ose nuk arrin ta përballojë, është ajo që mbështjell Shog Sokolin: hija e masakrës, ankthi i zhdukjes, dëshira për hakmarrje, frika se historia mund të përsëritet.

Por kjo Hije nuk është vetëm personale. Gjatë leximit të romanit, ajo përhapet. Bëhet Hije kolektive shqiptare. Trashëgohet nga përvoja të rënda shekullore: masakra, kërcënime për jetë, dhunë shtetërore, asimilim, luftëra, humbje, varre të përbashkëta, këngë që nuk lejojnë të lëvizësh kur dëgjohen. Në pavetëdijen e Mustafajt qëndron afër Hija e kolektivit shqiptar: ankthi i luftës me tjetrin dhe frika se ky ankth mund të kthehet në mënyrë të jetuarit.

Kjo Hije përsëritet në Kosovë. Millosheviqi dhe aparati i tij shtetëror e ushtarak sulmojnë shqiptarët në Kosovë. Në këtë histori, Mustafaj i mbetet peng sidomos operacioni "Patkoi" dhe dhuna e Serbisë ndaj shqiptarëve. Por në mesin e miliona të dhunuarve, ai gjen sërish një Shog Sokol: Dren Cekën.

Dren Ceka nuk është thjesht përsëritje dokumentare. Ai është kthimi i Hijës në kohën moderne. Ai tregon se ajo që dukej këngë e vjetër nuk ka mbaruar. Se historia gojore nuk ishte vetëm e kaluar, por paralajmërim. Se fëmija i këngës mund të kthehet si fëmijë i lajmit, i dëshmisë, i masakrës bashkëkohore.


Prandaj romani *Në mëni të njeni-tjetrit* është, në thelb, roman për Hijen kolektive shqiptare: ankthin e vrasjes, të masakrës, të zhdukjes. Një Hije që herë kërkon rrugë për hakmarrje, si në projektin e dikurshëm të shkrimtarit të ri, dhe herë kërkon rrugë për përmbajtje, si në heshtjen e gjyshes dhe në pjekurinë e romanit që më në fund shkruhet.

Kapitulli i fundit, siç del nga logjika e librit, është vendi ku kjo Hije nuk zhduket, sepse Hija nuk zhduket kurrë. Ajo vetëm njihet, pranohet, mbahet. Në këtë kuptim, Mustafaj kthehet te "gurëzimi" i gjyshes: te ajo formë e heshtjes që buron nga dijenia e tmerrshme e asaj që ka ndodhur dhe e asaj që mund të vazhdojë. Sidomos e asaj që mund të eskalojë deri në pafundësi, deri te njeriu i fundit.

Në fund, ky roman, megjithëse duket i pamundshëm për t'u shkruar, arrin qëllimin e tij. Jo qëllimin ultra-nacionalist të shkrimtarit të ri, të formuar nga ideologjia e rrënuara, por qëllimin më të vështirë: përmbajtjen, njohjen e Hijës dhe pajtimin me të.

Ky nuk është pajtim me krimin. Nuk është pajtim me harresën. Nuk është pajtim me padrejtësinë. Është pajtim me faktin se rrëfimi nuk duhet të bëhet vazhdim i mënies. Është pajtim me përgjegjësinë e shkrimtarit për të mos e kthyer dhimbjen në municion.

Dhe pikërisht këtu romani i Mustafajt e gjen forcën e vet: jo në rindërtimin e masakrës, por në betejën e brendshme për të mos e lejuar kujtesën e masakrës të bëhet një tjetër formë e mënies



Nga të gjitha udhëtimet që njeriu bën në jetën e tij, vetëm disa prej tyre lënë një gjurmë të thellë shpirtërore. Në këto raste përtej përvojës fizike, udhëtimi shndërrohet në një realitet i cili të ndryshon botën e brendshme, përjetimet, ndjenjat, reflektimet dhe deri vizionin për të ardhmen.

Në vazhden e udhëtimeve të mia, përvoja në Observatorin e shtetit të Kalifornisë (Griffith Observatory) më solli një tjetër përjetim. Vëzhgimi tërë kureshtje dhe ndjesia që shkaktonte prekja e gurit të Hënës dhe Marsit, kometave dhe meteorëve të ekspozuar apo vëzhgimi i yjeve me teleskop, ekspozimet e elementeve kimikë, krijimi i stinëve, ekuinoksi, të sjellin ndjesinë që hapësira nuk është më për t'u zotëruar, por një realitet që kërkon të soditet. Të duket sikur e gjithë kjo atmosferë të rrëmben në mënyrë magjike dhe të çon mijëra vite dritë larg për ta soditur hapësirën e më pas të rikthen në Tokë me shpirtin e mbushur plot me mrekullitë e Universit.

E gjendur mes asaj që mund të shpjegohet dhe asaj që mund të ndihet, fillova ta kuptoj ndryshe edhe letërsinë.

Atmosfera e krijuar përgjatë këtyre dy udhëtimeve ngacmoi në nënvetëdijen time si lexuese dhe studiuese refleksione të reja mbi dy vepra të rëndësishme letrare: "Princi i vogël" i shkrimtarit francez, Egzyperi, një vepër mjaft e njohur ndërkombëtarisht, e përkthyer në mjaft gjuhë të botës dhe "Princeshëza e Hënës" e shkrimtarit bashkëkohor shqiptar, Virgjil Muçi, e botuar në vitin 2023. Kjo vepër e cila në një kohë të shkurtër është përkthyer në italisht e greqisht, ka marrë rrugën drejt një proze të lexuar edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Ky krahasim ka lindur nga dëshira për të vendosur ballë për ballë dy botë: arsyen dhe ndjenjën. Princi i vogël kërkon të kuptojë, të gjejë shpjegim, ndërsa Princeshëza nga ana tjetër e gjen kuptimin tek soditja. Nga ana tjetër e shoh edhe një përpjekje për të ndjekur atë vijë të hollë që ndan njohjen nga ndjesia, realen nga simbolikja, ndoshta edhe për të reflektuar se kuptimi i vërtetë i ekzistencës nuk qëndron në njërën anë apo në tjetrën, por në kapërcyell të të dyjave. Si lexuese dhe studiuese këto dy vepra i shoh të krahasueshme në rrafshin tematik, strukturor, filozofik, estetik dhe stilistik.

I frymëzuar nga romani "Princi i vogël" i Egzyperisë, Virgjil Muçi e sjell "Princin e vogël" në ditët tona, në një kohë të re, moderne, ku shkenca, teknologjia e robotika kanë nderhyrë në të gjitha sferat e jetës njerëzore. "Princi i vogël" tashmë është "Princeshëza e Hënës". Kjo përrallë moderne e mban të mbërthyer lexuesin për të shkuar drejt një fundi të papritur. Në këtë mjedis surreal mes astronautit dhe Princeshëzës zhvillohen dialogje mjaft interesante mbi shkencën, teknologjinë, robotikën, mjedisin në tokë e deri tek temat filozofike mbi jetën, miqësinë, dashurinë, heshtjen dhe vetminë; gjë e cila e shtyn lexuesin drejt refleksioneve mbi botën e sotme moderne. Një tematikë e tillë (edhe pse Virgjil Muçi shkruan në kontekstin shqiptar) është universale duke na sjellë përvoja që tejkalojnë kufijtë kulturorë. Kjo e bën veprën të komunikueshme në nivel ndërkombëtar.

Të dy autorët në rrafshin tematik vënë në qendër të veprës së tyre botën feminare si simbol i pafajësisë dhe i së vërtetës,

(Një qasje krahasimore mes "PRINCI I VOGËL" I ANTUAN DË SENT-EKZUPERISË DHE "PRINCESHËZËS SË HËNËS" SË VIRGJIL MUÇI)

## Një princ e një princeshëzë

Nga Dr. Esmeralda Strori

por edhe si kundërvënie ndaj botës së të rriturve. Tek Ekzyperi ky kontrast është shumë i theksuar, ndërsa tek V. Muçi është më poetik dhe ëndërrimtar. Kjo kundërvënie del hapur në fjalët e Princit të vogël kur shprehet: *Kam takuar mjaft njerëz të rëndësishëm në jetën time, kam jetuar për një kohë të gjatë mes të rriturve. I kam njohur nga afër, i kam vëzhguar pa pushim. Por mendimi im për ta nuk është se ndryshoi thelbësisht. Po kështu edhe fjalët e Princeshëzës kur ajo shprehet: *Të rriturit nuk kanë fantazi. Edhe kur thonë të vërtetën gënjejnë. Të dy personazhet udhëtojnë nga një planet në tjetrin për të kuptuar botën dhe njerëzit, një udhëtim që është më shumë shpirtëror sesa fizik. Në të dyja veprat trajtohen tema të mëdha universale, njerëzore që lidhen ngushtë me ndjenjën e dashurisë, miqësisë, lumturisë, përgjegjësisë dhe vetmisë, të cilat dalin dukshëm në fjalët e personazheve. Fjalët e Princit të vogël: *Të harrosh një mik është diçka fort e trishtë. Është gjë e bukur të kesh pasur një mik, edhe nëse paskëtaj të ndodh të vdesësh, apo të Princeshëzës: *Ja pra fatin e lumturinë ngandonjëherë shkon e i gjen atje ku s'ta pret mendja; Jeta****


*është një udhëtim që kryhet më këmbë; zgjojnë vetëdijen e lexuesit duke hapur refleksione mbi realitetin e jetës. Të dyja veprat nuk janë thjesht libra të shkruara për fëmijë, por ato mbartin kuptime të thella filozofike të cilat në fakt duhet të fillojnë dhe të kuptohen edhe prej fëmijëve të vegjël. Një prej temave filozofike më të ndjeshme lidhet me konceptin e vetmisë. Tek Princi i vogël ajo del përmes fjalëve të tij: *Vetmi e madhe është edhe pranë njerëzve* ndërsa tek Princeshëza kjo temë zë më shumë hapësirë, në një kontekst modern ku vetmia e njeriut sa vjen dhe thellohet e ndikuar nga jeta individualiste dhe moderne në epokën e teknologjisë së avancuar, koncept i shprehur përmes fjalëve të saj: *Terri është më fort një dimension i brendshëm sesa i jashtëm.**

Tek vepra "Princi i vogël" udhëtimi nëpër planete të tjerë dhe dialogjet me personazhe të ndryshëm simbolizojnë tipologji të ndryshme njerëzore; secili prej tyre përfaqëson vlera të tjetërsuara të botës së të rriturve, permendim këtu personazhet si: *mbreti* simbolizon pushtetin absurd, *biznesmeni* materializmin, ndërsa *pijetari* arratisjen

nga realiteti. Siç shprehet vetë personazhi: *Të rriturit janë vërtet shumë të çuditshëm.* Pra është një roman i cili trajton në mënyrë më të drejtpërdrejtë absurditetin e botës së të rriturve, krizën e vlerave dhe kuptimin e jetës. Këtu kemi një kritikë të drejtpërdrejtë shoqërore dhe morale. Ndërsa tek "Princeshëza e Hënës", figura e saj dhe hapësira kozmike përdoren si metafora për ëndrën dhe kërkimin shpirtëror. Ajo ka një filozofi më të nënkuptuar, më shumë emocionale dhe estetike sesa analitike. Ndihet një arratisje nga realiteti drejt një bote më ideale dhe ëndërrimtare.

Për nga struktura "Princi i vogël" është një roman filozofik me episode të ndara, të përbërë nga dialogje, ndërsa "Princeshëza e Hënës" është më tepër një përrallë moderne, prozë poetike dhe lirike me një strukturë të thjeshtë narrative. Personazhi i Princit është aktiv, eksplorues, pyetës, ai kërkon përgjigje, është në kërkim të së vërtetës. Tek Princeshëza ajo kthehet në simbol të arratisjes, bukurisë, ëndrës, idealit të largët. Në të dyja veprat në qendër është bota njerëzore por nëse Egzyperi e bën përmes filozofisë dhe reflektimit kritik, Virgjil Muçi e bën përmes poezisë dhe ëndrës.

Jam e mendimit se vendosja e veprave letrare në rrafsh krahasues është me vlerë edhe për të vënë në dukje rëndësinë e botimeve në letërsinë tonë, të shkrimtarëve bashkëkohorë, të cilët përmes përpjekjeve dhe punës së tyre sjellin krijime po kaq me vlerë sa edhe të autorëve klasikë.



Romani "Gjin Bardhela i arbresh" i Anton Nikë Berishës qëndron në një nivel të lartë artistik dhe hyn denjësisht në dialog me realizmin magjik latino-amerikan të autorëve si Gabriel García Márquez dhe Juan Rulfo etj., madje në shumë çaste ai e konkurren atë për nga thellësia dhe ngarkesa poetike, por megjithatë mbetet thelbësisht i ndryshëm në mënyrën si e ndërton dhe e përjeton magjiken. Ky dialog nuk është ndikim i drejtpërdrejtë letrar, por një takim i dy traditave shpirtërore që kanë arritur, secila në mënyrën e vet, të bashkohen në mitin me realitetin njerëzor.

Realizmi magjik, si një mënyrë e veçantë e të rrëfyerit, nuk është i njëjtë kudo, sepse ai merr frymë ndryshe në hapësira të ndryshme kulturore, sikur të ishte një erë që bart aromën e tokës nga ku ngrihet. Në këtë kuptim, realizmi magjik i romanit shqiptar dhe ai latino-amerikan nuk janë thjesht dy variante të së njëjtës dukuri, por dy mënyra të ndryshme për të parë botën dhe për t'i dhënë kuptim asaj përmes një ndjeshmërie që lidh të dukshmen me të padukshmen. Në njërin rast miti është kujtesë e ruajtur, në tjetrin është përpjekje për ta rikrijuar kuptimin e humbur të botës.

1. Në romanin shqiptar, magjika nuk hyn në realitet si diçka e huaj apo e papritur, por është aty që në fillim, si një kujtesë e vjetër që nuk është shuar kurrë dhe që vazhdon të jetojë në heshtje brenda qenies njerëzore. Ora e shtëpisë, zanat, të Bukurat e Dheut, besa edhe ringjallja e Kostandinit nuk shfaqen si çudi që kërkon shpjegim, por si pjesë e rendit të gjërave, të pranuar natyrshëm nga njeriu shqiptar pa ndier nevojën për t'i ndarë nga realiteti. Në këtë mënyrë, realiteti nuk çahet në dy pjesë, por mbetet i vetëm, i thelluar dhe i pasuruar me një shtresë të padukshme që e bën më të gjallë dhe më të ndjeshëm ndaj misterit. Magjika këtu nuk është thyerje e ligjeve të botës; ajo është kujtesa e ligjeve të saj më të hershme.

Në këtë botë, miti nuk është një jehonë e largët, por një dritë e brendshme që nuk shuhet, një frymë që ecën pranë njeriut pa bërë zë, duke u shndërruar në një prani të heshtur që ushqen vetëdijen dhe kujtesën. Ai nuk rrëfëhet si diçka që i përket së shkuarës, por merr frymë në gjakun e kohës, si një rrënjë që vazhdon të ushqehet nga thellësitë e padukshme të qenies.

Ndërsa në realizmin magjik latino-amerikan, edhe pse magjika pranohet si pjesë e realitetit dhe nuk vihet në dyshim nga personazhet, ajo ruan një tension të brendshëm që e bën botën të duket sikur lëkundet mes rendit dhe absurdit. Aty ngjarjet e çuditshme ndodhin me një qetësi të jashtme që i bën edhe më të çuditshme në thelb, ndërsa brenda tyre ndjehet një prirje drejt çrregullimit, sikur realiteti të ishte një ëndërr që nuk arrin të gjejë një formë të qëndrueshme.

Në Amerikën Latine magjika shpesh shfaqet si reagim ndaj një historie të dhimbshme kolektive, ndërsa tek Berisha ajo lind si vazhdimësi e një harmonie të lashtë mes njeriut dhe botës. Kështu tek Pedro Páramo, zërat e të vdekurve nuk janë thjesht pjesë e një bote të përtejme, por një jehonë e rëndë që mbështjell hapësirën me një heshtje të ngarkuar dhe pothuajse të dhimbshme. Fantazmat latino-amerikane kërkojnë drejtësi historike; figurat mitike shqiptare ruajnë ekuilibrin ekzistencial.

2. Dallimi bëhet më i dukshëm kur vëmendja ndalet te burimi i magjikes, sepse në romanin shqiptar ajo buron drejtpërdrejt nga mitologjia dhe folklori, duke ruajtur një pastërti që lidhet me kujtesën kolektive dhe me mënyrën tradicionale të të menduarit, ndërsa në Amerikën Latine magjika lind nga një përzierje kulturash dhe historish, ku bashkëjetojnë elemente indigjene, spanjolle dhe afrikane, duke krijuar një identitet të ndërthurur që kërkon vazhdimisht të kuptojë vetveten. Në romanin e Berishës miti nuk është produkt i përzierjes kulturore, por vazhdim i një trangu të vetëm shpirtëror që nuk është shkëputur nga rrënjët e tij.

3. Kjo ndryshon edhe funksionin e saj, sepse në "Gjin Bardhela i Arbresh" magjika nuk përdoret për të rrëfyer historinë, por për të ndriçuar kufirin e brishtë mes jetës dhe vdekjes, mes kujtesës dhe harresës, ndërsa tek Márquez apo Rulfo ajo shpesh bëhet një mënyrë për të treguar historinë e dhimbshme

# Ndryshimi i realizmit magjik mes veprës së Anton Nikë Berishës me letërsinë latino-amerikane

Nga Timo Mërkuri



të një kontinenti dhe për të shprehur përmes figurave të çuditshme një realitet që nuk mund të përshkruhet ndryshe. Tek Berisha realizmi magjik është introspektiv; tek latino-amerikanët ai është historik dhe social.

4. Edhe koha rrjedh ndryshe në këto dy botë, sepse në romanin shqiptar ajo nuk ecën në vijë të drejtë, por kthehet mbi vetvete dhe rikrijon vazhdimisht lidhjen mes së kaluarës dhe së tashmes, duke e bërë kujtesën një përvojë të gjallë që nuk shkëputet kurrë plotësisht. Duket sikur vetë koha ndalet për një çast dhe dëgjon, si një plakë e urtë që ruan në gji historitë e pathëna, ndërsa njeriu përpigjet të kuptojë nëse është ai që e jeton botën, apo bota që e ëndërron atë. Koha në romanin shqiptar nuk është histori; ajo është kujtesë e gjallë.

Në realizmin magjik latino-amerikan, edhe pse koha shpesh merr formë ciklike, ajo mbart gjithmonë peshën e historisë dhe të ngjarjeve që kanë lënë gjurmë të thella në ndërgjegjen kolektive, duke e bërë përsëritjen një lloj fatkeqësie që nuk mund të shmanget lehtë.

5. Një tjetër dallim i ndjeshëm shfaqet në mënyrën si trajtohet vdekja, sepse në romanin shqiptar ajo nuk është një fund i prerë, por një kalim i heshtur drejt një gjendjeje tjetër

të qenies, ku të vdekurit mund të qëndrojnë pranë të gjallëve pa e prishur rendin e botës, ndërsa tek Rulfo vdekja merr një peshë të rëndë dhe mbulon gjithçka me një ndjenjë boshllëku dhe jehone, sikur jeta të ishte vetëm një kujtim i largët që nuk arrin të rikthehet plotësisht. Vdekja tek Anton Nikë Berisha është vazhdimësi ontologjike; tek Rulfo është plagë historike.

Dhe ndoshta, në këtë ndërthurje të heshtur të reales me të magjiken, realiteti shfaqet si një derë gjysmë e hapur, ku botët prekin njëra-tjetrën pa u përzier plotësisht, duke ruajtur një ekuilibër të brishtë që e bën përvojën njerëzore më të thellë dhe më të pasur.

6. Dallimi më i thellë qëndron në vetë natyrën e magjikes, sepse në romanin shqiptar ajo është mënyra natyrore e të qenit dhe nuk ka nevojë të justifikohet, duke u shfaqur si një frymëmarrje e qetë e botës, ndërsa në realizmin magjik latino-amerikan ajo është një gjuhë e zgjedhur për të treguar një realitet të vështirë dhe për të shprehur absurditetin e tij.

Në njërin traditë miti është trashëgimi; në tjetrën është shpikje shpëtuese.

Kështu, në njërin anë kemi një botë ku miti është ende gjallë dhe flet me një zë të ulët, por të qëndrueshëm, ndërsa në anën tjetër kemi

një botë ku miti rikrijohet për të kuptuar një realitet të thyer, dhe pikërisht në këtë dallim qëndron bukuria e këtij krahasimi, sepse ai na tregon dy mënyra të ndryshme të së njëjtës përpjekje njerëzore për të gjetur kuptim në jetën që rrjedh mes dritës dhe hijes.

Në realizmin magjik latino-amerikan, njerëzit jetojnë me fantazmat.

Në romanin e Anton Nikë Berishës- arbëreshi jeton me dheun.


Dheu bëhet kujtesë, trup, gjak, vazhdimësi. Dhe pikërisht këtu realizmi magjik shqiptar nuk kërkon të habitë lexuesin; ai kërkon ta rikthejë atë në një mënyrë më të thellë të të jetuarit.

7. Në këtë këndvështrim më të gjerë, realizmi magjik i Anton Nikë Berishës nuk mund të shihet vetëm si një paralelizëm me traditën latino-amerikane, por si një formë evropiane dhe ballkanike e këtij fenomeni estetik. Ai lind jo nga nevoja për të shpikur një realitet alternativ, por nga ruajtja e një bote ku miti, besimi dhe kujtesa nuk janë shkëputur kurrë nga përvoja e përditshme njerëzore. Ndërsa realizmi magjik latino-amerikan shpesh shfaqet si reagim ndaj traumave historike dhe fragmentimit të identitetit, realizmi magjik i Berishës duket si një rikthim në një unitet të hershëm ontologjik, ku njeriu, natyra dhe e shenja vazhdojnë të bashkëjetojnë pa konflikt. Në këtë kuptim, romani "Gjin Bardhela i Arbëresh" nuk qëndron në periferi të realizmit magjik botëror, por e zgjeron atë drejt një dimensionit tjetër: drejt një realizmi magjik të kujtesës së gjatë, ku historia nuk rrëfëhet vetëm, por përjetohet si trashëgimi shpirtërore. Kështu, vepra nuk dialogon thjesht me Márquez-in apo Rulfo-n, por hap një trajektore të vetën, duke e kthyer realizmin magjik në një mënyrë të të qenit dhe jo vetëm në një mënyrë të të rrëfyerit.

8. Në këtë mënyrë, krahasimi mes realizmit magjik të Anton Nikë Berishës dhe atij latino-amerikan nuk përfundon në dallim estetik, por hap një kuptim më të thellë kulturor: ekzistojnë realizme magjike që lindin nga kriza e historisë dhe realizme magjike që lindin nga vazhdimësia e kujtesës. Tek Márquez-i dhe Rulfo-ja, magjika shpesh është mënyra për të mbijetuar brenda një bote të thyer; tek Berisha ajo është mënyra për të mos e humbur kurrë botën e trashëguar. Prandaj, në romanin shqiptar, miti nuk rikrijohet - ai vazhdon të jetojë. Ai nuk është imagjinatë që shtohet mbi realen, por realiteti vetë në gjendjen e tij më të thellë.

Kështu, "Gjin Bardhela i Arbëresh" mund të lexohet si një dëshmi se realizmi magjik nuk është pronë e një kontinenti të vetëm, por një gjuhë universale që ndryshon sipas shpirtit të popujve. Në këtë roman, arbëreshi nuk endet mes fantazmave të historisë, por ecën brenda një bote ku dheu, kujtesa dhe shpirti flasin ende të njëjtën gjuhë. Dhe pikërisht këtu qëndron veçantia e veprës: ajo nuk e bën realitetin të duket i pabesueshëm, por e bën misterin të duket i natyrshëm.

Në fund, realizmi magjik i Berishës nuk kërkon të na bindë për mrekullinë; ai na kujton se mrekullia ka qenë gjithmonë pjesë e jetës njerëzore. Dhe ndoshta për këtë arsye, lexuesi nuk del nga romani me ndjesinë se ka lexuar një histori të jashtëzakonshme, por me ndjesinë më të rrallë artistike: sikur realiteti vetë është bërë më i thellë, më i heshtur dhe më i gjallë se më parë.



## TË DUA MË SHUMË SE VETEN

të dua më shumë se veten  
dhe shkaktare e harresave je ti  
s'ha bukë  
s'vë alkool në gojë  
kam harruar emrin e poetit  
që shkroi  
fryu erë e detit dhe rrëzoi hijen e lisit  
dhe më kujtohet kur bie të fle  
ashtu krejt papritur  
i zhvendose gjërat  
zemra si duket s'mbante më  
stomaku s'treste  
dhe mushkëritë e donin një aparat oksigjeni  
të gjitha emocionet si letra të shtrenjta  
i le si kompjuteri në ajër  
të qarkullojnë në botën e madhe  
të emocionojnë të akulltit  
mendove dhe për të varfrit  
më bëre bamirës me fat  
ushqeva tërë pëllumbat e parkut  
dhe të pastrehëve iu dhashë para  
sa i mirë u bëra  
më i mirë se dalai lama  
ndihmoja pleq e plaka  
dhe iu flisja ëmbël  
s'isha unë, jo, s'isha unë  
i kisha të tuat  
zemër, mushkëri, puthje  
se e ndieja  
nga vështrimi që më hidhnin nënat e reja  
kur iu puthja fëmijët!  
ishe ti!  
ishe ti vërtet  
të dua më shumë se veten!

## I HOQA ZINXHIRËT

i hoqa zinxhirët një nga një  
të parin atë të dashurisë  
me bosin tim amerikan e prisha kontratën  
tani jam i lirë  
pa zinxhirë  
nju jorku më shkel syrin nga ura e bruklinit ku kalonte  
treni që më çonte në tajms skuer  
në ora 7 fiks  
rri mbështetur te dritarja dhe shikoj katër trenat që më  
kalojnë mbi çati r, e, f, m  
dhe avionët e jfk që s'kanë mbarim  
ç'të bëj tani që jam i lirë?  
zinxhirët që më kishin lidhur më mbanin lidhur dhe me të  
tjerët  
s'kam më asnjë lidhje  
po sa trishtim dhe mërzi!  
ia nis nga e para  
kërkoj një dashuri  
mulates që kam përbri i nxjerr gjuhën dhe lëpij buzët  
ajo përsërit të njëjtin veprim dhe kruan pëllëmbën e dorës  
do para për kafe dhe cigare  
të parin lidh sërish zinxhirin e dashurisë  
dhe bosit hebre i trokas për punë  
lidh dhe zinxhirin e dytë  
i mbërthyer me zinxhirë si sklevërit e piramidave  
pres fundin  
me zinxhirë  
vjen karonti atomik dhe m'i zgjidh

## I THEM KAQ HERË HIQ DORË PREJ MEJE

i them kaq herë; hiq dorë prej meje  
jam si një gërmadhë me mistere  
ditën errësirë  
natën t'i shpon sytë terri  
të hysh brenda  
lakuriq nate të presin  
po ti buzët më kërkon dhe më jep burimin  
këmishën më zbërthen dhe më jep kraharorin  
më ul zinxhirin e pantallonave dhe më jep seksin  
kërkon të hysh në lakuriqësinë e dytë  
po s'mundesh  
ajo s'është as imja  
as e zotit  
ai më ka zgjedhur veç si shkruet  
të gomarllëqeve të tij  
po ti gënjejesh  
s'kam qenë kurrë më i sinqertë  
se sa te ky varg fatalisti; hiq dorë prej meje!



po ti je grua  
s'ke shpirt, as zemër  
po një krimb që të bren  
kureshtjen  
e kanë këtë fat poetët!

## E ÇMENDUR ËSHTË KJO NDJENJË

e çmendur është kjo ndjenjë  
dhe te pemët  
dhe te ligatinat e pista plot me lyshtra ku mbin papritmas  
zhumbrica  
unë shkoj nga shkoj dhe kthehem sërish te këto lule ngjyrë  
gurë kali që kanë mbirë te një e çarë trotuari  
dhe ngjyra është si e larë  
dhe dielli si diamant pret në qiell pasqyra  
dhe unë nga një  
bëhem njëmijë  
dallga e oqeanit vjen në megapol dhe shtron mbi asfalt një  
blu saks të ndritshëm  
peshq me ngjyra me gjyslykë dielli  
mbathin këpucët e mia  
dhe marrin në dorëzim wall street-in  
që me kohë ka hyrë në ujë dhe bëhet më jeshil  
ka ardhur koha e dashurisë  
nistem dhe unë në takim  
s'i shpëtoj dot këtij zakoni të rinisë  
më ndjekin pas të gjithë drurët e nju jorkut  
zbathur i shkel trampit  
zyrën në down town  
zogjtë  
si tenor e soprano  
prej foleve dalin  
kërkojnë miminë e puçinit me një arie dashurie  
zgjidhni, thotë trampit, cilin grataçiel doni  
një papafingo piktori  
sa më afër qiellit  
i le zgjedhjet trampit  
e le dhe melaninë  
merr për grua një gjerëqinë që luan rolin e mimitisë  
e çmendur është kjo ndjenjë  
dhe te trampit  
si unë  
dhe ai  
nga një  
bëhet njëmijë

dielli si diamant pret në qiell pasqyra

## SHKRUAJ PËRDITË

shkruaj përditë  
kur s'shkruaj jam sëmure  
lexoj, përkthej, merrem me dokrra  
ja, që e zbulova sekretin  
rrallë e më rrallë, kur më ka buzëqeshur suksesi  
e kam huajtur frymëzimin e shenjtë  
ashtu fshehtas  
me një marrëveshje xhentëllmenësh  
në borxhe jam kredhur  
e di prej nga më vjen shkëndia hyjnore  
po s'kam ç'shpërblim të jap  
askush s'më kërkon t'ia kthej  
pres një ditë të më trokasim  
një mandat për gjyq të gjej poshtë derës  
po asgjë  
veç heshtje  
jam kredhur në borxhe të tmerrshme

të kishte honorare shkrimi  
të paktën honoraret t'i dërgoja  
një dorë me kacidhe  
po s'kam veç penë e letër  
paraja në amerikë s'vjen për poetët  
ulem dhe shkruaj si i çmendur  
vargje, vargje, vargje  
me një frymëzim të huajtur  
s'katranosa vetë asgjë të hajrit  
ç'më vjen e hedh në letër  
plagjiator i pashallur  
i vjedh atdheut mallin

## PO E HUMBJA

po e humbja si qytetërimin e vjetër balta dhe pluhuri  
veç sytë i kishin mbetur përjashta  
në një stinë të ndritshme  
kur mjelma blu e amerikës së veriut bënte dashuri në  
drurë  
me mjelmën e kuqe të amazonës  
pra, ishte pranverë  
po veç me një flatër  
tjetrën e kishe marrë ti nën dhe  
po humbje dhe sytë  
dhe hëna më s'do të dilte netve  
fshehur qepallave të tua  
dhe dielli  
zjarrin do të humbte  
prej syrit tënd që mbante ballancën  
s'kish më epshe  
qenë platur dhe tufanet  
deti me valë të vogla si buzë foshnjeje  
ai sy që po e vazhëronte botën  
kish kaq shumë poezi  
sa vetë esenini ish ngjallur  
me smoking dhe bastun në dorë shkante mospërmas  
parisit  
i dehur si maji kur kanë lulëzuar dhe hitrat  
ai syri yt ka mbetur ende pa e mbuluar krejt rrënojat  
vetëm ai sy mëngjesi  
ende pa dalë dielli  
kur hëna është nisur për në mbrëmje

## IRIS TË KUQ

s'të putha dot atëherë kur duhej  
tani që erdhi koha ti s'ke më buzë  
si iris të kuq që i zë vjeshta me furtunë  
i vyshk  
i këput  
buzët  
ia mora hua ëndrrës  
aq të bukura ishin  
sa më bënë fatkeq  
prej mungesës së mishit  
jo, s'isha asnjëherë poet  
s'të dashurova dot në ëndërr  
të doja të zhveshur  
gjinjtë përpjetë  
thithkat ndër dhëmbë  
kofshët që bëhen gërshtë e henes  
vagina zbuluar si misterit  
po s'qenë mish  
veç iluzion  
tani që erdhi koha e dashurisë  
na zuri vjeshta me re  
kur thahen irisët e kuq  
vyshken  
dhe këputen  
do të mësohem të dashuroj në ëndërr

## PREJ TË GJITHA DASHURIVE QË PATA

prej të gjitha dashurive që pata  
aq të shkurtra  
dhe gjithmonë në pranverë kur çelnin lulet  
atë mbaj mend  
prej mosvëmendjes  
as ma varte, as më bënte lajka;  
ah, këto kaçurrellkat e tua!  
s'më krahasonte me personazhe romanesh  
as poezinë s'ma lexonte  
as të bukur s'më quante  
për të gjitha këto dështime të mia

unë synova suksesin dhe e arrita  
s'ishte maj, po fund shtatori  
kur i dhurova karafilin e fundit  
një vishnje të errët  
me njëqind fletë të dhëmbëzuara  
që ishin gati t'i ngulnin dhëmbët çdo zemre  
dhe kundërmonthe më fort se channel  
e vuri në hundë  
dhe ishte e para herë që shpërtheu;  
o, ç'aromë e mrekullueshme!  
dhe më la që të puthja  
nuk kam parë dashuri si kjo  
që të mos të të duan!  
ja, ky ishte fillimi  
pastaj ajo u çmend për mua  
ishte gruaja!

### ORA SHTATË E MBRËMJES

ora shtatë e mbrëmjes  
unë shkruaj  
karrocet mondane të nëntëqindës kalojnë nëpër cirkuid  
kolomb dhe avenjunë e pestë  
çojnë zonjat në operan metropolitane  
mbushen restorantet dhe teatrot te avenju e shtatë  
në hotelet e famshëm të americas avenue dhe rockefeller  
center zonjat me kamelje mbushin dhomat e  
rezervuara  
nju jorku i ngjan një titaniku në oqean  
jo si tragjedi  
po si farsë  
ç'dua unë këtu, moj hënë?  
po ti çdo mbi këto rrokaqiej?  
në amerikë as një fustan s'të qepën  
të lanë fukara  
e kthej me fund dhe më duket se do të kem sukses  
kur më del pija dua t'ia heq vetes  
veç ti më qetëson  
kujtim i largët  
hipi tek ti dhe shkoj me shpejtësinë e zërit  
ora shtatë e mbrëmjes

### DAL NATËN TË NDEZ QIRINJ

dal natën të ndez qirin në varre, të zgjoj poetët e mi të  
varfër  
që s'e njohën famën, po mjerimin dhe turpin dhe barkun  
s'e mbushën me bukë  
dashuruan vargun më shumë se gruan dhe asaj më fort i  
kënduan  
famën e donin ashtu fshehtas, po qielli i tyre i mbyllur prej  
furtunës mbeti  
s'u hap njëherë qielli me njëmilion yje, për ta të pikonte të  
paktën veç njëri  
të marrë nëpër këmbë poetët e mi të varfër që veç  
ëndërruan një jetë më të mirë  
dhe dashuruan gratë më të bukura që asnjëherë s'ua  
vërsëllyen  
se ata xhepat bosh i kishin dhe të bukur s'i kish bërë natyra  
dal natën të ndez qirin në varre dhe shoh barin që është  
rritur, gramini dhe ferrat  
aty më tej gjarpri lëviz dhe një gjerëz ngrihet, më  
rrethojnë lypsarë dhe nëna të mjera  
që për një kacidhe janë gati të pastrojnë varret nga barërat  
e këqija  
t'i lajnë dhe t'i shplajnë mermerët që nxijnë, t'i nxjerrin në  
pah varret e poetëve  
nën hënë të shkëlqejnë dhe nën yjet që në supe atyre s'iu  
ranë, po veç shkëlqyen në supe kriminelësh  
një klithmë qyqeje dhe një furtunë dritash të kuqe vijnë  
prej qytetit të dafrungave dhe orgjive  
atje bëjnë qejf mashtruesit dhe rezilët që s'dinë ç'është  
rima apo ritmi në një poezi divinë  
po veç lexojnë markat e armëve dhe të makinave dhe i  
mësojnë përmendësh si poetët homerin  
unë dal natën të ndez qirin në varre dhe shoh poetët e mi  
si ngrihen vertikalisht mbi mermerë  
dhe më duken varret monumente që lëvizin dhe ajri i  
natës plot me yje sikur në qiej lart i ndih  
u desh të vdisnin që të kishin dhe ata monumente, paçka  
se nuk duket njeri  
dhe lule nuk sjell askush, veç ferra dhe gramini i ka  
mbështjellë, si një hakmarrje  
i kanë harruar poetët, se sot s'këndojnë të vërtetët, po  
kuakin bretkosat në moçale  
dal natën të ndez qirin në varre, të zgjoj poetët e mi të  
varfër  
t'iu them se monument s'kishin në gjallje, po kanë në  
vdekje varret!



### FATI I KEQ I POETËVE

Frederik Rreshpjes

fati i keq i poetëve që e kanë në ballë shkëndijën  
e një ylli plot shkëlqim  
po s'i duan prej këtij ylli ata që s'e kanë dhe ata janë shumë  
po yjet i duan  
se budallenjtë nuk ngopen me yje dhe e kanë mbushur  
pazarin e tyre me yje të gënjeshtërt  
s'kanë fat poetët, se në gjallje dështojnë  
dhe në vdekje, ç'ju duhet lavdia?  
i poshtëruan  
i fyen  
i morën nëpër këmbë  
i treguan me gisht si të çmendur që s'dinë ç'është jeta  
se nuk e vrasin për modë dhe arturina  
për pazare tavolinash të pista  
merren me veten  
që e kanë lidhur me fije peri të shenjtë me engjëjt në  
eternita  
dhe rrinë shtrembër në ajër  
shkojnë në anën e kundërt të nderit dhe zakonit  
s'i njohin ligjet tokësore  
dhe armiqtë i ndjekin  
armiqtë e panjohur të rregullit  
të shturur janë bohemianët e mi  
dhe varfëria pas i ndjek si qen  
aspak të kujdesshëm kur paraqiten në festa që i urrejnë  
prej falsitetit  
se s'dinë të kujdesen  
maskën e hipokrizisë nga fytyra duhet të mos e heqin  
as buzëqeshjen servile  
kurrizin të thejnë  
e fjalët t'i zgjedhin  
për zhaptrashët e pushtetit  
gafa bëjnë  
dhe mëkate  
ata e dinë ç'heqin  
të pakorigjueshëm janë si kriminelët  
edhe sikur t'iu vënë litarin në fyt dhe t'iu varin  
s'pyesin për vdekjen, po për vargun  
kjo i çmend vulgarët  
ç'racë prej të marrësh!  
kot rroni në këtë botë trutharësh, o poetët e mi të qiellit  
më mirë shkoni lart  
trokisni në blunë e ndritshme të hapësirës  
prisni të hapet për ju  
dhe të zhduken!  
s'është kjo tokë e fëlliqur për shpirtbardhët  
se këtu rrojnë zuzarët!  
dhe gratë s'iu duruan

ju lanë  
fëmijët ju përbuzën se ju s'nxorët para  
dhe me vargun tuaj u tallën ziliqarët  
miqtë armiqtë tuaj  
se ata i trembte ylli  
në ballin tuaj të lartë!  
të ndohtë jeni  
dhe me zhele e shtyni  
s'utë parfum  
për ju  
gjer në fund harxhuan aromën lulet  
buka iu dha dhe lypësit  
për ju  
s'kishte!  
rrugëve ju lanë të zvarriteshit  
të mos gjenit kurrë qetësi  
dhe strukjen  
diku  
prej dhimbjeve mbledhur grusht  
jua përgjuan  
vdisni shpejt, të shpëtojmë prej jush  
s'iu duam!  
po lapsin e thyer harruan  
dhe letrën e zhubrosur  
ku ylli juaj kish pikuar  
nuk ju përcollën për në banesën e fundit  
po pinë sa u bënë thumb  
dhe ju shanë  
dhe ju mallkuan  
po a shahen, a mallkohen të vdekurit?  
ju e bëtë! prandaj vuani  
dhe s'e doni veten  
kur vargu i poeteve gjëmon me dritë aureole  
dhe ju s'keni ç'ti bëni  
të mundur jeni  
po hiqeni fitimtarë  
ju  
dështakë të përjetshëm  
eternitaja  
dhe qielli  
dhe engjëjt  
dhe gjithë ç'përmban libri i librave, bibla  
janë të poetëve  
ju tavolina e pistë ju ka mbetur  
gota e rakisë  
dhe kënga  
për cicat e mëdha të didisë me tallava  
kur ju kujtojnë poetët  
ju bie damllaja!  
kështu u ndanë punët  
dështakët pa yll në ballë gëzojnë jetën  
përjetësinë poetët!

Një ndër kujtimet e bukura nga Tepelena ishte kur na vinin miqtë e dajës për darkë e nëna niste përgatitjen që në mëngjes dhe e merrte me shumë pasion atë punë. Fillonte të gatonte specialitetet e saj, që gjithmonë e kishin bazën te mezet, të cilat për të ishin fillimi i mirë i çdo tryeze të bollshme. Në fakt, kishte të drejtë, sepse ajo që provon së pari në tavolinë të jep përshtypjen kryesore për vlerën e ushqimit. Gjyshja përgatiste meze nga më të ndryshmet, sigurisht me ato ushqime që gjendeshin në tregun e kohës. Për shembull, bënte një si pure të ftohtë me patate, një tjetër me fasule, të cilave u hidhte hudhra e i zbukuronte me piper të kuq dhe majdanoz. Herë i vendoste në pjatancë e herë mbi feta buke. Bënte meze me ç'të gjendej, por erëzat, arrat, hudhurat dhe majdanozin nuk i ndante. Zbukurimin e pjatave e kishte merak vetë dhe gjithmonë më thoshte: në më të shumtën e herës ha syri më shumë se stomaku. Të gjitha këto darka të shtruara me delikatesë përfundonin me një ëmbëlsirë të thjeshtë që ajo e quante rulo, pasi ishte një pandispanjë e hollë e mbushur me reçel, që e mblidhte rulo me letër derisa të ftohej. Më pas e priste në 27 iris halili feta të holla dhe ajo shtrohej shumë bukur në pjatancë dhe shërbehej si një ëmbëlsirë që i shkonte për shtat një darke të rëndë. Këto meze të nënës, ëmbëlsirat e saj e shumë receta të tjera mbetën gjithmonë në librin tonë familjar të kuzhinës që e mbajmë si një trashëgim prej saj. Unë besoj se çdo trashëgimi është e vlefshme, se mbart brenda saj dashurinë, historinë dhe kujtesën e njerëzve të dashur. Pronat janë trashëgimi ku mund të jetosh, të shpenzosh kohën e të kujtosh familjen, festat apo edhe muret brenda të cilave kanë folur të parët e tu dhe që vetvetiu përcjellin nostalgjinë që na lidh natyrshëm. Po kështu këshillat apo porositi e lëna nga të parët na vijnë dhe lihen po ashtu si një trashëgimi që në çaste të caktuara na ndriçon rrugën apo na bën të ndihemi krenarë për largpamësinë e të parëve tanë. Veprat e mira heroike apo bamirëse të të parëve janë pa dyshim trashëgimia që nuk vdes kurrë, se lë gjurmë në histori apo zemrat e njerëzve. Nga ana tjetër, recetat familjare të gatimit janë edhe ato trashëgimi, pasi duket sikur të rikujtojnë më shumë se çdo gjë çastet e shijuara me njerëzit e dashur si dhe janë si një glorifikim modest për to, por edhe kthehen si një trashëgimi shumë shpirtërore, pasi duke i gatuar përherë e më shumë këto receta duket sikur dalin nga enët e së shkuarës dhe mbajnë gjallë të ardhmen duke e rikrijuar atë si dikur. Dhe kështu libri familjar me receta gatimi shtohet çdo ditë me recetat e nënës, mamit apo edhe miqve të tjerë sipas titujve: "Sallata e Dianës", "Fërgesa e mamit", "Qoftet e Valit". Me recetat e kudogjendura në internet, edhe kjo traditë e recetave familjare dhe miqësore po zbehet dhe shpirtërorja gjithmonë e më tepër po ia lë vendin sipërfaqësore. Megjithatë, ende aty-këtu dikush poston apo boton "recetat e nonna-s" pasi ato janë më të mirat, sikurse është përkushtimi i pazëvendësueshëm i gjysheve që na e mbushnin tryezën gjithmonë me shumë dashuri. Kur vizitova Spanjën para shumë vitesh, hymë në një restorant të famshëm të Barcelonës që njihej për tapas. I gjithë restoranti kishte një si tryeza gjigante me të gjitha llojet e tapas, rrethuar me tavolina të vogla që



qarkonin të madhen. Ishin të shijshme vërtet, por ajo që bëja lidhjen ishte që mezet e nënës sime provuar tridhjetë vjet më parë ishin pikërisht tapas, vetëm se ne nuk i quanim kështu. Sa e sa shoqe të miat i kanë provuar ato meze, sidomos në vitet e gjimnazit në Tiranë, kur unë festoja ditëlindjen edhe dy apo tri herë në vit vetëm për t'u mbledhur dhe për të kërcyer në një kohë kur ende nuk kishte klube apo bare për rininë. Batanijet në dritare shërbenin për të krijuar errësirën, mezet e nënës ishin tapas dhe një magnetofon me kasetë luante pa pushim Modern Talking. Si pije kishim vetëm ujë çezme. Ishim shumë të varfër në çdo gjë dhe sigurisht, edhe në argëtimet tona. Megjithatë, nuk na duhej alkooli që të vinim në qejf. Ishim të varfër, por platonikë; nuk kishim telefon, por kishim fishkëllima; nuk shkruanim në kompjuter, por kishim ditarë ku ndjenjat tona i dinim vetëm ne dhe jo gjithë interneti. Unë dhe motra ndoshta kishim pak më shumë, si "gocat e doktorit". Për shembull, një

telefon në familje që doktorëve u duhej për shërbim apo ca fruta a zarzavate të freskëta që fshatarët i sillnin si respekt për babain tim që nisej në çdo orë të ditës a natës për t'u shërbyer. Të tjerat ishin pothuaj njëlloj. E vetmja gjë që mund të xhelozojë në kohën e komunizmit ishte merita apo intelijenca personale, bukuria fizike, trashëgimia familjare apo pozita partiake. Këto ishin arsyet që i bënë njerëzit xhelozë dhe i kthenin në armiq të njëri tjetrit. Dhe këtu fillonte lufta e klasave, ku vëllai spiunonte vëllain, burri gruan, shoku shokun dhe e keqja, siç thoshte nëna, "të vinte nga nuk e pandehje". Midis miqve dhe njerëzve të mirë kishte edhe nga ata që na afroreshin jo se na donin, por se kishin një mision – të na shkatërronin. Ose edhe vërtet na donin mendjen dhe aftësinë, apo edhe na adhuronin, por, sikur ndodh rëndom, pavarësisht se në çfarë sistemi apo shoqërie jetojmë, në fillim njerëzit të afrohen se të adhurojnë mendjen, stilin apo personalitetin, më pas fillojnë të të imitojnë. Imitimi, shumë



herë më shumë se miqësi e sinqertë, është dëshirë e sëmure për të arritur subjektin e imituar. Nëse fillojnë të të imitojnë, shumë shpejt do të të kthehen kundër dhe nga "adhuruesit" më të denjë do të shohim "ziliqarët" më të rrezikshëm, kjo pasi njeriu që të imiton kërkon t'i vërë vetes apo të arrijë atë që s'e ka apo s'e ka pasur tërë jetën dhe kur sheh që imitimi i tij është i dobët e nuk arrin t'i afrohet dot modelit që imiton, e kap një xhelozë dhe një inat i brendshëm, e sundon një hakmarrje verbuese dhe pikërisht në ato momente fillojmë të kuptojmë arsyet e vërteta të afrimit të mikut a mikeshës që na imitonte apo vazhdon të na imitojë.

Gjyshja ime harxhonte gjithë ditën për t'i përgatitur darkat e shijshme Thanasit dhe disa miqve të tjerë të dajës, emrat e të cilëve pas kaq shumë dekadash nuk më kujtohen të gjithë. Por kjo nuk e pengoi Thanasin dhe një tjetër shok të dajës t'i dilnin dëshmitar në gjyqin e shtirur komunist. Nëna tregonte që Thanasi kishte thënë në gjyq se Hajredini ka parë fshehtas stacionet e televizionit italian më 1971, në atë kohë kur ne as që kishim televizor. Ndërkohë, ironia ishte që në gjyq kishte veshur xhaketen që daja dikur e kishte hequr nga trupi dhe ia pati falur. Xhaketa në trup të Thanasit asnjëherë nuk më është shqitur si detaj i tradhtisë dhe mosmirënjohjes. Si mundet një njeri të përpiket të të fundosë dhe ndërkohë të mbajë në trup dhuratën tënde? A është ky një fetishizëm sadist? Mos është një karshillëk i tipit "ja si më shkon xhaketa jote" teksa po të fundos plotësisht duke përdorur gënjeshtërën për të fshehur dobësinë më të madhe njerëzore, xhelozinë, më të madhen e të gjitha kohëve, atë dobësi që kap nga njerëzit që duhen çmendurisht apo miqtë që kanë kaluar një jetë bashkë, deri te dashuritë më të forta, si vëllai për vëllain, motra për motrën, prindi për fëmijën apo fëmija për prindin?! Xhelozia, ky ushqim i inferiorëve! Pikërisht xhelozia njerëzore ka arritur të krijojë edhe ideologji dhe sisteme të panumërta që kanë sunduar dhe keqtrajtuar, dëmtuar dhe zhdukur gjenerata të tëra. Marksizmi ishte një e tillë që u instalua në pushtet politik dhe u brumos në mënyrë jetese në miliona njerëz në çdo cep të botës e u njoh si komunizëm, apo te ne si enverizëm, duke marrë kështu emrin e udhëheqësit që drejtoi komunizmin në vendin tonë, duke i bashkëngjitur gjithashtu sublimimet më të errëta të shpirtit të tij sa paranojak aq edhe katran. Darkat e bukura të nënës në Tepelenë përfunduan atë fund shtatori të vitit 1979 kur dajës tim tridhjetenëntëvjeçar i vunë prangat. Unë kisha filluar ndërkohë klasën e dytë fillore në Tiranë dhe isha kthyer te prindërit. Nuk di si ndodhi ajo ditë, vetëm kujtoj se si sa hap e mbyll sytë nëna erdhi në Tiranë me disa valixhe rrobash dhe mua e motrën na thanë: "Nëna tani do të jetojë me ne."



Ka ardhur koha që rrugëtimi artistik të piktores Mimoza Arapi mjafton të shkruhet me pak fjalë, sepse tashmë gjurmët e këtij rrugëtimi janë të shënuara në veprat e saj. Ajo është një piktoreshqiptare me mbi 30 vite karrierë artistike, që e ka zhvilluar në pjesën më të madhe jashtë Shqipërisë, kryesisht në Greqi dhe në vende të tjera të Europës. E diplomuar në Universitetin e Arteve të Bukura në Tiranë dhe për letërsi, Mimoza Arapi ka krijuar një profil të dyfishtë artistik – vizual dhe poetik.

Veprat e saj janë ekspozuar në një numër të madh galerish ndërkombëtare, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-të, Italinë, Greqinë, Austrinë e më gjerë.

Më herët jam njohur me dhjetëra vepra të Mimoza Arapit, por ekspozita që çeli në Vjenë, Austri (2025), ishte një ftesë e mirëfilltë për një lexim më artistik të veprave, të cilat krijojnë një rezonancë të ngrohtë në syrin e vizitorit, me shpërthimin e lirë të ngjyrës dhe emocionit, ku forma nuk është e imponuar, por lind nga energjia e brendshme e aktit krijues.

Në këtë ekspozitë Mimoza Arapi u paraqit me një univers vlerash artistike, ku ngjyra çlirohet nga çdo kufizim formal dhe shndërrohet në një gjuhë të pavarur shprehjeje. Në këto vepra, abstraksioni nuk është një largim nga realiteti, por një zhytje më e thellë në emocion, në kujtesë dhe në ndjesi. Gjestet e lira të pikturimit, shtresëzimet e guximshme dhe kontrastet e forta krijojnë një tension harmonik, ku kaosi organizohet në një rend të brendshëm estetik.

Aty shfaqet një cikël veprash që ngjizen nga fërgëllima e shqisave, lëvizjeve të buta e të lirshme të penelit, për të prodhuar më pas kontraste të forta ekskluzive me blunë, të verdhën, të kuqen, rozën, shpesh me ngjyra të derdhura.

Ngjyra në pikturën e Arapit nuk ilustron, por rrëfen, duke u shndërruar në subjekt që lëviz, rrjedh, merr frymë; ajo është gjendje, impuls dhe narrative njëkohësisht.

Në tablotë e saj vihet re transparenca dhe shtresëzimet medituese që krijojnë një urë mistike të kalimit nga vëzhgimi në interpretim, në ndjesi, duke u zhytur më tej në thelbin e saj estetik.

Edhe pse veprat janë abstrakte, ato janë paraprirë nga ndjesia e një peizazhi të

## Piktura e Mimoza Arapit, një urë mistike e kalimit nga vëzhgimi i epërm në interpretim

Nga Dhurata Hamzai




brendshëm të autores, që pasi “rërbejnë” dritë në telajo sugjerojnë figura në transformim, duke lënë hapësirë të mjaftueshme për interpretim emocional. Në procesin e interpretimit magjeps edhe teknika e përdorur me spërkatjet e ngjyrave, derdhjet me delikatesë të bojës, gjurmët e shpejta të furçës.

Piktura e Mimoza Arapit ka një energji shumë të afërt me frymën e ekspresionizmit abstrakt, ku akti i pikturimit është edhe më i rëndësishëm sesa rezultati. E gjithë tabloja ndërtohet përmes një procesi intuitiv, duke u bërë një refuzim formave të tepruara akademike. Ky gjest krijues e përfron me artin e veprimt (action painting).

Arapi tashmë ka një dorë të stërvitur, ku arrin të kontrollojë të pakontrollueshmen. Megjithëse në pamje të parë veprat duken si përjetim kaotik dhe krijime spontane, ato ruajnë një gravitet vizual dhe një balancë mes zonave të dendura dhe boshllëkut, dhe sidomos një ritëm të brendshëm që e mban syrin në lëvizje.

Në të njëjtën kohë, arti i saj kapërcen kufijtë e telajos, duke u shndërruar në element dizajni, siç dëshmojnë edhe aplikimet e saj të përzgjedhura më herët nga industri të modës, ku piktura bëhet pjesë e jetës së përditshme. Ngjyrat dhe veprat e Mimoza Arapit janë bërë prej shumë vitesh pjesë e industrisë së veshjes VIDA. Bashkëpunimi me këtë kompani



nisi pas një ekspozite në Londër, ku veprat e saj u kërkuan për t’u transformuar në një dimension tjetër artistik, duke u shfaqur në veshje si krijime origjinale të një artisteje shqiptare.

Ndryshe nga brishtësia e shfaqjes së karakterit të artistes, fshihet brenda veprave të saj një konstrukt ekzistencial, i cili formohet pikërisht në çastin kur ai zhvendoset përtej dimensioneve të njohura, duke marrë si bazë një lidhje të fshehtë poetiko-metafizike të njeriut me versionin e tij më të përkryer.

Në këtë mënyrë, konkretizimi kozmologjik i objektit shfaqet nga një lloj energjie krijuese e cila e sfumon imazhin dhe e mbush veprën me një temperament poetiko-muzikor. Është kjo energji e akumuluar, që hap rrugën për një organizim shprehës figurativ intuitiv, thuhet “jashtë ligjeve”, përtej kanuneve të formës klasike, duke krijuar një tipologji të re të figuracionit abstrakt.

Në këtë nivel, vepra artistike vëzhgohet sipas një mënyre të re bashkëpunimi me shikuesin. Në prizmin analitik, ajo zbërthen një “bërthamë” ku rrezatimet e ngjyrave marrin nuanca të holla kuptimore, shpesh në kufirin e të prekshmes dhe të paprekshmes, duke krijuar një tension të vazhdueshëm perceptiv.

Vizionet e artistes Mimoza Arapi transformojnë të pazakonshmen dhe irrealen në një realitet të mirëfilltë artistik. Nëpërmjet një procesi të pandërprerë transformimi, dinamizmi unifikues i substancës ngjyruese shndërrohet në kërkim të vazhdueshëm, duke marrë trajtat e një simbolizmi të thellë dhe misterioz.



Mbasi Kisha e vjetër ishte boshatisë Medhe prej thasëve të fundit të drithit, gra e burra kishin zhgreh kush e kush ma shpejt me fshesa, me kova me ujë e shtupa leckash në dorë, me fshi e me pastrue. Gratë, me zell të madh e me ngut, gjithësecila i gjente punë vetes. Dikush nga fundi pastronte dyshtemenë e shtrueme me rrasa guri të gdhenuna, dikush tjetër aty te elteri e do djem ma t'ri merreshin me dyer e me dritare, tue i qërue ma parë prej pluhnit të bamë koje e l'mashkut që i kishte mblue...

Kur ishin mbyllë kishat, ajo qe kthye në magazinë drithi e kështu kishte shërbye për 23 vjet rresht... Muret e trasha prej guri të gdhendun të lidhun me fugat e përdredhuna, që vizatonin format e lakueme të gurëve fasadës në interierin e kishës, nuk qenë tjetërsue. Po ashtu edhe së jashtëmi, me perjashtim të katër sipërfaqeve suvaje drejtkandëshe simetrike, të baraslargueme nga njena - tjetra që, me cepat e premë hark, ngjanin si brisqe rroje *astra* të stërmadhueme. Mbasi qenë suvatue ishin lye me gëlqere dhe mbi to atëherë ishin shkruie parulla, të cilat, përgjatë dy dekadave të fundit kishin xhirue në kujtesen e vendasve si në një bobinë filmi dokumentar, tekstet e të cilave transmetonin thekset ideologjike, që ishte dashtë t'u kumtoheshin atyne, në varësi të rrethanave që krijoheshin. E t'u nguliteshin thellë në nënndërgjegjen e tyne. Po parulla që s'kishte ndryshue asnjëherë aty, qysh se qe shkruie për së pari, ishte: "Feja është opium për popullin". Edhe tash mbas kthimit në identitet të kishës, parullës ende nuk i kishte ardhë rradha me u heqë.

Përbrenda, gratë që pastronin, ato më të moshueme shqiptonin me kantilenë, po të inonueme **Falemimarinë**: Për herë të parë me za, të çlirëshme e pa kurrfarë droje. Si sfidë ndaj heshtjes së kamuflueme të shpirtit besimtar të ndrydhun.

*T'falemi Mari hirëplote, Zoti me ty  
E bekueme je mbi të gjitha gratë  
e i bekuem asht fruti i barkut tand,  
Jezusi.*

Deda, mocatar me tá i bashkëngjitej zanit të korit me të njëjten kantilenë veçse me tekstin në latinisht:

*Ave Maria, gratia plena, Dominus tecum  
est, benedicta es tu in omnibus  
mulieribus,  
et benedictus fructus ventris tui, Jesus.*

Deda kishte ndihmue priftin asokohe kur mesha thuhej përbotshëm në latinisht. E përposë se nostalgjia, shumëçka tjetër e kthente në atë kohë, edhe pse Konçili i dytë i Vatikanit, i cili mbyllet një vit përpara se me u mbyll kishat te ná, kishte pasë vendosë që mesha të mos kremtohet ma në gjuhën latine, por në gjuhët vendase.

Kurse, një grup i grave mã të reja e vajzat që pastronin, ia kthenin lutjen në shqip, po ashtu me kantilenë tue i zgjatë fjalët e thekset:

*Shejtja Mari nana e TenZot  
lutu për ne mëkatnor't,  
tash e në fill të mordes sonë  
Ashtu kjoftë!*

# FRANO KULLI

## Mea Culpa e Kel Parubit

Tregim



Të çlirëshme, të përtrime si këndellja e gjithçkaje në muajin e parë të pranverës; gati në ekstatë...Ishte e marte dhe të djelën do të kremtohej mesha. Tre besimtarë, të primë prej Dedës i kishin shkue në Shkoder Pader Benardit, në shtëpinë e së motrës ku banonte me bisedue me të. Athue do ta kishte mundësinë me ardhë ?!... Ishte i vjetruem e ma fort i lodhun prej burgimit të gjatë e tash i xanun sa s'ka me shërbesat e reja sakramentare. U kishte thanë se do të vinte fill mbasi të kremtonte meshën në Suka. Ishte caktue ora 12. Ndërkohë, mbrenda kishet, gjithçka ishte pastrue, por, prapë ishin gjithë ato punë të tjera që duheshin me u bá. Dikush solli tavolinën e bukës, e e çuan në elter. Format i saj me syprinën drejtkandëshe i përshtatej vendit ku kishte me u vendosë. Përsipër i vunë një sofrabez, që e kishte sjellë Xhina, në thurjen e të cilit dominonte e bardha. Një e bardhë, pak e përlume me të verdhë, si në oker. Sofrabezi varej deri poshtë, një shplakë përmbi dyshteme, tue i dhanë kështu hijen e meritueshme elterit. E paprituna ishte kelk shejti, që solli Marija. Ajo kishte mujtë me e tërheqë atëhere prej remeve të tjera, që ateistat entuziastë i hidhshin rrëmujshëm asokohe, bashkë me librat e shejtë e gjithçka tjetër. E e kishte vendue në fundin e arkës së vet, poshtë teshave të dekës. Me fuguret e familjes së Shejtë, të Nanës së Këshillit të mirë e të Jezusit fëmijë, i kishte strukë edhe ato. Kurse Vojnat e Shejtë, i kishte mshehë diku që veç ajo e dinte. Ato të paktë që kishin mbetë, mbas sakramenteve që ajo i bante tinzash. Histori në vedi kjo e Vojnave. I kishte sjellë dom Deda me Tushin prej dom Ivos së Shëngjergjit. E kishin kalue lumin me lundren e vogël, pa ju hi ferrë në kambë, për fat. Ishin nisë pak mbas mesnate e për një çerek ore kishin mrrit në bregun matanë, pa u vu re prej rojeve të këndejshe të kufinit. Edha atyne matanë nuk u kishin

ra në sy e kështu, mbasi kishin ecë edhe ma pak se gjysë ore ja kishin behë te qela e dom Ivos. Ishte natë e errët e binte shi, si don Zoti. Kishin qëndruie jo ma shumë se një orë me të e pak para se me zbardhë morën rrugën e kthimit. Mrritën ende pa zbardhë, shëndosh e mirë deri sa hynë në katund. Kishin kalue nëpër birë të gjylpanës, po s'kishte qenë e thanë me shkue vaj deri në fund puna e Vojnave të Shejtë. Dikush i kishte vrojtue e kishte njoftue njësitin kufitar... Kishin shkue te Qela e kishin marrë së pari dom Deden. E kishin lidhë duarsh; prej aty te shpija e Tushit e të njejtën gja kishin ba edhe me te. Mandej të dy i kishin marrë e plasë mbrenda në burg. Po Vojna kishin shpëtue...

"Tashma s'mund t'i besohej këmishës në shtat"- e përsëritte ritualisht Marija, qysh atëherë e gjithëherë atyne kohëve...

\*\*\*

Erdhi e djela, një ditë me mot të kthjeshtë e të ngrohtë. Oborri i kishës i mbushun plot e përplot me njerëz. Të dalë prej dimnit të gjatë, të mpitë e të ngrysun, atë ditë fytyrat e tyre gjallnonin posaçe...Si vetë natyra e stina, që ka herë s'kishte sjellë kaq ndezull në zemrat e tyne. Kel Parubi kishte ardhë shpejt, ndër katër a pesë të parë e kishte zatetë edhe ai në oborr krahu tyne.

- Nadja e mirë - kishte përsëritetë - po si keni ndjeh ?

- Mirë se të bjen nadja, i ishin përgjigjë me një gojë ata, tue e pezullue për pak bisedën. E gjitha aty ngjante me një mizanskenë teatri të kohës së zanafillës së teatrit në oborret e shprijave të Shkodrës. Mandej mërritën njëni mbas tjetrit burra, gra, të rinj e fëmijë e oborri u mbush. Me të thanë mendja se s'kishte mbetë kush n'shpi. E me të vërtetë, përveç ndoj plaku e plake që nuk mund lëvizte s'kishte mbetë kush pa ardhë...

Ra kumbona për fillimin e meshës...  
*Tingujt e kumonëve s'kishin prajtë*

*asnjëherë. Njisoj si cicërimat e zogjve e kangët e bylbylave në pranverë kur, degët e shelgjeve vareshin mbi ujin e kthjelltë të lumit e shumoheshin prej pasqyrës së tij. Në bregun tjetër të lumit që ndante dy botë kompanjeli i Kishës së Shëngjergjit ndihej njësoj edhe këndejt...*

Kumbonen e kishin kacavjerrë mbi degën e trashë të frashnit të madh, në oborr. Trungu i tij, që për fat s'e kishte kapë spata, nuk mund të qarkohej as prej dy pash burrash krahhapët. Askërkujt prej tyne nuk i kishte bâ zemra me përdorë spatën mbi të. E kishin rikthye dhe vendosë aty prej repartit ushtarak në kodër. Histori në vedi edhe kjo se si kumbona kishte shpëtue e nuk qe dërgue në fonderinë e shkrimjes, në uzinën e Rrencit, afër qytetit. Dikush e kishte çmue utilitetin e saj, kështu siç ishte, pa e prekë aspak. Ky kishte qenë komandanti i repartit ushtarak kundërajror, që ishte në majen e kodrës sipër katundit. Ai vetë kishte ardhë me tre ushtarë, e kishin ngarkue në zis dhe e kishin përcjellë në repart. Aty e mbasandej tingujt e kumbonës kishin zgjue rregullisht alarmet e repartit...  
*Thuhej se ajo qe sjellë nga Venecia ma se njëqind vjet ma parë. Me material tunxhi të përziem e derdhun atje, me fuguren e Jezusit të kryqëzue të vizatuem në faqen e jashtëme të harkueme e të lëmuet të saj, ajo lëshonte tingujt të zgjatun që përhapeshin me jehonë...Në rezonancë me tokën e qiellen...*

Besimtarët kishin lëshue oborrin dhe kishin hy në kishë. Fillon mesha. Me paqe e përsipirtni e me lutje të përplotuna. Prej shpirtit të ndryshun e prej nostalgjisë. Në fund meshtari jep bekimin, riti përmbyllës: Mesha u krye, shkoni në Paqe !

- Falënderojmë Hyjin - përgjigjen njëzashëm besimtarët dhe meshtari ban me u largue nga elteri. Atëherë po ndigjohet një za, që pezulloi lëvizjen e gjindjes:

- Me leje - shqipton ai, tue e shoqnie kërkesën me ngritjen e dorës. Asht Kel Parubi ! Meshtari ndalet, Keli ban disa hapa përpara e del në krye ; zen vend në njënen anë poshtë elterit, prej kah mund të komunikonte njëherësh edhe me besimtarët edhe me priftin:

- Vllazen e motra - e fillon Keli kumtin e vet. Besimtarët ndalin, bisedat e zhurmshme ndërpritin prejherit, bie aso heshtje, që nuk ndigjohet as miza. Hësht edhe meshtari.

-Unë i kam dy fjalë me i thanë sot para jush. Do e dinë se çka e do e marrin me mend...Tushi, pati ra puna me ba edhe burg... Kam kenë i shtërnguem o me ba ashtu, o me shku edhe unë si ata. E bashkë me ta... Me shpirt e me zemër nuk kam dashtë e jam ruejt me bâ sa ma pak dam. Per ket deshta me u rr'fye sot n'ket ditë të lume, të dashtun vllazen e motra. Para jush e para Zotit !- Mbasi përshkon me sy krejt njerzinë në kishë, çon pak kryet nalt me sy prej elterit, e zbret ngadalë e, masandej e shpërndan shikimin cep e n'cep të kishës. - I kërkoj të falun secilit prej jush në ket ditë të shëjte për ne. Megjith shpirt ju kërkoj të falun ! - e mbylli Keli fjalën e prap zu vend heshtja. As prifti nuk foli. Dy gra u panë tue fshi pikat e lotit...

- Falë kjoshe e Zoti t'faltë, Kel ! - u ndigjue zani i Tushit. - Unë e kam ditë se atje e kam pasë vendin edhe pa padinë tande.

**K**a vepra që lindin nga një jetë e qetë në dukje, por që arrijnë të depërtojnë në strukturat më të thella të përvojës njerëzore. *Krenari dhe Paragjykim* i Jane Austen është një prej tyre. I shkruar nga një autore që nuk u largua pothuajse kurrë nga rrethi i saj familjar dhe provincial, romani krijon një univers që tejkalon kufijtë e kohës së vet dhe vazhdon të mbetet një pasqyrë e tensioneve themelore midis femrave dhe shoqërisë së atëhershme.

Jeta e Austen-it vetë është në kontrast domethënës me kompleksitetin e veprës së saj. Vajza e një famulltari, e lidhur me një familje relativisht të begatë, ajo jetoi pothuajse gjithmonë brenda sferës familjare dhe nuk u martua kurrë, pavarësisht një momenti të rrallë kur pranoi një propozim dhe më pas e refuzoi. Vdiq në vitin 1817 nga një sëmundje që sot identifikohet si *Addison's disease*, ndërsa një pjesë e madhe e korrespondencës së saj u shkatërrua nga e motra, duke lënë të pazbuluar shumë nga eksperiencat e saj personale. Megjithatë, ajo që mbetet është një vepër e përqendruar: gjashtë romane, të botuara fillimisht në mënyrë anonime, që kanë ndikuar thellësisht në formësimin e romanit anglez siç e njohim sot.

Në këtë kontekst, *Krenari dhe Paragjykim* (1813) shfaqet si një tekst kyç jo vetëm për tematikën e tij, por edhe për strukturën narrative që propozon. Në qendër të romanit qëndron marrëdhënia midis Elizabeth Bennet dhe Mr. Darcy e cila nuk është një histori lineare dashurie, por një proces transformimi reciprok. Të dy personazhet kalojnë përmes një rishikimi të thellë të vetes dhe të tjetrit përpara se të arrijnë një harmoni përfundimtare. Në këtë kuptim, romani artikulon tensionin midis pritshmërive shoqërore dhe vlerave personale, një tension që mbetet thelbësor edhe për lexuesin bashkëkohor.

Shoqëria që përshkruan Austen nuk është një koncept abstrakt, por një realitet konkret, i rrënjësor në jetën e përditshme të një komuniteti të vogël. Marrëdhëniet shoqërore janë të gjithanshme: ato mund të përjetohej si detyrim, si kënaqësi apo si rrezik. Prania në jetën shoqërore nuk është neutrale; ajo kërkon vazhdimisht balancimin e interesave personale me normat kolektive.

Romani nuk ndalet në përshkrimin e shoqërisë; ai e vë atë në diskutim. Austen sugjeron se vlera e individit nuk mund të reduktohet në përputhjen me kodet shoqërore. Përkundrazi, energjia individuale, vetëdija dhe aftësia për reflektim bëhen elemente kyçe për një ekzistencë autentike. Kjo dialektikë e pjesëmarrjes shoqërore, midis konformizmit dhe individualitetit, është thelbësore për të kuptuar kufijtë dhe përgjegjësitë e shoqërisë në roman.

Një nga risitë më të mëdha të Austen-it qëndron në teknikën narrative. Dominimi i ndërgjegjes femërore është i dukshëm: pothuajse çdo skenë tregohet përmes përvojës së grave, veçanërisht të Elizabeth-it. Kjo realizohet përmes përdorimit të "ligjëratës së zhdrejtë të lirë", një formë rrëfimi ku zëri i narratorit ndërthuret me mendimet e personazhit, duke krijuar një perspektivë hibride mes vetës së tretë dhe përjetimit të brendshëm. Lexuesi nuk ka një narrator të gjithëdijshëm klasik; ai ndjek një vetëdije në zhvillim, me të gjitha kufijtë dhe gabimet e saj.

Tematikisht, romani ndërton një rrjet kompleks ku përvoja e grave është qendrore, por gjithmonë në ndërveprim me strukturat e pushtetit mashkullor. Dashuria dhe martesja nuk paraqiten si ideale romantike të pastra, por si procese të ndërlikuara ku ndërthuren ndjenja dhe interesa ekonomike. Paraja dhe prona janë gjithmonë të pranishme; informacioni mbi të ardhurat dhe pasurinë e personazheve nuk është dekorativ, por thelbësor për të kuptuar vendimet e tyre.

## Dashuria, gjykimi dhe rendi i padukshëm shoqëror: një rilexim i romanit *Krenari dhe Paragjykim*

Nga Anja Levanaaj

Studente e masterit Letërsi Krahasuese në King's College London

Ai trajton në mënyrë kritike edhe edukimin dhe rolin e grave në shoqëri. Jane Austen vë në dukje kufizimet e një edukimi që i mëson gratë më shumë "arritje" sipërfaqësore sesa zhvillim intelektual, siç shihet në debatet në Netherfield mbi atë që përbën një grua "të arrirë". Në këtë pikë, qëndrimi i Darcy-t afrohet me idealet e Mary Wollstonecraft, duke theksuar rëndësinë e formimit moral dhe intelektual mbi aftësitë dekorative. Po kështu, romani vë në pah edhe kufijtë e martesës si institucion: figura e Mrs. Bennet mishëron një vizion të ngushtë dhe utilitar të rolit të gruas, ku ambicia reduktohet në sigurimin e një martese të favorshme, duke reflektuar trajtimin e grave si "pasuri" në tregun shoqëror. Këto tensione pasqyrohen edhe në kontrastet mes motrave Bennet, Mary me prirjen e saj drejt dijes, Jane me përlësinë që përputhet me normat e feminitetit, përmes të cilave Austen satirizon pritshmëritë shoqërore dhe kufizimet që ato imponojnë.

Në këtë botë, marrëdhëniet shoqërore

karakterizohen edhe nga ajo që mund të quhet "urrejtje e rregulluar": një vetëdije e vazhdueshme për thashethemet, rivalitetet dhe vëzhgimin reciprok. Komuniteti funksionon si një rrjet ku çdo individ është njëkohësisht pjesëmarrës dhe vëzhgues, një formë e kontrollit social që e bën reputacionin një element vendimtar.

Për lexuesin shqiptar, një element me rëndësi të veçantë është botimi nga TOENA, i cili vjen me një përkthim të nivelit të lartë. Enit Steiner - Karafili me përkthimin e saj ruan elegancën stilistike, ritmin dhe ironinë e hollë të Austen-it, duke e bërë veprën të komunikueshme në shqip pa humbur kompleksitetin e saj. Në një tekst ku nuancat janë thelbësore, kjo përbën një arritje të rëndësishme.

Në fund, *Krenari dhe Paragjykim* mbetet një roman mbi mënyrën sesi individit ndërton dhe rindërton marrëdhënien e tij me shoqërinë. Ai nuk ofron një refuzim të rendit shoqëror, por një rikonceptim të tij përmes vetëdijes individuale. Transformimi i Elizabeth-it dhe Darcy-t nuk është thjesht



personal. Ai sugjeron mundësinë e një harmonie ku shoqëria dhe individit nuk janë në konflikt të përhershëm, por në një dialog të vazhdueshëm.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron forca e romanit: në aftësinë për të treguar se dashuria, në formën e saj më të plotë, nuk është një arratisje nga shoqëria, por një mënyrë më e vetëdijshme për të ekzistuar brenda saj.

Londër, prill 2026



Ra zilja e celularit. U rrëqetha. Pashë se po Rmë merrte nëna. Ishte shumë herët dhe u shqetësova. Qëkur kisha ikur në mërgim dhe jetoja larg prindërve, shqetësohesha më tepër. Por kisha edhe arsye të tjera, të forta. Para ca kohe, nëna më kishte kërkuar të shkoja sa më shpejt në Tiranë. Kishin një kokëçarje të madhe me qeramarrësin e katit të parë të shtëpisë. Qeramarrësi ishte një polic i ri, i martuar, me një fëmijë, por pasi ndenji dy vjet me qera në shtëpinë tonë, papritur tha diçka të papranueshme dhe të frikshme. -Unë jam ngushtë këtu, tha- do të shtoj dy dhoma me paret e mia. Eshhtë në të mirën e të dy palëve.

Im at ishte jo vetëm i frikësuar, por edhe i ndërkrer nga kjo gjë, i kishte thënë prerë jo, por polici vazhdonte me të tijën. Im at kishte shkuar disa herë në polici, por asgjë! Kjo na futi të gjithëve në alarm dhe frikë dhe unë po bëhesha gati të shkoja atje sa më parë. Më ngjante si shenjë ogurzezë ky ngulmim i policit. Më luajti mendja kur vura re thirrjen e nënës. Ah, klitha së brendshmi, diçka e keqe do të ketë ndodhur. E hapa telefonin me duar të dridhura. Por kur foli nëna, ajo më komtoi një gjë edhe më të rëndë; im at ishte shumë sëmurë. Nëna më tha: "Eja shpejt se nuk i dihet e gjen apo nuk e gjen gjallë". Kjo, për ne do të thotë se ose ka vdekur ose është shumë i sëmurë dhe do të vdesë shumë shpejt. E harrova atë punën e qeramarrësit që na kishte dalë si ferrë dhe na e kishte nxirë jetën muajt e fundit. Më e rënda ishte se kur kisha pyetur njërin nga miqtë e mi në Tiranë ai më kishte thënë: ai, polici, është nga ata njerëz që të bëjnë gjëmën, ka qënë i dënuar me burg në Itali dhe tani është kthyer në Shqipëri dhe është bërë polic. Dreq ta marrë, si ishte e mundur kjo? Një ditë të bukur të del se edhe polici mund të jetë keqbërës, nëmos edhe vrasës!? E frikshme, por kjo që më tha nëna ishte edhe më tronditëse. Duhet të shkoja sa më parë në shtëpi, tek prindërit. Mora makinën dhe u nisa. Më ngjan se me makinë arrij më shpejt. Më lodhin tepër pritjet në aeroportet.

E dija se një ditë do ta merrja këtë lajm, por s'di pse, për këto gjëra, gjithnjë kam qënë foshnjarak, më ngjante vetja si në një përhimje përralle, më dukej se atë lajm nuk do ta merrja kurrë. Gjithë rrugën tek ngjisa automjetin, mendja më rrinte vetëm tek im at. Sikur doja të risillja në mendje dhe të rishqyrtoja gjithë vitet që kisha jetuar me të. Hej dreq, e qortoja veten. Pse bëja kështu, si i tërmëngur? Pse mendoja më të keqen?

Unë kam shkuar shumë mirë me tim at. Bisedonim shpesh, ai fliste çiltër dhe me gjykime të thella. Gjatë trazirave të '97-ës dhe më pas, ne flisnim shpesh për dhunën, si dhe pse vinte, si duhej shpurrur nga vetja jonë. Po si bëhej kjo? E kundërshtonim fort njëri-tjetrin. Im at thoshte se njeriu ka lindur, si çdo gjë tjetër, së bashku me dhunën. Më i zoti fiton, duke marrë nga të tjerët apo nëpërmjet të tjerëve. Njerëzimi ka histori luftërash, ngulmonte ai. Dhe gjendja bëhet gjithnjë edhe më e keqe. Ç'kemi parë ne që nga koha e Jezu Krishtit që tha se Zoti është dashuri? Njeriu është bërë më i dhunshëm dhe, për më tepër, mjetet që përdor janë me mijëra herë më të këqia, më të dhunshme, më vdekjeprurëse se shpata e dy mijë vjetëve më parë. Ndërsa unë, si i urtë dhe që doja të mirën, kisha një qasje kokëfortësisht të kundërt. Kisha shpresë tek mirëkuptimi dhe paqëtimi. Iu isha ngjitur shumë këtyre mendimeve që në shkollë të mesme, kur kisha dëgjuar së pari për moskundërshtimin e së keqes me dhunë të Tolstoit. Vetë im at më kishte thënë se "Tolstoi është shkrimtar nga më të mëdhenjtë, por ishte Jezu Krishti ai që tha se nëse dikush të qëllon në një rëndësi, ti ktheji edhe tjetrën. Vite më vonë, në fshehtësi, arrita të lexoja Dhjatën e Re, një botim i vjetër, që kishte një erë të rëndë libri të përdorur. Edhe pse në heshtje, mu rrit besimi tek fuqia e mirëkuptimit dhe dashurisë mes njerëzve.

Më vonë, pas ndryshimeve, ne mund të bisedonim lirshëm, por qëndrimet tona ishin po ato: im at vijonte të thoshte se, që nga Jezu Krishti, gjendja e sjelljes njerëzore është bërë më e keqe. Unë i përgjigjesha se numri i atyre që kanë besim tek mirëkuptimi dhe dashuria po rritet, por ata janë të heshtur. Nëna ime e cila tëhupej kur dëgjonte biseda të tilla, rrallë fliste. Dy-tri herë më kujtohet, ashtu, me zë të mendueshëm, me një si thirrje që vinte nga një lartësi e pakuptueshme, si nga yjet, thoshte, "Eh, të gjithë djem nënash janë". Ne kjo na dukej si një gjuhë e pakuptueshme. S'kishte shumë kohë që kishim përjetuar 97-tën. - E sheh se ç'bëhet tek ne?- pyete im at. -Gjithsekush ose duhet të ushtrorë dhunë, ose të kërcënojë me përdorim dhune që të shpëtojë. Do thosha ti se kjo është e

## TAIP SULKO

# Ne të tre dhe shpirti njerëzor

Tregim



përkohëshme, gjithçka do të ndryshojë. Mbese kështu do jetë, por tani kemi këtë që kemi. Në fund të fundit, le ta harrojmë '97-ën. Shih se ç'bëhet në Kosovë? Serbia kur s'ia doli t'i largonte shqiptarët, duke i lënë pa bukë dhe pa arsim, tani po përdor dhunën dhe i vret që t'i spastrojë dhe dehojë një herë e përgjithmonë. Ç'duhet të bëjnë shqiptarët? Ta pranojnë fatin, të ikin apo të luftojnë, të mbrohen?

Trazirat e '97-ës dhe rragatat për to, më duket ishin një parastërvitje e mirë. Ishte një mësim i ngjeshur teorik për atë që erdhi më vonë. Ne blemë një shtëpi në Tiranë atë kohë. Ishim të gëzuar, aty brenda e gjenim qetësinë dhe mirëkuptimin, aty në atë oaz ku nuk mbërrinte breshëri dhe rrufetë e dhunës që vërvitej si kuçedër atje jashtë. Por kjo qetësi kaq e ëmbël nuk zgjati shumë. Për dreq, bisedat tona për dhunën dhe paqen, nga kënaqësi bisedash, papritur u kthyen në një bombë që na plasi mu në mes të shtëpisë. Shkaku ishte fqinji më i afërt që na kishte ndihmuar ta gjenim atë shtëpi, e cila dhe pse e vjetër, mund të ndreqej e përmirësohej.

Fqinji që na kishte ndihmuar që një ish punonjës i sigurimit që ende mbante një revole me leje nga shteti. Sapo ne u futëm në banesën e sapoblerë, çdo natë, para mesnatës, por ndonjëherë, edhe në mëngjes, apo edhe në mes të ditës, fqinji ynë ishsigurims, ende me revole, dilte në dritare ose në taracë, si një tel i hollë dhe i sertë dhe qëllonte me armën e tij. Plumbat kishin një fishkëllimë të egër prej vdekjeje. Nuk qëllonte një herë, por shumë herë, sa që jo vetëm ne, por gjithë lagjia ta merrte vesh se ai po qëllonte. Im at arriti të bisedonte me të. Na luajti mendja e kokës kur mësuam se ç'donte. Sipas tij, gjysma e tokës që kishim rreth shtëpisë i takonte atij. Ia kishte premtuar vetë pronari, siç thoshte ai. Im at, e më pas edhe unë, ngulmonim se shtëpinë e kishim blerë me gjithë tokën. Atëherë ishsigurimsi u zemërua, u bë si i tërbuar, fare i papërmbytur. -Unë do ta marr sesbën atë që më takon!-tha. Dhe as na fliste më, e as donte të bisedonte me ne. Një gjë e bënte më shpesh dhe frikshëm, qëllonte pa pushim sidomos nga dritarja e katit të dytë. Gëzhojat e plumbave kërcenin e binin në kopshtin tonë. Ky ishte vetëm fillimi. Një ditë, pasi qëllloi sa u zhdëp dhe na shurdhoi me krismat aq sa na e mbushi kopshtin me gëzhoja të xehta, fqinji shkoi dhe e hoqi gardhin e lehtë që ishte mes shtëpive tona. Pasi hoqi gardhin, ai solli lëndë ndërtese, madje filloi të hapte themelet për të ndërtuar një mur të lartë ndarës mes dy shtëpive.

-Duhet të veprojmë, të kundërpërgjigjemi, -tha im at. -Tani, këtu, në Tiranë ka vetëm trazirë. Edhe me top të qëllosh s'të kthen sytë njeri. Duhet të mbrojmë veten. Unë heshtja i nemitur, nëna vetëm dridhej dhe i lutej Zotit në heshtje. Mua, që kisha kohë që notoja në ujra që s'i njihja dhe s'i doja, kur im at tha se duhet të mbrojmë veten, më ngjau se diçka më ra si sopatë në kokë.

Ç'do të bënim ne, do të merrnim armët dhe do të luftonim me një njeri të keq, që gjithë jetën ishte marrë me armët dhe, ku ta dish, me grabitje në fshehtësi? Ato kohë s'më hiqej nga mendja thënia e Jezu Krishtit kur do ta arrestonin "Fute shpatën, sepse, ai që e përdor, nga shpata do të vdesë". Nuk e doja kundërshtimin me dhunë. Isha unë ai që kisha ngulur këmbë dhe ashtu kishim bërë, gjatë trazirave të '97-ës, kur të gjithë morën nga një armë dhe qëllonin netëve lart, sikur sulmonin vetë qiellin, ne, as unë, as im at as nuk morëm armë dhe sigurisht që as qëlluam. -Të mos hyjmë në grindje dhe armiqësi me asnjëri- thosha unë. Dhe ashtu bëmë. Por ja, tani, jeta po na vinte në provë. Ishte e qartë se ne duhet ta mbronim veten, por si dhe me ç'mjete, kjo nuk dihej sidomos në atë kohë trazirash, sidomos për mua. Kur shkoja të flija, gjumi s'më zinte, por kjo ishte më e pakta, mendja më vinte vërdallë dhe më dukej se ajo marramendje nuk ishte brenda meje, jo, me siguri bota po rrokullisej dhe përmbysje me gjithçka. Çfarë të bëja? Të merrja edhe unë një armë dhe të vetmroheshja? O Zot, pse jeta ishte kaq e ashpër, e pamëshirshme? Kur biseduam me tim at, unë thashë të prisnim, të shihnim se mos gjenim një zgjidhje me të mirë, por ditët fluturonin dhe fqinji ynë grabitqar, kishte filluar punën për të ndërtuar murin, thjesht, po na zhgërrëpte pronën. -Do ta zgjidhja unë, -tha im at. -Ti mos u ngatëro në këtë çështje. Kjo është luftë dhe unë mendoj se në luftë duhet të shkojnë të parët ata duhet të ikin nga kjo jetë të parët.

Isha me zemër të ngrirë, për ditë e ditë me radhë. I frikësohesha më të keqes, se mos kishte ndonjë përplasje me armë që do të përfundonte në gjakderdhje dhe humbje të pakthysme dhe të lemerishme. Ishin ditë të zeza, të mbushura me ankth. E shihja tim at që hynte dhe dilte, por sikurse u morëm vesh, ne as flisnim për këtë. Gjithçka do ta bënte ai dhe çdo përgjegjësi do ta kishte ai. Im at e zgjidhja. Një të vërtetë, ai bëri atë që të gjithë bënin ato kohë në Tiranë. Një natë, kur muri grabitqar i fqinjit kishte filluar të ngruhej, unë dëgjova krismë në kopësht. Ishin të forta, shurdhuese, të frikshme, të pamëshirshme. Në dhomën time në katin e dytë, ndjeja erën e barutit. U afrova tek dritarja të shikoja. U lemerisa edhe më keq nga ajo që pashë. Atje, në anë të kopshtit, pothuaj ngjitur me murin që po ngrinte fqinji ish sigurims, im at qëllonte lart me automatik. Oh, o Zot, klitha. Çdo bëhet me ne? Do shfarosemi, do shuhemi, apo edhe më keq, do bëhemi kriminelë, vrasës? Po sikur edhe ai, që përtej gradhit të dilte dhe të qëllonte ç'do të bëhej. O, Zot, të falem, pëshpërisja me vete kur vija re se nga shtëpia e fqinjit nuk vinte asnjë pipëtim. Ishte qetësi dhe errësirë. Im at u ngrit edhe në mëngjes herët, atëherë kur nuk kishte shumë krismë në qytet dhe filloi të qëllonte përsëri lart, fort, pamëshirshëm. Unë u aforva tek dritarja dhe nisa të lutem përsëri. -O Zot na ndihmo, na ruaj nga ndonjë gjëmë! U bë qetësi

dhe pastaj vura re tim at që e prishi murin që ishte filluar, mori rrjetën e telit të hedhur tej dhe e vuri aty ku kishte qënë, sipas kufirt të blesjes. Gjithçka ngeli ashtu, nuk ndodhi asgjë. U vu në vend një padrejtësi. Im at më duket se fitoi me qasjen e tij. Më ngjante vetja i mundur dhe ashtu u solla, u zhyta në heshtje si i mposhtur dhe i mundur.

Pasi u ngrita në mëngjes, dola në kopësht. Ishte ditë me diell. Rreth e rrotull ishte qetësi. Zogjtë e frikës sikur ishin rralluar. Një natë më parë, si dhe atë mëngjes, pasi im at kishte qëlluar me automatik, fqinji as nuk u pa dhe as nuk qëlloi nga dritarja apo nga tarraca. Ecja në kopësht dhe ndjeja poshtë këmbëve sesi më vrisnin gëzhojat e mëdha të plumbave të automatikut. Ecja i menduar, ndjeja një peshë të rëndë dëshpërimi. Më dukej se zgjidhja ishte gjetur, po si? A nuk kishte mënyrë tjetër? Pse njeriu të ishte kaq i pangopur, i padrejtë, për më tepër kaq i papërgjegjshëm? Im at kishte fituar, nuk e bëja dot me faj, sepse ai ishte vetmbrojtur dhe kishte vendosur në vend atë që ishte e drejtë. Po sa afër gjëmës kishim kaluar, sa e frikshme dhe e pamendueshme ishte kjo? O Zot, sa i papërkryer është njeriu, sa shtrembër është sajuar mendja e tij! Ah, o Zot, na ndihmo, o Zot ndihmoje njeriun të ketë një mendje jo si kjo, tjetër! Isha sigurisht në kopështin tim, sidomos në kopështin e mendimeve dhe qasjeve të mia paqëtuase. Atë hop më ngjau se kështjella ime e paqëtitimit u kris përsëri. Papritur, në anën tjetër të gardhit doli e shoqja plakë e fqinjit, një grua e veshur krejt në të zeza, me një nishan të madh në faqe. -Mirëmëngjes- tha me zë të ulët. Ktheva kokën i frikësuar. S'e prisja të vinte ndonjë zë nga ajo anë, kishte kohë që ne nuk flisnim, edhe kur kryqëzoheshim në rrugë. -Mirëmëngjes - u përgjegja, duke e parë me habi, në mos me sy të shqyer. Ajo buzëqeshi me përlulesi. -Mirë duket- tha. Unë tunda kryet në shenjë pohimi. -Dëgjova shumë krismë mbrëmë, më mesnatë dhe sot në mëngjes- tha. -Eh- mermërita, -kështu është Tirana tani. -Jo, ishte këtu, - vijoi ajo me një klithmë të dridhur, -këtu, shiko sa gëzhoja ke në tokë! Vetvetëshëm hodha sytë poshtë. Një vrikth i sertë më përshkoi trupin deri lart, tek çafka e kokës. E dija se ç'kishte poshtë këmbëve; më dhembnin shputat kur ecja. -Janë gëzhoja revoleje- thashë me zë të ulët. -Mirë të keqen nëna, -tha, -paç një ditë të mbarë!

Ato ditë me krismë dhe gëzhoja si dhe gjithë stina, me krismë e vrasje e '97-s sikur u harruan dhe pas ca kohe ne u bëmë fqinjë të mirë dhe gati miqësorë. Por ai ajri me vrunduj dhune e bëri punën e vet, më dëshpëroi, më la pa fuqi dhe më dukej se do të duheshin njëqind vjet që gjërat të rregulloheshin.

Nuk vonoi dhe, si shumë të tjerë, edhe unë ika në mërgim. Por nuk ika në një vend të largët, thashë më mirë të qëndroja në një vend rrotull që edhe prindërit të mos i kem larg. Ose në fund të fundit, të iki për ca kohë e kthehem përsëri. Sigurisht që rashë në lak, ai që ikën nuk kthehet më, dhe, pas ca kohe, edhe vendi yt i afërt të bëhet i largët. Prindërit ngelën vetëm dhe më ngjante se, edhe kur flisnim në telefon, edhe kur shkoja rrallë atje, vija re se në shtëpi kishte shumë ligështim, pothuaj errësirë. I ndihmoja prindërit, por ata prapë ishin të pakënaqur, ishin fare të palumtur, e thoshin shkoqur se të gëzuar do të ishin nëse edhe ne, së bashku me fëmijët, do të ishim aty, me ta. -Sikur na ha shtëpia, -thoshin, -na duket shumë e madhe.

Kjo gjendje na bëri të merrnim vendimin që katin e poshtëm ta jepnim me qera, prindërit do të jetonin në katin e dytë. Dhe këtu desha të dal atje ku e nisa. Kjo ishte koha kur ne ia dhamë katin përdhes me qera një polici që kishte qënë i burgosur në Itali. Edhe ai, po ashtu si ishsigurimsi, që nuk jetonte më, e gjeti një rrugë, një mënyrë për të na e prishur qetësinë, por jo vetëm kaq, për të më hedhur mua përsëri në erë, me gjithë lecka. Ç'dreqin të bëja unë me të, si ta hiqja qafe? Më ngjante se kot kisha shpresuar se '97-ta ishte mbyllur dhe kishte ngelur larg. Jo, e njëjta gjë po ndodhte përsëri, por në rrethana edhe më të këqia për mua. Im at ishte i sëmurë rëndë dhe nuk bënte dot asgjë madje edhe më keq, unë kisha frikë nëse do ta shihja të gjallë apo jo kur të mbërrija.

I dhashë makinën si i marrë pa ndërprerje, me pak ndalime të vogla në vendpushimet anës rrugës, pastaj mora traqetin dhe më në fund, i lodhur dhe si i shtypur në shpirt, i ligështuar mbërrita në shtëpi. Tek dera më priti nëna. Ne u ngjitëm në katin e dytë. Kur kaluam nëpër shkallë, ndjeja zërat që vinin në katin e pare, ku jetonin qeramarrësit. Im at mu duk më mirë seç e prisja. Ishte shumë i dëbësuar, i zverdhur dhe i

pafuqi, por ende lëvizte, mbahej. Më vinte shumë keq për të, por edhe për nënën. Po të isha aty, mbase do të bëja më shumë, do të kisha mundësi t'i ndihmoja.

Im at, ditët e para, nuk më foli për sëmundjen. Me sa kuptova, e dinte tashmë se kishte sëmundje të keqe dhe se do vdiste shpejt. Më shumë donte të fliste me mua, të kënaqej, të pyste për fëmijët e mi, të rikujtonte vitet dhe ngjarjet e kaluara, madje deshi të cikonim edhe gotat me verë, si dikur.

Pas pak ditësh, pasi mbaroi kjo periudhë e parë e ardhjes time dhe u çmall disi, im at më thirri në dhomën e tij dhe më dha porosinë e fundit. Unë dridhesha dhe isha si në gjemba, por ai, edhe pse me një zë të thellë, më fliste qetë. Më tha se kur të vdiste donte që ta varrosnim, atje ku kishte lindur, në fshat. Më la dokumentet e pronësisë dhe kartat e bankës, ku kishte kursimet e veta. Pasi mbaroi këto, më tha se kishte edhe një porosi të fundit. -Ec me mua- tha. U nis ngadalë dhe mu duk sikur donte të ecte sa më gjatë ose mbase që ajo rrugë të mos mbaronte kurrë. Por, ja, gjithçka ishte brenda shtëpisë. Arritëm tek këndi i fshehtë të cilin as e dija se ishte. -Unë do vdes,- tha - dhe nuk kam kohë. Dua ta mbaroj edhe këtë punë. Ai e hapi këndin e fshehtë dhe unë u tmerrova kur hodha sytë brenda. Ay gjendej po ajo armë me të cilën ai qëllonte lart si i marrë në '97-tën, kur donte të mbronte shtëpinë. Arma ishte e pastruar dhe vetëdijta, aty pranë, në atë kthinë të ngushtë, ishte vendosur edhe një arkë me fishekë. O Zot, na ruaj, mëmërita me vete, sa për të bërë një luftë! Ai ma tregoi se si ta hapja dhe mbyllja vendin e fshehtë ku mbahej arma. Pastaj u kthym po ngadalë në dhomën e tij. -Ti rri këtu, - më tha- se sot dua ta zgjidh çështjen që kemi me qeramarrësin. Mos dil nga shtëpia. Unë do jem poshtë dhe do bisedoj me të. Ai e di që ti je këtu.

Ngela si i ngrirë aty në mes të dhomës. Ai mori një zarf dhe nxori disa letra. Më tha se ishte një kërkesë me shkrim, e përgatitur tek noteri me anë të së cilës ai i kërkonte qeramarrësit të largohej menjëherë nga shtëpia. Zbriti ngadalë shkallët dhe unë u afrova tek dritarja. Pamja atje jashtë në oborr dhe në kopësht, më kujtonte gjendjen që kishim në '97-tën kur fqinji ynë ish

sigurims me revole, e hodhi tej gardhin dhe donte të ndërtonte një kufi të ri, që të na vidhte pronën. Një pjesë e oborrit ishte mbushur me lëndë ndërtimi, tulla, gurë dhe dërrasa, të cilat qeramarrësi i kishte sjellë për të bërë shtesën. Ishte e frikshme. Nëse ai e ndërtonte, sikurse më kishin thënë, shtëpia një ditë mund të bëhej e tija. Ishte një mahi e keqe që më ngjante po aq e rrëpirtë sa edhe shkëmbinjtë në majën e Dajtit që ngrihej atje tej, përballë me shtëpinë tonë. Im at zbriti poshtë në oborr. Qëndroi pak atje në pritje. S'e dija ç'do bënte dhe si i kishte menduar gjërat. Qeramarrësi, me trupin e bëshëm, veshur gjysmë me uniformë, me ca lëvizje bolle që është tepër e sigurtë në fuqinë e helmit të vet, po punonte në oborr, lëvizte lëndët ndërtuese që kishte sjellë aty. Atë çast, dera e jashtme trokiti dhe im at, ngadalë shkoi dhe e hapi. Ishte një miku i tij. E pashë që aty ku isha, tej dritares, se si u takuan dhe im at e ftoi të hynte. Por ata nuk u futën në shtëpi. Pasi qëndruan pak, fare pak, në këmbë para shtëpisë, im at u shkëput dhe në prani të mikut, iu afrova qeramarrësit që, ashtu sikurse ishte, me pantallona dhe me këpuce polici dhe me revolen në brez, lëvizte dhe stivoste tullat që kishte sjellë brenda oborrit. E vura re sesi miku i tim eti u afrova për të qënë më pranë, si, dëshmitar. Im at qëndroi para qeramarrësit, qëndroi drejt, sikur të ishte ende i ri dhe i fuqishëm. Nxori nga zarfi letrat dhe ia zgjati. I fliste shkoqur dhe me vendosmëri. Fjalët nuk i dëgjoja, por vetëm shihja si po zhvillohej biseda. Vura re se qeramarrësi u zverdh kur mori letrat në dorë. Hodhi sytë në letra, shpejt sa për të parë se ç'ishte, pastaj pa nga miku i tim eti dhe, për habi, ngriti sytë edhe lart, atje ku isha unë, pas qelqeve të dritares. Nuk e di se ç'farë i tha im at qeramarrësit. Ai kurrë nuk ma tregoi dhe nuk kishte shumë kohë. Po bëhej gati të ikte përgjithnjë. Ndjehesha dyfish i ligështuar dhe i hidhëruar. S'di pse për këtë gjë, këtë herë, im at donte të ikte pa e zënë me gojë, pa folur për fitore. Sa isha i ri, mendoja se nëna ishte engjëlli im mbrojtës, por, pasi u bëra me fëmijë, dhe shihja se ç'farë ishte gati të bënte im at për mua, fillova të mendoja se edhe ai ishte po aq engjell mbrojtës sa edhe nëna.

Pas dy javësh, qeramarrësi u largua nga shtëpia. Unë ende isha aty. Shpëtuam edhe këtë

herë, mendova. Por e dija, nuk kisha kohë të gëzohesha dhe të kremtoja. Vetëm disa ditë pasi qeramarrësi u largua, unë përjetova një hidhërim të madh, më të madhin, im at vdiq. Ishin ditë të vështira. Por më e rëndë më ngjante se do të ishte ikja, të kthehesha në vendin e mërgimit, ta lija nënën vetëm.

S'di pse, në atë trazirë, s'më rrihej pa e parë edhe një herë armën e fshehur në atë kënd të padallueshëm dhe të pagjendshëm. Porosia kryesore e tim eti kishte qënë që, nëse do të ishte e mundur, kurrë të mos e përdorja armën. Madje ai më dha edhe një rregullorë që e kishte bërë vetë, që, me siguri, mund të ishte më e ndërlikuar, mbase dhe më e rreptë se vetë vënia në gatishmëri e armëve bërthamore të fuqive të mëdha. Isha, atë hop, dyfish i trazuar. Ajo ëndrra ime për paqësoren dhe mirëkuptimin ishte në rrezik të zhdukej. Ndjeja se ai thelbi im i mirësisë dhe mëshirës ishte mësyre keq dhe nuk kishte më shpëtim. O Zot, pse kështu? Ç'të bëja? Mos vallë atë betejën në biseda me tim at për sjelljen njerëzore dhe mëshirën e kisha humbur përfundimisht, do të ikja i mundur? U ula në shtrojë dhe mora armën në dorë. -Ah, o Zot, -klitha së brendshmi. -Pse jemi ende kështu? Kur do të vijë një ditë kur gjërat do t'i zgjidhim ndryshe, kur mes nesh të mbretërojë ligji dhe dashuria? Arma heshtte, duket kurë s'do të fliste. E vendosa përsëri aty dhe e mbylla këndin e fshehtë, siç më porositi im at. Të nesërmen ika.

Për ca kohë, atje larg, në mërgim, sikur u harrova. Përreth meje frynin erëra më të qeta. Por ishte e thënë që mëdyshjet dhe përplasjet të më përfshinin përsëri. Pas dy vitesh më vdiq edhe nëna dhe unë ndenja ca kohë në Tiranë. Ato kohë u miratua edhe ligji për dorëzimin e armëve. S'di pse në fillim nguroja edhe pse, së thelli, e dija se kjo ishte udha më e sigurtë, më e mira, ajo që prisja, rreptësi të shtetit. Vendosa, pa mëdyshje të tjera, që ta dorëzoja armën e tim eti. Por, aty, atë ditë, atë hop, ndodhi edhe e papritura, befasimi më i madh i jetës time. Nuk kisha asnjë dyshim, ky ishte vendimi më i mirë, arma duhej dorëzuar. Mbylla derën e jashtme dhe hapa vendin e fshehtë. Gjithçka e bëja ngadalë dhe me kujdes, sipas porosive të tim eti. E dija se ai kishte caktuar rregulla të forta për hapjen e këndit të fshehtë. Kjo

puqej, edhe pse fshikurazi, me mendimet dhe ëndrrën time për rrugën që çon tek mirëkuptimi dhe paqja. Por, kur këndi u hap dhe hodha sytë, u tmerrova, ngriva sikur të më kishte shituar Qoftëlargu. Arma nuk ishte aty. Përcillesha pa kuptim, ato mizëzat e shumta që dilnin nga sytë sesi vërviteshin rreth meje. Nuk shikoja aq mirë nëpër atë trazim, dhe më e keqja ishte se s'i besoja as syve të mi. E preka gjithçka me kujdes. Asgjë. Duart më bëheshin gjithnjë e më të ftohta. I nxora të gjitha gjërat që ishin aty, një arkë prej dërrase, mbëshjellëse leckë, vegla dhe vajra pastrimi, prapë asgjë. As arka me fishekë nuk ishte. Vetëm fletorka e vogël e udhëzimeve ishte lënë e hapur. Si ishte e mundur kjo? Mos isha treguar megjithëmend foshnjarak dhe kjo gjë ishte bërë shtysë për ndonjë gjëmë!? Ndjeva se trupin dhe kryet m'i kishte përfshirë një flakë e papërmbajtshme. Askush nuk e dinte këtë të fshehtë. As nëna! Mos duhet të njoftoja policinë? Ndjehesha i dobët, s'kisha fuqi as të mendoja.

Mbylla përsëri vendin e fshehtë. Kalova kështu disa ditë sikur të më kishin vënë flakën së brendshmi. Doja të mendoja, t'i shohisja gjërat, të gjykoja i qetë, të isha i kthjellët, i qartë! Ndjeja një shtysë të fortë që ta hapja përsëri këndin ku fshihej arma. Ashtu bëra. I nxora gjithë gjërat jashtë. Vëreja gjithçka me hetim të ngadalë. Në fund i erdhi radha edhe fletores së udhëzimeve që më kishte lënë im at. Ajo ishte ruajtur më mirë nga gjithçka, ngjante sikur sapo të ishte blerë. E shihja me squllje malli dhe zhgënjimi. Por s'di pse edhe si me pyetje dhe shpresë. Ashtu doli vërtet. Në anën e brendshme të kores së fletores vura re një shenjë të çmuar për mua, që ma vinte nëna në fletoren e detyrave, sa herë ngelte e kënaqur, një trajtë zemre, me një shkronjë të madhe A përsipër. Ishte shkronja e parë të emrit të saj, Afërditë. Ah, nëna, e pazëvendësueshmja! E njoha shenjën që më ngjau se u shkëput nga korja e fletores dhe u vërsul e më përqafoi. Ah, nëna, nuk kishte dashur të ikte nga kjo jetë pa hequr nga rruga ime, nga supet e mia këtë ferrë, këtë gur të rëndë, ose më mirë këtë tel me gjemba që më trembte tek e mendoja, që ma burgoste shpirtin. -Të ndritë shpirti nënë, ti e kuptove më parë se unë se ç'duhej bërë!- thashë me vete. Zemra e saj e dinte më mirë! Të ndritë shpirti!

### Karikaturë nga Arben Mexsi



## VAJZAT E ALEKSANDËR PUSHKINIT

**1. Maria Gartung**, vajza e madhe e Aleksandër Pushkinit dhe Natalia Gonçarovës, lindi më 19 maj 1832 në Shën Petersburg. Pushkini interesohej me dashuri për zhvillimin e saj, shpesh pyeste për të në letrat drejtuar së shoqes dhe e quante me përkëdheli “Pushkina pa dhëmbë” ose “litografia e vogël”. Kur poeti vdiq tragjikisht, Maria ishte vetëm 5 vjeçe.

Pasi mori arsimim në shtëpi dhe përfundoi Institutin Ekaterina, Maria u bë shoqëruese oborri e perandoreshës Maria Aleksandrovna. Në moshën 28-vjeçare, ajo u martua me Leonid Gartungun, i cili më vonë bëri karrierë si gjeneral-major dhe drejtues i fermave perandorake të kuajve.

Në vitin 1868, Lev Tolstoi, i magjepsur nga bukuria e saj e pazakontë, e takoi Marian në një ballo te gjenerali Tulubjev, pranë Tulës. Pikërisht ajo shërbeu si prototip për pamjen e Anna Kareninës, duke përfshirë kaçurrelat karakteristike dhe madje edhe fustanin e zi me dantella, të përshkruar në roman.

“Në kokë, mbi flokët e saj të zinj, krejt të vetët e pa asnjë përzierje, kishte një kurorëz të vogël manushaqesh, dhe një tjetër të tillë mbi shiritin e zi të brezit, mes dantellave të bardha. Krehja e saj nuk binte në sy. Të dukshme ishin vetëm, duke e zbuluar atë, ato unaza të shkurtra, të pabindura flokësh kaçurrelë, që gjithmonë i dilnin në zverk dhe në tëmtha. Rreth qafës së saj të skalitur e të fortë kishte një varg perlash.”

*Anna Karenina*, Lev Tolstoi

Martesa tragjike e Marisë me Leonid Gartungun mori fund për shkak të pasionit të tij për lojërat me letra dhe borxheve të grumbulluara. Në vitin 1877, ai u bë viktimë e një akuze të rreme për vjedhje, gjë që çoi në gjyq dhe, në fund, në vetëvrasje për shkak të turpimit të padurueshëm. Pa fëmijë, Maria e përjetoi humbjen e burrit në varfëri dhe vetmi të plotë, duke ndërruar jetë në Moskë më 7 mars 1919.

**2. NATALIA PUSHKINA**, vajza më e vogël e poetit, erdhi në jetë në vitin 1836, katër vjet pas motrës së saj. Ajo mbeti jetime që në foshnjëri — ishte vetëm tetë muajshe kur i ati vdiq tragjikisht. Ashtu si motra e saj, Natalia mori një edukim të shkëlqyer në

Etërit e tyre i thërrisnin me përkëdheli “djallushe” dhe “kuti shkrepësesh” për temperamentin e tyre shpërthyes. Po ju tregojmë se si u zhvilluan fatet e vajzave të bukura nga familjet e shquara të klasikëve të njohur rusë.

# Fatet e vajzave të Pushkinit dhe Tolstoit

shtëpi, ndërsa për karakterin e saj energjik dhe gazmor, në fëmijëri e quanin “djallushe”. Në moshë të pjekur, ajo fitoi reputacionin e njërës prej grave më tërheqëse të Shën Petersburgut.

Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare, Natalia u martua me Mikhail Dubeltin, djalin e xhandarit të lartë Leonti Dubelt. Kjo martesë doli e pasuksesshme për shkak të varësisë së burrit nga lojërat e fatit dhe karakterit të tij despotik. Pas disa vitesh jetë të përbashkët, në vitin 1862 ata pushuan së jetuari bashkë, ndërsa divorci u zyrtarizua në vitin 1868.

Natalia dhe princi Nikolai Wilhelm Nassau, të cilët u takuan në një pritje mondane, shpejt u bënë të dashur dhe më pas bashkëshortë. Pas martesës, ajo u shpërngul nga Rusia në Wiesbaden, ku, pavarësisht dallimit në status, gjeti lumturinë. Natalia nuk mori titullin princeshë, por u bë konteshë von Merenberg, sipas emrit të pronës së princit Nassau.


## MARIA, VAJZA E LEV TOLSTOIT

**Maria Lvovna Tolstaja**, e lindur në vitin 1871 në Jasnaja Poljana, ishte vajza e dytë dhe fëmija i pestë në familjen e Lev dhe Sofia Tolstoit. Ajo gëzonte dashurinë dhe besimin e veçantë të të atit, por hollësitë e jetës së saj mbeten pak të njohura për shkak të humbjes së ditarit të saj personal.

Sofia Tolstaja, në kujtimet e saj, e përshkruan Marian si të sëmure dhe të dobët që nga lindja. Kjo largësi u thellua edhe më shumë kur Maria, që në moshën katërmbëdhjetëvjeçare, mori pa kushte



Orest Kiprensky,  
Portret i Pushkinit, 1827



Ivan Nikolayevich Kramskoi,  
Portret i Lev Tolstoit, 1873

anën e të atit në konfliktin me të ëmën, gjë që çoi në prishjen përfundimtare të marrëdhënies së tyre, siç vëren biografia e Lev Tolstoit, Nadezhda Mikhnovet.


Maria, ashtu si i ati, parapëlqeu vetminë dhe jetën mes njerëzve të thjeshtë, duke iu përkushtuar shërbimit ndaj fshatarëve. Ajo hapi një shkollë në fshat, ku vetë u mësonte fëmijëve, si dhe kujdesej për të sëmuret dhe të uriturit. Tolstoi shënonte në ditarët e tij se vetëm ajo, nga të gjithë fëmijët e tij, i shpëtoi gjykimit të tij të ashpër.



“Sot mendova: unë zemërohem me mpirjen morale të fëmijëve, përveç Mashës. Por kush janë ata? Fëmijët e mi, krijesa ime nga të gjitha anët, trupore dhe shpirtërore. Unë i kam bërë të tillë siç janë. Këto janë mëkatet e mia — gjithmonë para meje.”

Në moshën 26-vjeçare, Maria u martua me të afërmin e saj, Nikolai Obolenskin. Megjithatë bashkimi i tyre ishte i lumtur, shëndeti i Marisë ishte i brishtë dhe ajo nuk mundi të bëhej nënë.

Fatkeqësisht, në moshën 35-vjeçare, ajo ndërroi jetë nga pneumonia, në vitin 1906.

Përkthimi © ExLibris





## Nga postimi i Besiana Kadaresë

Gjeta në arkiva këtë poezi që më ka kushtuar babi, me korrigjimet e tij - "Shpjegim për librat Besianës së vogël". Krahas saj po botoj edhe versionin përfundimtar, marrë nga vëllimi III i Veprës Komplete, botuar nga Shtëpia Botuese Onufri.

### SHpjegim për librat Besianës së vogël

Meqë ti do diçka të grisësh patjetër  
Në bibliotekën time,

Po të shpjegoj ç'ka këtu.

Këto libra janë shkruar gjatë shumë e shumë  
vjetësh,

Rresht pas rreshti janë mbushur me a, i, u.

Ja, për shembull, ky këtu është xhaxha Homeri,  
Për gjithë ne shkrimtarët ky është babazot.

Ku i ka sytë? Jo, s'ia ka ngrënë macja,

Por, me sa duket, ajo ç'ka parë në botë.

Ky mbi kalë është xhaxhi Don Kishoti, vërtet  
i marrë,

Po më vonë jam i sigurt se për të ti do të qash.

Kurse këta janë xhaxhi Migjeni me Naim Frashërin,

Që nën jastëk besoj gjithmonë do t'i mbash.

Sikur Zog e sulltan të mos kishte atëherë

Dhe në vend të tyre penicilinë të kishte,

Ata më shumë do të rronin dhe prej tyre së paku

Ca ditë më të bukura në jetë ti do t'i kishe.

Por ti ngul këmbë se diçka, sidoqoftë duhet grisur,

Në të vërtetë çdo bibliotekë për të grisur ka diçka,

Ja këtu në qoshe rrinë grumbull ca poetë hermetikë,

Më duket se njëfarësoj mund të merresh me ta,

Ndërsa ti sa vete rritesh e mëson fjalë,

Ata bëjnë të kundërtën, sa vete i harrojnë ato,

Meqenëse tani për tani ke moshën me ta për t'u marrë,

Unë hiqem mënjane...

dhe ti vepro!

“Unë kurrë nuk kam qenë vërtet në botë,” tha Muriel Spark, 85 vjeçe, në një nga intervistat e fundit të autores. “Kam qenë gjithmonë shkrimtare dhe lexuese, prandaj idetë vinin të parat.”

Për këdo që ka qoftë edhe një njohuri të zbehtë për jetën — ose, në fakt, për jetët e shumta — të Spark-ut, fjalët e saj mund të vijnë si befas. Në fund të fundit, kjo ishte një grua aq e etur për aventura në botë, sa që në moshën 19-vjeçare udhëtoi e vetme nga Edinburgu në Afrikën e Jugut, pasi pranoi propozimin për martesë të Sydney Oswald Spark-ut, një mësues matematike mbi 10 vjet më i madh se ajo. Një shkrimtare aq e vendosur të “përjetonte luftën”, sa la burrin dhe djalin e saj foshnjë për një jetë të re në Angli, ku gjeti punë duke fabrikuar lajme të rreme të krijuara për të ulur moralin e nazistëve. Një sensacion letrar aq i suksesshëm, sa shoqërohej me ajkën e ajkës së Nju Jorkut, shëtiste nëpër rrugët e Romës me limuzinë me shofer, merrte letra adhurimi të përunjura nga Liz Taylor dhe bleu një kalë gare nga stallat e Mbretëreshës Elizabeth II.

Kjo të shtyn të pyesësh: nëse Spark nuk ishte “në botë”, atëherë kush drejtin ishte?

Megjithatë, sigurisht, ajo kishte të drejtë. Në vend që të ishte “brenda” botës, Spark kalonte përmes saj si një kamerë lëvizëse. Në festa dhe në biseda, ajo ishte gjithmonë vetëm gjysmë e pranishme. Dëgjonte me kujdes për ndonjë kthesë të çuditshme fraze dhe vështronte për fillesat vezulluese të një historie apo personazhi të ri. Hidhte vështrime të fshehta në çantat e blerjeve të të panjohurve dhe i sodiste njerëzit nga fundi i autobusit. Të jetoje kështu — duke e trajtuar lëndën e jetës si përbërës për letërsi — e bëri atë pa rrënjë, të shqetësuar dhe të vetmuar. Ajo ishte, siç thoshte vetë, “një e mërguar nga natyra”, që nuk i përkiste askund dhe askujt, dhe i përgjigjej vetëm asaj që e quante “ndjesia ime e çuditshme diktatoriale”. Deri në fund, Spark mbeti jo tokësore, e shkëputur nga bota.

Kjo shkëputje vëzhguese, me sy të mprehtë, është tipari përcaktues i krijimtarisë së çuditshme, të errët dhe shpesh shumë qesharake të Spark-ut. Ajo është e pranishme në romanin e saj më të famshëm, *The Prime of Miss Jean Brodie*, ku zakonet dhe sjelljet e ish-mësueses së Spark-ut, zonjushës *Christina Kay*, formuan themelet e personazhit kryesor të librit — edhe pse, që fëmijë, Spark ishte tashmë e zënë duke mbledhur materialin e saj burimor. Pastaj janë romanet e saj të vendosura në Londër, si *The Girls of Slender Means* dhe *The Bachelors*, të frymëzuara nga konviktet dhe dhomat me qira të viteve të saj të tridhjeta. Ndërkohë, shkëlqimi dhe gjallëria e viteve të suksesit në Nju Jork dhe Romë gjetën rrugën e tyre në romane të



## “Njerëzit vijnë para librave”: Sakrificat ekstreme që Muriel Spark bëri për të shkruar

Por, pyet biografi i saj më i fundit, James Bailey, a ishte pikërisht vendosmëria e saj e pakompromis për ta vënë shkrimin mbi mëmësinë dhe martesën ajo që i bëri të mundura këto vepra?




James Bailey, autori i biografisë “Siç e do macja zogun: nëntë jetët e Muriel Spark” (Marc Provins)

çuditshme të mesit të karrierës, si *The Hothouse by the East River* dhe *The Public Image*. “Isha një magnet

për përvojat që më duheshin,” thotë shkrimtarja-protagoniste e romanit të nominuar për Booker, *Loitering with Intent*. Çfarë fraze tipike për Spark-un.

Të drejtonte jetën në këtë mënyrë kërkonte disa “sakrifica të mëdha”, pranoi më vonë Spark. Kryesorja ndër to ishte marrëdhënia me djalin e saj, *Robin*. Që nga çasti kur u largua nga Afrika për në Londër, Spark nuk do ta merrte më kurrë rolin e kujdestares kryesore të Robin-it. Ajo dhe i biri do t’i kalonin shtatë dekadat e ardhshme duke u rrotulluar rreth jetëve të njëri-tjetrit, por gjithmonë në largësi.

Marrëdhënia e tyre, e acaruar vazhdimisht nga kureshtja ndërhyrëse e medias, do të përkufizohej nga akuza të ndërsjella, nga një nervozizëm i përbashkët dhe nga një jetë e tërë pajtimesh të dështuara. Pikërisht kjo e forcoi më vonë përshkrimin e Spark-ut, në disa pjesë të shtypit, si një përbindësh i pashpirt i shkrimit, që i trajtonte të tjerët — përfshirë edhe fëmijën e saj — thjesht si pengesa për një



ditë të mirë pune. “Kur shoh pas,” reflektoi ajo, “shpesh pyes veten nëse mund të kisha bërë më shumë, por thellë-thellë nuk mendoj vërtet se mundesha.”

Për Spark-un, nuk mund të kishte qenë kurrë ndryshe. “Je vetëm gjysmë e pranishme nëse je shkrimtare,” shprehej ajo. Nëse kjo pengonte mëmësinë, ajo e rrëzonte plotësisht idenë e një martese tjetër. Jo se asaj i bëhej vonë; me pak përjashtime, burrat në jetën e Spark-ut ishin të padobishëm, të rrezikshëm, ose një ndërthurje e mjerë e të dyjave. Këtu përfshihej ish-bashkëshorti i saj, *Sydney*, me temperamentin e tij shpërthyes dhe luhatjet e dhunshme të humorit, si edhe *Derek Stanford*, një ish-i dashur që ia hante racionet ushqimore dhe më vonë shiti letrat e saj. Për më tepër, këmbëngulte Spark, marrëdhëniet vetëm sa i zinin rrugën gjësë që donte më shumë: “Unë kam një thirrje. Shkrimi është diçka që duhet ta bëj. Jo shumë burra do të duronin për këtë, dhe njerëzit vijnë para librave, ndaj është më mirë të mos kesh njerëz në jetën tënde. [...] Ata e quajnë sakrificë, por sakrificë për kënaqësi e bën kënaqësinë edhe më të madhe. Po të ma hiqnit shkrimtaren prej meje, besoj se nuk do të ekzistoj fare.”

Pasi e kishte ndarë mendjen, ajo u tërhoq gjithnjë e më shumë në atë që *Caroline Rose*, protagonistja e romanit të saj debutues të vitit 1957, *The Comforters*, e quante “bota shumë e largët” e artistit. Në dekadat e fundit të jetës, ajo jetoi me *Penelope Jardine*, shoqëruesen dhe sekretaren e saj personale, në një rektorat të rrënuar thellë në kodrat e Toskanës. Jardine gatante, ngiste makinën, komunikonte me agjentët dhe kontrollonte kontratat, në mënyrë që Spark t’i përkushtohej tërësisht faqes së shkruar. “Kur nis një roman,” tha ajo për shkrimin e saj, “dua ta përthith përmes poreve.”

Megjithatë, Spark dhe Jardine nuk ishin krejtësisht vetëm. Në fshatrat toskane, macet endacake hynin e dilnin nga rektorati. Ato hidheshin mbi tryezën e punës së Spark-ut dhe i bënin shoqëri ndërsa ajo shkruante gjatë ditëve të gjata, të ndriçuara nga dielli. Ajo nuk e kishte problem; prania e maceve, thoshte ajo, ishte ngushëlluese. Në fund të fundit, ajo dhe këto krijesa kishin diçka të përbashkët. Ndërsa qentë “skllavërohen lehtësisht” nga pronarët e tyre, kishte reflektuar ajo dikur, macet “nuk provojnë asgjë – ato janë mbi të gjitha këto. Ato as nuk kapin një mi, nëse nuk u leverdis ta bëjnë.” Kjo natyrë e pabindur ishte një cilësi që ajo mund ta vlerësonte. “Kur një mace zhduket vullnetarisht nga shtëpia,” thoshte Spark, “kjo ndodh thjesht sepse i ka ardhur teka të kërkojë diçka më pak të mërzitshme diku tjetër.”

Kjo ishte Spark, në jetë dhe në vepër: e palidhur pas askujt, e ftohtë, e distancuar dhe gjithmonë në kërkim të një jete më pak të zakonshme.

Përkthimi © ExLibris



## Shkrimtari i njohur, Anthony Horowitz, pranon se përdor inteligjencën artificiale: “Më duket sikur po mashtroj”

Nga Prudence Wade  
The Independent

Autori i shumë librave, Anthony Horowitz, karriera e të cilit shtrihet në disa dekada dhe përfshin serinë e dashur *Alex Rider* si dhe romane për të rritur, si *Magpie Murders*, ka zbuluar se përdor ChatGPT “gjatë gjithë kohës” në procesin e tij të shkruarit, një praktikë që ai pranon se e bën të ndihet “nervoz”.

Shkrimtari 71-vjeçar, i cili aktualisht po planifikon pjesën e radhës të serisë së tij të njohur *Hawthorne and Horowitz*, rrëfeu se ndien njëfarë shqetësimi për mbështetjen e tij te inteligjenca artificiale.

“Ndihej nervoz për këtë, sepse a është mashtrim? Më duket pak sikur po mashtroj në një provim në shkollë,” tha ai. Ai tregoi një rast kur i kërkoi ChatGPT-së një mbiemër për të përshkruar formën e një patateje dhe mori fjalën “elipsoidale”. Kjo, sipas tij, nxori në pah kufizimet e inteligjencës artificiale. “Pikërisht këtu duhet ta lësh mënjatë inteligjencën artificiale dhe të përdorësh inteligjencën tënde – lexuesit, kur të dëgjojnë se patatja në pjatën e saj ishte ‘elipsoidale’, do të thonë: ‘Çfarë drejtin po flet ky tipi?’”

Horowitz, i njohur për kërkimet e tij të imtësishme, të cilat e shtynë të lexonte tre deri në katër libra për çdo episod të dramës së tij të ITV-së

*Foyle’s War*, e pranon lehtësinë që ofron AI-ja për marrjen e menjëhershme të njohurive. Megjithatë, ai thekson rëndësinë e gjykimit njerëzor. “Është e dobishme të kesh njohuri të menjëhershme, por jo të pakufizuara. Gjithmonë duhet të gjykosh atë që po të thuhet dhe gjithashtu të kërkojë një burim të dytë.” Ai e krahason këtë me metodat e tij të dikurshme: “Në kohët e mëparshme, shkoja në bibliotekë, kërkoja gjëra në libra. Cili është dallimi mes përdorimit të AI-së dhe shkruarjes drejt e te përgjigja?”

Përtej eksperimenteve të tij me AI-në, bibliografia e gjerë e Horowitz-it përfshin tre romane të *James Bond*, dy rishkrime të *Sherlock Holmes*, si edhe kontribute në seriale televizive të suksesshme si *Midsomer Murders*. Aktualisht ai po promovon *A Deadly Episode*, librin e gjashtë në serinë e tij *Hawthorne and Horowitz*, i cili zhytet në një rrëfim meta-letrar, ku detektivi dhe autori hetojnë një vrasje në sheshshirimin e një filmi që po përshtat librin e tyre të parë.

Duke reflektuar mbi tërheqjen e qëndrueshme të mistereve me vrasje, një zhanër që dominon një pjesë të madhe të krijimtarisë së tij, Horowitz sugjeron se ajo buron nga një nevojë themelore njerëzore. “Unë ia atribuoj

këtë ndjesinë se njerëzit kanë nevojë për të vërtetën absolute,” mendon ai.

Në një epokë të mbushur me “lajme dhe lajme të rreme, media sociale dhe të gjitha teoritë konspirative”, ai beson se romanet kriminale ofrojnë një lloj ngushëllimi të veçantë. “Një roman kriminal, të paktën, i vendos pikat mbi i, i sqaron të gjitha dhe të jep të vërtetën absolute. Vrasësi ishte ky person. Këto janë të dhënat që duhej t’i kishe vënë re. Kjo është arsyeja pse ai ose ajo e bëri, dhe do të ndëshkohet.” Ai shton se ky zhanër plotëson gjithashtu dëshirën për drejtësi dhe përmbyllje, duke ofruar ndjesinë e një “komuniteti që është shëruar”.

Pavarësisht këtyre temave të rënda, Horowitz kujdeset që librat e tij të mos jenë pa humor, duke pranuar se shpesh e bën veten të qeshë ndërsa shkruan. Edhe pse nuk i pëlqen termi “komedi kriminale aventureske”, ai vëren se seria *Hawthorne and Horowitz* ka zhvilluar një “anë më të lehtë”, ndoshta si kundërpeshë ndaj “kohëve të zymta dhe të errëta” në të cilat jetojmë.

Në përgjigje të këtij ankthi bashkëkohor, Horowitz, i cili u nderua me titullin *CBE* për shërbime ndaj letërsisë në vitin 2022, ka përqafuar disa praktika të reja personale. Ai i është kthyer leximit të poezisë, duke e gjetur atë “pafundësisht inkurajuese dhe pasuruese për jetën”, dhe tani e nis ditën me një poezi në vend të lajmeve.

Ai gjithashtu mori vendimin të largohej nga mediat sociale, duke braktisur *X* — dikur *Twitter* — dy vjet më parë. “Jam i lirë nga të gjitha mediat sociale dhe ndihem shumë më i shëndetshëm dhe më mirë për këtë – ndryshimi është vërtet mjaft dramatik,” thotë ai, pasi kishte kuptuar se po “zhytej gjithnjë e më shumë në to” dhe po ndeshte përmbajtje “dukshëm më toksike”.

Sa i përket *James Bond*, pasi ka shkruar një trilogji romanesh për agjentin 007, Horowitz refuzon prerazi të përmendë aktorin e tij të preferuar për mishërimin e ardhshëm të spiunit, duke e quajtur këtë “një rrugë pa krye ku nuk duhet të futesh”.

Megjithatë, ai shpreh mendimin se përzgjedhja e një *Bond-i femër* do të ishte “gabim”, duke përmendur *Modesty Blaise* si një personazh ekzistues spiunazhi femëror. Edhe pse i përshkruan librat e *Modesty Blaise* si “të tmerrshëm”, ata zënë një “vend të veçantë në zemrën time”, pasi kanë qenë të preferuar në familje.

Horowitz gjithashtu i është rikthyer letërsisë klasike, duke rilexuar *Thomas Hardy* me bashkëshorten e tij, producenten *Jill Green*. Ai gjen një bukuri prekëse në këtë proces. “Kam arritur në moshën kur jam i vetëdijshëm se këta libra tani do t’i lexoj për herë të fundit, dhe kjo është e trishtueshme – por është gjithashtu shumë zemërdhënëse t’u rikthehem librave që i kam dashur kur isha më i ri,” reflekton ai. Për të, “gëzimi i letërsisë së madhe është se, nëse e lexon kur je 20 vjeç dhe pastaj e rilexon kur je 60 ose 70, ajo të mban një pasqyrë përpara, duke të treguar sa shumë ke ndryshuar”.

*A Deadly Episode* nga Anthony Horowitz botohet në format me kapak të fortë nga *Century*, me çmim 22 paund, dhe është tashmë i disponueshëm.

Përkthimi © ExLibris

# Festivali i Librit Shqip

Toronto 2026

Libra, autorë,  
biseda dhe  
komunitet

Albanian  
Book  
Festival

**dbf**

## Vendi

Humber College - Barrett Centre  
for Technology Innovation  
Silver Bell Ln, Etobicoke, ON M9W 5L7

## Orët e festivalit

E shtunë, 9 maj  
10:00 AM - 8:00 PM

E dielë, 10 Maj  
9:00 AM - 5:00 PM

## Ambjentet Kryesore

Kati i parë- Hapësira e panairit  
CTI 512 - Salla e parë afër shkallëve  
CTI 513 - Salla në mes  
CTI 514 - Salla më në lindje

**dbf** Albanian  
Book  
Festival

## E shtunë, 9 maj

Programi - Festivali i Librit Shqip - Toronto 2026

Hyrja është falas . Nëse jeni regjistruar online për dhuratat me libra, ju lutemi paraqituni te recepsioni për të konfirmuar regjistrimin tuaj. Orari i programit mund të pësojë ndryshime. Për informacion të përditësuar, ju lutemi drejtojeni recepsionit.

10:00 AM **Hapja e dyerve**

Doors open

11:00-11:30 **Hapja Zyrtare**

Fjala e hapjes nga organizatorët, përfaqësues të institucioneve dhe të ftuar

Kati i Parë

12:00-13:00

Suzanne Lebeau - **Të shkruarit për audiencat e reja : çfarë tu tregojmë fëmijëve dhe si** (EN)

Moderatore: Aida Baro  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



13:00-15:00

Pushim

15:00-16:45

Ardian Vehbiu - **Të rrëfesh dhe të rrëfeshesh** (SQ)

Moderatore: Ajkuna Dakli  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



16:45-17:00

Pushim

17:00-18:45

Rita Petro - **Të jetosh pa frikë : Letërsia si akt lirie** (SQ)

Moderator: Flurans Ilia  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



16:45-17:00

Pushim

19:00-20:00

Dr. Klodian Rado - **Dialogu Gjyqësor Global dhe Gjykata Supreme e Kanadasë: Diplomaci, Rrjete, Ndikim** (SQ)

Moderatore: Blerina Ruka  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



20:00

**Mbyllja e panairit**

**dbf** Albanian  
Book  
Festival

## E dielë, 10 maj

Programi - Festivali i Librit Shqip - Toronto 2026

Hyrja është falas . Nëse jeni regjistruar online për dhuratat me libra, ju lutemi paraqituni te recepsioni për të konfirmuar regjistrimin tuaj. Orari i programit mund të pësojë ndryshime. Për informacion të përditësuar, ju lutemi drejtojeni recepsionit.

9:00 AM

**Hapja e panairit**

11:00-12:30

Ermal Nurja - **Burimet arkivore Osmane dhe historia demografike e Shqipërisë** (SQ)

Moderatore: Beti Njuma  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



11:00-13:00

Shkëndije Ibishi - **Ora e tregimeve me Dije Ibishin** (SQ/EN)

Tregime për fëmijë

CTI 514

12:30-13:00

Pushim

13:00-14:15

Marlee's Got Talent, Xhemi Agaj, Ana Golja - **Pasditë poetike** (SQ)

Prezantuese: Edlira Çini

CTI 512

14:15-15:00

Pushim

15:00-17:00

Dr. Pashko R. Camaj - **Letërsia e mërgimit: mes lirisë, fajit dhe pajtimit** (SQ)

Moderator: Beti Njuma  
Ofrohet përkthim direkt

CTI 512



17:00

**Mbyllja e Festivalit**